RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

"Auditim Financiar"

Tiranë, shtator 2026

PËRMBAJTJA....2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE....4
I.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin....4
I.2 Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve....5
I.3 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit....9
II. HYRJA....10
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA....11
II.1 Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit....11
II.2 Identifikimi i Çështjes....11
II.3 Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese....11
II.4 Përgjegjësitë e Audituesve....12
II.5 Kriteret e Vlerësimit....12
II.6 Standardet e Auditimit....13
II.7 Metoda e Auditimit....13
II.8 Dokumentimi i Auditimit....14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT....15
III.1 Informacion i përgjithshëm....15
III.2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit....16
III.2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik”....16
III.2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit te buxhetit....29
III.2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025....62
III.2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm....84
IV. REKOMANDIME....121

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AAGJM	Aktive Afatgjata Materiale
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
AAGJM Aktive Afatgjata Materiale	
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN

a. Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimi.

Bashkia e Lushnjës shtrihet midis lumenjve Shkumbin e Seman. Në veri kufizon me bashkitë e Rrogozhinës dhe Peqinit, në lindje me bashkinë e Belshit, në jug me Bashkinë e Fierit e Rroskovecit, ndërsa në perëndim me Divjakën. Qendra e Bashkisë është qyteti i Lushnjës. Sipërfaqja e përgjithshme e saj është mbi 372 km2. Bashkia përfshin qytetin dhe përafërsisht 90 fshatra, të organizuar në 15 njësi administrative: Lushnja në 5 rajone, si dhe Allkaj, Bubullima, Hysgjokaj, Golemi, Dushku, Karbunara, Ballagati, Fier – Shegani, Kolonja dhe Krutja. Ajo është pjesë e qarkut të Fierit. Bashkia e Lushnjës ka nën administrim një zonë të gjerë rurale. Ky territor është zona bujqësore e rëndësishme e Shqipërisë për prodhimet blegtorale, bujqësore, ullinj, drufrutorë si dhe vreshta. Veprimtaria financiare e Bashkisë Lushnjë financohet nga të ardhurat e veta vendore, transfertat nga buxheti i shtetit, grantet dhe burime të tjera financimi të lejuara nga legjislacioni në fuqi. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, bashkia ka përgjegjësi për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, administrimin e fondeve publike, menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve, si dhe hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me standardet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Auditimi financiar është kryer me qëllim vlerësimin e rregullshmërisë, ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare të Bashkisë Lushnjë, si dhe verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare me kuadrin ligjor e rregullator. Në kuadër të auditimit janë shqyrtuar sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, proceset e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, administrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, menaxhimi i aktiveve dhe detyrimeve, si dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e fondeve publike sipas parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Misioni i Bashkisë Lushnjë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Lushnjë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*" nenit 50 "*Auditi i jashtëm*" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë*". Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Lushnjë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar në Bashkinë Lushnjë për periudhën e aktivitetit nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së bashkisë.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Vlerësimi bazohet në risk dhe materialitet nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarive, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur tekN...t e auditimi si; Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve; Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët.

I.2 NUMRI I GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 22 gjetje dhe ka dhënë 27 rekomandime, nga të cilat 25 masa organizative dhe 2 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se: Objektivat e miratuara nga Bashkia nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet email-it apo shkresave zyrtare; Pavarësisht hartimit të regjistrit të riskut nuk është konkluduar me hartimin e një strategjie risku e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë ka ndryshime thelbësore mjedisi i riskut; Nuk vlerësohet mundësia e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues; Nuk është ndërtuar gjurma e auditimi për proceset kryesore të punës; Nuk është hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1; "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016 i ndryshuar, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika a 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar".

- Nga auditimi i njësisë së Auditit të Brendshëm konstatohet se përgjegjësi i strukturës së NjAB nuk ka përvojë pune në profesion dhe nuk është i çertifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik",

veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 1, pika 2/b të Ligjit nr. 114.2015, "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"

- Nga auditimi mbi realizimin e fondeve të parashikuara për investimet, nga auditimi u konstatua se: Në PBA 2025-2027 dhe projekt planin vjetor 2025 me burim "të ardhurat e veta + transferta e pakushtëzuar" janë planifikuar në total 47 projekte investimi në vlerën totale 525,472 mijë lekë për 4 programe buxhetore të 12 funksioneve, dhe janë realizuar 25 investime në vlerën totale 199,331 mijë lekë ose në masën 38% të vlerës totale të planifikuar;

Referuar Relacionit shoqërues të Raportit të monitorimit përcjellë në Këshillin Bashkiak dhe Akt rakordimit me thesarin, rezulton se mosrealizimi i fondeve buxhetore për zërin investime ka ardhur si rezultat i fondeve të papërdorura: nga viti 2024 për vitin 2025 në vlerën 171,195 mijë lekë dhe nga viti 2025 për vitin 2026 në vlerën 238,740 mijë lekë, nga të cilat rreth 20% e vlerës totale nuk është prokuruar dhe pjesa tjetër nga lidhja e kontratave në fund të vitit buxhetor apo nga diferenca plan-kontratë;

Nga sa më lartë, mosrealizimi i plotë i programeve të investimeve, vonesat në zbatimin e procedurave dhe pamundësia kohore për riadresimin e fondeve të lira, në arsyetimin e grupit të auditimit ka të bëjë me planifikim me paqartësi apo pasaktësi në përzgjedhjen e programeve dhe investimeve më prioritare, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 36; Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe Manuali MFK, Paragrafi 2.4; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Neni 9 pika 1.3, neni 5, neni 12 etj.

- Nga auditimi mbi parashikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksa e tarifat vendore, u konstatua se*;* Për vitin 2025, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 640,579 mijë lekë në po të njëjtën vlerë me vitin 2024 dhe janë realizuar në vlerën 515,768 mijë lekë ose (-) 4,772 mijë lekë më pak se realizimi në vitin 2024 dhe (-)124,811 mijë lekë më pak se planifikimi i tyre në vitin 2025 ose në masën 80.5%;

Nga kategoria "taksa", në mosrealizimin e të ardhurave kanë ndikuar arkëtimet nga: TNI, taksa e tokës bujqësore, taksë ndërtese, të cilat janë realizuar në masën nga 50.2% deri në 88.7% ndaj planifikimit vjetor por edhe me një rënie në masën nga 0.9% deri në 5.4% ndaj realizimit të vitit paraardhës 2024;

Nga kategoria "tarifa vendore", kanë ndikuar në mosrealizim tarifa nga: leje transporti-licenca, pastrim-higjenë-ndriçim realizuar në masën nga 77.5% deri në 84.5% ndaj planifikimit dhe me një rënie prej 12% ndaj realizimit të vitit të kaluar;

Nga kategoria "taksa të ndara" nga: taksë e kalimit të drejtës së pronësisë, renta minerare janë realizuar në masën nga 59.7% deri në 54% ndaj planit dhe me rënie prej 17.6% ndaj realizimit të vitit 2024;

Nga kategoria "të ardhura të tjera" nga: qira ndërtese, qira tokë bujqësore, të ardhura të tjera, janë realizuar në masën nga 22.6% deri në 86.5% ndaj planit dhe me rënie nga 3.8% deri në 4% ndaj realizimit të vitit 2024;

Nga njësitë e varësisë, në mosrealizimin e të ardhurave kanë ndikuar: mospagesat për konviktet, nga vaditja dhe nga qendra kulturore e klubi sportiv, realizuar nga 1.6% deri në 47.3% ndaj planit dhe me rënie nga 0.5% deri në 26% ndaj realizimit të vitit të mëparshëm 2024.

Mungesa e një analize të mirëfilltë, të detajuar për çdo burim të ardhurash, ka ndikuar në planifikimin në vlera jo reale të pastudiuara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë, duke kufizuar identifikimin e burimeve me performancë të ulët dhe marrjen e masave për rritjen e të ardhurave.

- Nga auditimi i të ardhurave nga subjektet që tregtojnë hidrokarbure, u konstatua se:

Në Bashkinë Lushnjë kanë ushtruar aktivitetin 56 subjekte, nga të cilat: - 33 subjekte janë pa liçencë, nga të cilat 9 subjekte janë mbyllur/pezulluar apo çregjistruar dhe 1 subjekt ka ndryshuar aktivitet; - 28 subjekte janë debitore deri në 31.12.2025 në vlerën totale 23,500,000 lekë nga të cilat: 1 subjekt aktiv me autorizim me vlerë debitore 1,000,000 lekë; janë 26 subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa licencë; janë 17 subjekte debitore aktive që ushtrojnë aktivitetin pa u pajisur me liçencë në vlerë totale debitore 14,300,000 lekë; janë 9 subjekte pa licencë që kanë mbyllur aktivitetin dhe kanë vlerë debitore totale 8,100,000 lekë dhe 1 subjekt që ka ndryshuar aktivitet me vlerë debitore 100,000 lekë; Kjo problematikë nuk është ngritur për diskutim në takimet e GMS dhe GMR, gjë që ka sjellë mungesën e hartimit të një plani masash konkret për të mundësuar arkëtimin nga subjektet debitore

të vlerës prej 23,500,000 lekë. Mosveprimet nga ana e Bashkisë Lushnjë në kundërshtim me kuadrin ligjor: VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar etj.

- Nga auditimi i të dhënave të llogarisë analitike 210 "Toka, troje, terrene" u konstatua që prej vitit 2024 janë bërë shtesa në këtë llogari troje, parcelat bujqësore dhe gurore me sipërfaqe totale 648,608 m^2 por me vlerë 17 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" konstatohet se që prej vitit 2024 janë shtuar 12 ndërtesa, të cilat janë kontabilizuar në shumën 12 lekë, pra 1 lek për ndërtesë. Efekti në pasqyrat financiare të vitit 2025 është mosparaqitje e drejtë dhe e saktë e aktiveve në pozicionin financiar. Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare informacioni i pasqyruar në pozicionin financiar të Bashkisë nuk është i drejtë dhe i saktë.
- Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" konstatohet se nga viti 2005 deri në vitin 2015 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 48,138,931 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sh.a Lushnjë por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Lushnjë. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Lushnjë dhe UKL Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 35-36.
- Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 7,279,000 lekë. Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë. Në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë që posedon në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë në masën 37.79% në vlerën 3,779,000 lekë sipas Marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime me nr. 1592 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM-it, Bashkisë Lushnjë dhe Bashkisë Divjakë. Gjithashtu në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë që posedon në Shoqërinë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930". Vlera e aksioneve të Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" është 3,500,000 lekë sipas Ekstraktit Historik në QKB dhe Vendimit nr. 60, datë 06.09.2013, të Këshillit Bashkiak Lushnjë me objekt "Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lushnjë si aksionar i vetëm në themelimin e Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" si zotërues në masën 100% të kapitalit të kësaj shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2".
- Gjendja e llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2025 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht: Kontrata me nr. 8578 prot., datë 01.10.2025, me objekt "Rehabilitimi i shkarkuesit në rezervuarin e Kasharaj" me vlerë kontrate 32,964,687 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 17,615,760 lekë; Kontrata me nr. 8780 prot., datë 07.10.2025, me objekt "Rindërtimi i shkollës së mesme të bashkuar "Zyber Sharka" me vlerë kontrate 56,699,683 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 13,305,306 lekë; Kontrata me nr. 10112 prot., datë 12.11.2025, me objekt "Sistemime rrugore në Lagjen "18-Tetori", ndërmjet rrugëve "Hysni Gorovelli" dhe "Athina Dhimitri" me vlerë kontrate 31,929,696 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 7,134,456 lekë. Vlera e likuiduar prej 38,055,522 lekë që i përket kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23.
- Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 2,938,459,293 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 275,898,364 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 135,407,908 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 6,664,262 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 374,283,280 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,636,436 lekë. Kjo problematikë është konstatuar në Qendrës Arsimore si pasojë e mos aplikimit të saktë të normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17.
- Nga auditimi mbi të dhënat në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifat vendore që kanë ndaj Bashkisë Lushnjë, u konstatua se deri në datën 31.12.2025 vlera debitore progresive është *1,860,578,335* lekë dhe vetëm për vitin 2025 është krijuar debi në vlerën totale *210,462,009* lekë. Vlera debitore është kontabilizuar. Në Bashkinë Lushjnë në takimet e GMS, nuk janë trajtuar problematikat për pamundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematik pa shpresë arkëtimi në shumën e 198,969,135 lekë dhe të atyre me afat papagese nga 2 deri në 5 vjet në vlerën 408,494,117 lekë dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë të detajuar, deri tani nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre. Mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920/2008 datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar;

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:
- Kryetari i Bashkisë, dhe strukturat përgjegjëse të marrin masa për hartimin e strategjisë së risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Lushnjë, në plan-veprimin për menaxhimin e riskut dhe regjistrin e risqeve të bëhet pjesë edhe risku i mashtrimit; të krijohet sistemi i raportimit mbi shkeljet e konstatuara gjatë proceseve të punës; të hartohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës si dhe të dokumentohet procesi i monitorimit.
- Kryetari i Bashkisë Lushnjë, dhe strukturat përgjegjëse të marrin masa për certifikimin e audituesve duke respektuar përcaktimet ligjore për stafin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.
- Në Bashkinë Lushnjë, Kryetari i bashkisë dhe GMS gjatë procesit të hartimit të PBA dhe projekt buxhetit vjetor, të tregojnë vëmendjen e duhur në përzgjedhjen e investimeve prioritare, duke përfshirë projekte të realizueshme brenda vitit buxhetor dhe të zbatohen në afatet kohore të përcaktuara, me qëllim rritjen e eficencës në realizimin e investimeve.
- Në Bashkinë Lushnjë, GMS, GMR dhe Drejtoria e Përgjithshme e financës dhe të ardhurave vendore të marrin masa për hartimin e analizave periodike mbi realizimin e secilit zë të ardhurash; pasqyrimin e detajuar të të ardhurave jotatimore sipas burimit të tyre, duke evidentuar shkaqet e diferencave midis planifikimit dhe realizimit, me qëllim planifikimin e të ardhurave mbi baza reale dhe rritjen e nivelit të arkëtimeve .
- DAV dhe Sektori i lejeve të transportit dhe licensimit, të marrë masat dhe në bashkëpunim me Drejtorinë juridike të ndjekin gjithë hapat ligjorë për vjeljen e detyrimit prej 23,500,000 lekë të 28 subjekteve debitore që tregtojnë hidrokarbure në territorin e Bashkisë Lushnjë, veçanërisht të subjekteve që kanë ushtruar aktivitetin pa u pajisur me liçencë dhe që aktualisht rezultojnë të pezulluar apo çrregjistruar në QKB. Kryetari i bashkisë dhe GMS të analizojnë shkaqet që kanë çuar në krijimin e kësaj situate, detyrat e pakryera nga strukturat përgjegjëse përkatëse dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në bashki;
- Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masat menjëhershme për përcaktimin e saktë të

vlerës së aseteve të shtuara që prej vitit 2024 dhe kontabilizimin e vlerave të sakta në llogaritë e aktiveve afatgjata sipas kërkesave dhe tek N.ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të bashkisë

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë për vlerën kontabël 48,138,931 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.
- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet në vlerën 7,279,000 lekë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.
- Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Qendrën Arsimore në pasqyrat financiare për vitin 2026 të kryejnë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.
- Kryetari i Bashkisë, GMS, GMR dhe Drejtoria e Përgjithshme financës, buxhetit, të ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës debitore progresive prej 1,860,578,335 lekë dhe veçanërisht për arkëtimin e debisë prej 607,463,252 lekë të debitorëve problematik pa shpresë arkëtimi.

I.3 KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2025:

a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Lushnjë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështësin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Lushnjë nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e Kualifikuar".

Bazat për opinionin e /kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 44,323 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2025, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Llogaritë 210 "Toka, troje, terrene" të pasqyruara në bilanc për vlerën 4,990,000 lekë (Qendra e Arsimit) dhe 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 4,176,457 lekë, 213 "Rrugë rrjete vepra

ujore" në vlerën 478,995,993 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në vlerën 14,574,498 lekë dhe 215 "Mjete transporti" në vlerën 50,661,092 lekë (Ndërmarrja e Pasurisë Publike) janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Qendra e Arsimit ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" vlerën 102,456 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 409,225 lekë në masën 20%;
- Qendra e Arsimit ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" vlerën 8,374,911 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 6,699,928 lekë në masën 20% dhe Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit vlerën 898,221 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 1,796,442 lekë në masën 20%;
- Bashkia Lushnjë nuk ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhej të aplikohej normë amortizimi në vlerën 3,079,062 lekë në masën 20% dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" vlerën 13,627,007 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 17,248,607 lekë në masën 20%;
- Bashkia Lushnjë ka aplikuar normë amortizimi në vlerën 278,200 lekë për llogarinë 218 "Inventar ekonomik"; NPP vlerën 771,083 lekë; QKKS vlerën 204,992 lekë dhe QA vlerën 7,992,369 lekë në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Për më tepër QKKS ka aplikuar normë amortizimi në masën 10% për llogarinë 218 "Inventar ekonomik";
- Në gjendjen e llogarisë 215 "Mjete transporti" është kontabilizuar vlera prej 3,669,000 lekë kosto historike që i përket automjeteve të dëmtuara që nuk janë në gjendje pune të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit të cilat duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 24 "Aktive afatgjata materiale";
- Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" u konstatua se nga viti 2005 deri në vitin 2015 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 48,138,931 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sh.a Lushnjë, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Lushnjë;
- Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" është nënvlerësuar në vlerën 7,279,000 lekë. Në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë që posedon në SHRUK Lushnjë në masën 37.79% në vlerën 3,779,000 lekë si dhe aksionet në masën 100% të kapitalit që posedon në Shoqërinë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930", ku vlera e aksioneve është 3,500,000 lekë;
- Vlera prej 38,055,522 lekë e kontratave të në proces duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë;
- Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,636,4360 lekë. Kjo problematikë është konstatuar në Qendrës Arsimore si pasojë e mos aplikimit të saktë të normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale;

II. HYRJA

Mbështëtur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 378/1prot., datë 09.04.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.04.2026 deri në datën 29.05.2026, në subjektin Bashkia Lushnjë u krye "*Auditimi Financiar*" për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. C., Përgjegjës Grupi;
2. M. H. anëtar
3. S. J. anëtare

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

II.1 Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përfundim të auditimit, hartohet Projekt Raporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Lushnjë.

II.2 Identifikimi i Çështjes.

Auditimi synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Lushnjë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Lushnjë.

II.3 Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnjë, Kryetari i Bashkisë në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të plotë dhe të saktë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Lushnjë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3. Nëpunësi Autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë. Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[1] Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe

[1] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 15

informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

II.4 Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për pasqyrat financiare të bashkisë Lushnjë lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.
Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: etika dhe pavarësia, kontrolli i cilësisë menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, alokimi i fondeve dhe transaksionet financiare. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Lushnjë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese, e cila përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

II.5 Kriteret e Vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Lushnjë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Lushnjë. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*";
- Ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*";
- Ligji nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, etj*.";
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar;

- Udhëzimi i MFE nr. 22, date 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore ";*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar;
- Udhëzimet standarde vjetore të Ministrisë së Financave për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit, etj.";
- Rregullore e Brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së*", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e brendshme "*Mbi Procedurat e auditimit në KLSH*", miratuar me vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë.

II.6 Standardet e Auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me:
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200,400 etj.;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të II1-t, INTOSA1 "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar;
- Manuali i zbatimi te rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

II.7 Metoda e Auditimit.

Si metodë auditimi gjatë procesit të auditimit është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[2]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur tekN...t e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të

[2] ***ISSAI 1320 (ISA 320)*** *trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Përcakton nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.
- *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat, shpenzimet për kontribute të sigurimeve, shpenzimet operative, transferimet korrente si dhe investimet. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[3].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mire informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

II.8 Dokumentimi i Auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "*Dokumentimi i Auditimit*", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.
Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua ky Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve) dhe (Akt-Verifikimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuar në zyrën e protokollit të Bashkisë Lushnjë në datë 27.07.2026, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit.
Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë protokolluar në KLSH nr. 737/3 datë 03.08.2026 të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizëm nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion, u përgatit dhe u dërgua në subjekt Projektraporti i Auditimit për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive rreth gjetjeve të tij.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

III.1 Informacion i përgjithshëm

Auditimi në Bashkinë Lushnjë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të menaxhimit financiar dhe raportimit financiar. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive. Bashkia Lushnjë përballet me një sërë sfidash që ndikojnë në realizimin e objektivave të saj dhe në ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve. Ndër sfidat kryesore evidentohet tkurrja e popullsisë dhe emigracioni, të cilat ndikojnë në uljen e bazës tatimore dhe të ardhurave vendore. Njëkohësisht, shtrirja e gjerë territoriale dhe karakteri kryesisht rural i bashkisë rrisin kostot e mirëmbajtjes dhe ofrimit të shërbimeve publike.
Sfidë e rëndësishme mbetet sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve publike dhe përmirësimin e infrastrukturës vendore, veçanërisht në njësitë administrative më të largëta. Gjithashtu, bashkia përballet me nevojën për rritjen e efiçiencës në mbledhjen e të ardhurave vendore, administrimin e aseteve publike dhe forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në kuadër të zhvillimit ekonomik vendor, sfidë mbetet krijimi i kushteve për nxitjen e investimeve, zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor, mbështetjen e aktiviteteve bujqësore e blegtorale dhe krijimin e mundësive të reja të punësimit. Përballimi i këtyre sfidave kërkon planifikim të qëndrueshëm financiar, përdorim efektiv të fondeve publike dhe forcim të kapaciteteve administrative e institucionale.
Rëndësia e këtij auditimi është sepse auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

III.2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të drejtimeve kryesore të auditimit drejtimit 1. "*Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik*", drejtimit nr. 2 "*Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit*", drejtimi nr. 3 "*Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025*" si dhe drejtimit nr. 4 "*Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm*" të programit të auditimit janë shqyrtuar dokumentacionet sipas pikave më poshtë:

III.2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik"

Në zbatim të Pikën nr. 1, të Programit të Auditimit nr. 737/1 prot., datë 30.06.2026, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregulloren e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit;
2. Urdhrat për caktimin e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues;
3. Kod sjellje, etike ose udhëzim për zbatimin e etikës;
4. Urdhrat për caktimin e Koordinatorit të Riskut dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik;
5. Raportin, Deklaratën dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit të dorëzuar pranë MFE-së;
6. Struktura organizative e institucionit;
7. Planet vjetore të punës;
8. Dokumentacion mbi vlerësimin e performacës së punonjësve;
9. Plani vjetor i trajnimeve;
10. Dokumentacion tjetër mbështetës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

III.2.1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Lushnjë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit":

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 1. *"Njësia publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike"*;

Parimi 2. *"Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje"*;

Parimi 3. *"Titullari/Nëpunësi Autorizues krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"*;

Parimi 4. *"Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave"*;

Parimi 5. *"Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale"*.

Parimi 1. *"Njësia publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike"*:
Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Lushnjë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Nga auditimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit, konstatohet se institucioni vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme miratuar me Vendimin nr. 36, datë 06.04.2021, e përditësuar me Vendimin nr. 17, datë 09.01.2026.
- Për miratimin e Rregullores "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lushnjë". Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.
- Kodi i Etikës është miratuar me Vendimin nr. 94, datë 28.03.2023, "Për miratimin e Kodit të Etikës në Bashkinë Lushnjë", në mbështetje të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.
- Me Vendimin nr. 412, datë 10.11.2025, është miratuar "Rregullorja për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës Bashkia Lushnjë".
- Punonjësit janë njohur me Rregulloren e Brendshme të institucionit me anë të e-mailit të nisur në çdo drejtori, e shpërndarë nga punonjësi i Protokollit si dhe ky dokument është publikuar edhe në faqen e web-it të institucionit.
- Me shkresën nr. 33 prot., datë 05.01.2025, nga Bashkia Lushnjë është hartuar programi vjetor i trajnimeve të punonjësve të institucionit duke u bazuar në kërkesat specifike të çdo drejtorie.
- Me Urdhrin nr. 189, datë 26.12.2019, është miratuar "Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit" por pas ndryshimeve ligjore që ka pësuar Ligji nr. 23/2026, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", ka dal Urdhri nr. 126, datë 18.05.2026, "Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Kodit të Etikës dhe Rregulloren e parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Lushnjë".
- Lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, vlen të theksojmë se bashkia i zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.
- Nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.
- Nëpërmjet email-it të nisura Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka rikujtuar drejtoritë e bashkisë mbi detyrimin ligjor për vlerësimin periodik të rezultateve në punë, konstatohet se zyrtarët raportues dhe zyrtari autorizues kanë kryer vlerësimet e punës gjatë vitit kalendarik (në të dyja periudha 6 mujore) në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.
Parimi 2. *"Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje"*:
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Titullari i bashkisë mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike për të gjithë komponentët. Është hartuar dhe miratuar Plani i Veprimit për KB dhe kryhet raportim periodik i monitorimit të këtij Plani.
- Nuk ka raportime për të gjitha dobësitë e kontrollit të brendshëm dhe as për realizimin e objektivave..
- Titullari i bashkisë ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave "*Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm*" dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin 2025 me shkresën nr. 2192 prot., datë 27.02.2026.
- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Parimi 3. *"Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"*:

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
Institucioni vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 09.01.2026, e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
- Me Urdhrin nr. 314, datë 11.12.2024, "Për miratimin e strukturës/organikës dhe kategoritë/klasat e pagave të Bashkisë Lushnjë dhe Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2025" si dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 111, datë 26.12.2024, është miratuar niveli i pagave për punonjësit e institucionit.

Struktura organizative e bashkisë e aplikuar për vitin 2025 paraqitet në tabelën si më poshtë:

	Struktura	Viti 2025	
		Plan	Fakt
1	Administrata + Njësitë administrative	**276**	**271**
2	Qendra e Kulturës	**63**	**61**
3	Qendra e Arsimit	**298**	**289**
4	Ndërmarrja e Pasurisë Publike	**264**	**245**
5	Pyjet (transf)	**8**	**7**
6	Ujitja dhe Kullimi(transf)	**29**	**25**
7	MZSH (transf)	**20**	**19**
8	Arsimi Bazë (transf)	**122**	**118**
9	Arsimi Mesëm (transf)	**3**	**3**
	Numri i të punësuarve	**1083**	**1038**

Burimi i të dhënave: Bashkia Lushnjë.

Administrata e Bashkisë përbëhet nga:
1. Funksionarët politikë (jo nëpunës civil);
2. Nëpunësit civilë;
3. Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.

Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

1. Funksionet politike:

a) Kryetari
b) Zëvendëskryetarët
c) Administratorët
d) Kabineti i Kryetarit

Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Vendim të Kryetarit.

2. Nëpunësit civilë:

Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:
Pozicionet e punës të vlerësuara me status të Nëpunësit Civil, gjithsej **143** pozicione, nga të cilat:

- 5 pozicione të kategorisë së lartë;
- 9 pozicione të kategorisë së mesme drejtues;
- 19 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese;
- 110 pozicione të kategorive ekzekutive;

Pozicionet të lira (të paplotësuara):

- 1 pozicion i kategorisë së lartë;
- 2 pozicione të kategorisë së mesme drejtues;
- 5 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese;
- 10 pozicione të kategorive ekzekutive.

Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar **40** punonjës të rinj dhe janë larguar **35** punonjës. Në dosjet e personelit dokumentacioni është i plotë dhe me fletë inventari sipas modelit për administrimin e dosjeve të personelit dhe të regjistrit qëndror të personelit. Janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion. Për sa i përket punonjësve administrativ dhe të terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Referuar Kreut II, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit të miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 108/2016, përcaktohet që:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune kriteret për rekrutimin e tyre përcaktohen bashkëlidhur shpalljes së vendit vakant të punës sipas specifikave të secilit pozicion. Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

- Komisioneri (KMSHC) është informuar çdo 3 muaj me raportim sipas periudhës përkatëse për pjesën e shërbimit civil, për punonjësit me akt të përkohshëm emërimi apo në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.
- Për vitin 2025 në strukturën e Ndërmarrjes së Pasurisë Publike pjesë e Bashkisë Lushnjë si njësi shpenzuese, në përbërjen e saj ka 5 (pesë) punonjës me profesion elektricist (z. F. D., z. S. B., z. B. B., z. E. N. dhe z. B. Ç.). Këta punonjës nuk janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike" i ndryshuar, neni 9, gërma "a".
- Bashkia ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
- Institucioni ka hartuar dhe miratuar deklaratë të misionit dhe një strategji të miratuar me objektivat dhe prioritetet strategjikë në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Janë zhvilluar mbledhje të menaxherëve të strukturave/njësive të vartësisë mbi diskutime për plan strategjik.
- Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia nuk përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4. *"Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave"*:

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë. Përshkrimet e punës në institucioni janë pjesë e Rregullores së Brendshme të Institucionit.

- Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale e cila është e pajisur me të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, vërtetim të gjendjes gjyqësore, të cilat përditësohen çdo fillim viti dhe të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë çdo 6 muaj.
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve, sa i takon procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, është realizuar procesi i vlerësimit në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar çdo 6 muaj.
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia ka hartuar një program trajnimi, ku përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.
- Me shkresën nr. 8575/1 prot., datë 08.11.2024, është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për trajnimet e vitit 2025.

Parimi 5. *"Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale"*:

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

- Bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme.

- Evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.
- Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2025 ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 52, datë 10.02.2025, "Për ngritjen e grupit të Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Lushnjë për vitin 2025". Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje **13** anëtarë dhe kryetar i grupit është Titullari i Bashkisë. GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

- Takimet e GMS-së dokumentohen me procesverbale konkretisht për vitin 2025 janë mbajtur 6 procesverbale.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut":

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6. *"Specifikimi i objektivave të përshtatshëm"*;
Parimi 7. *"Identifikimi dhe analiza e risqeve"*;
Parimi 8. *"Mundësia e riskut të mashtrimeve"*;
Parimi 9. *"Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme"*.

Parimi 6. *"Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva":*

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

- Duke marrë në konsideratë se bashkia duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur PBA, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.
- Dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 122, datë 26.12.2024.
- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, konstatohet se janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjesave me publikun.
- Gjatë vitit 2025 janë organizuar Dëgjesë Publike, ku morën pjesë qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e bashkisë.
- Institucioni nuk ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.
- Objektivat e miratuara nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet email-it apo shkresave zyrtare. Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.
- Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Parimi 7. *"Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave":*

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

- Njësia publike ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut. Bashkia ka identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë. Bashkia disponon urdhërin nr. 65, datë 24.02.2025, për ngritjen e GMS-së ku me shkresën nr. 8266 prot., datë 23.09.2025, ka kërkuar informacion drejtorive për të rishikuar regjistrin e riskur të çdo drejtorie sipas ndryshimit të mjedisit të institucionit, për të cilat drejtoritë kanë kthyer përgjigje lidhur me azhornimin e riskut sipas specifikave përkatëse.
Rishikimi i regjistrit të riskut është realizuar nga disa drejtori konkretisht: DZHR me shkresën nr. 8266/3 prot., datë 09.10.2025; DPIEPSI, DBNJ me shkresën nr. 8266/1 prot., datë 29.09.2025; Policia Bashkiake, DMP me shkresën nr. 8266/2 prot datë 03.10.2025, DSHSKSH me shkresën nr. 9020 prot, datë 13.10.2025. Regjistri i riskut në të cilën përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Lushnjë është hartuar në vitin 2017, për të përditësuar disa herë kur ka pasur ndryshime të mjedisit të institucionit.
- Pavarësisht hartimit të regjistrit të riskut i cili disponohet si dokument nga institucioni por nuk është konkluduar me hartimin e një strategji risku e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë ka ndryshime thelbësore mjedisi i riskut. Konkretisht nëpunësit autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 21.

Parimi 8. *"Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve":*

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
- Bashkia Lushnjë nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9. *"Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme":*

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
- Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet paraqitet në nivele të pranueshme, duke marrë në konsideratë faktin që regjistri i riskut përditësohet vit pas viti referuar ndryshimeve në mjedis, pavarësisht se nuk është konkluduar me një strategji konkrete të riskut.
- Bashkia Lushnjë ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit":

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 10. *"Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit"*;
Parimi 11. *"Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë"*;
Parimi 12. *"Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave"*.

Parimi 10. *"Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit"*:

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një

analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se bashkia ka një dokument të hartuar të hartave apo manualeve të proceseve të punës. Bashkia Lushnjë disponon Urdhrin nr. 94/1, datë 24.06.2020, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe përpunimin e hartës së Proçeseve të Punës Bashkia Lushnjë", ku në bazë të këtij urdhëri është ngritur një grup pune për hartimin e materialit përmbledhës të hartës së proçeseve të punës.
Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.,. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.,).
- Në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.
- Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" i ndryshuar.
Parimi 11. *"Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë"*:
Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
- Bashkia Lushnjë ka në përdorim disa sisteme qeveritare si AMFIS dhe e-leje për të cilat rregullat e përdorimit janë të përcaktuara nga AKSHI. Hostimi i tyre kryhet nga AKSHI i cili për çdo përdorim i ofron bashkisë manuale dhe rregullore përdorimi. Të dhënat ruhen në cloud. Përveç sistemeve fikse, bashkia nuk përdor sisteme të tjera dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up-it.
- Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT-së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.
- Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.
Parimi 12. *"Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave":*
Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
- Bashkia Lushnjë ka hartuar deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2025 për të cilën ka raportuar pranë Ministrisë së Financave/DHMFKK me shkresën nr. 2192 prot., datë 27.02.2026.
- Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

- Bashkia Lushnjë nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Gjurma e auditimit:

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

- Bashkia Lushnjë nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to. Ato duhet të përfshijnë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi":

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara. Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13. *"Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor"*;

Parimi 14 *"Komunikimi i brendshëm"*;

Parimi 15. *"Komunikimi i jashtëm"*.

Parimi 13. *"Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor";*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm. Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

- Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.*
- Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
- Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Parimi 14. *"Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm":*

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.
- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.

- Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15. *"Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm":*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore por evidentohet që punonjësit duke përdorur adresat zyrtare të e-mailit, bashkia_Lushnjë@yahoo.com dhe info@bashkiaLushnjë.gov.al.

Nga auditimi i të dhënave në faqen të Bashkisë Lushnjë, konstatohet se siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me:

- Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar;
- Buxhetin e miratuar të bashkisë;
- Raporte periodike të zbatimit të buxhetit;
- Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit;
- Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet;
- Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

V. Komponenti "Monitorimi":

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 16. *"Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta";*
Parimi 17. *"Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive".*

Parimi 16. *"Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm":*

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

- Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre. Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.
- Për vitin 2025 Bashkia Lushnjë ka dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE "Deklaratën për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm" me shkresën nr. 2192 prot., datë 27.02.2026.
- Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga NJAB.
- Bashkia Lushnjë nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
- Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.
- NjAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2025.

Parimi 17. *"Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë":*

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. - Bashkia Lushnjë ka hartuar Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin

2025 për të cilën ka raportuar pranë MF/Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit me shkresën nr. 2192 prot., datë 27.02.2026.
- Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

III.2.1.2 Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.
Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 20.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, pika 1, është ngritur dhe funksionon NJAB në varësi funksionale nga Titullari i institucionit, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.
Ky sektor përgjatë periudhës 2025, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 314, datë 11.12.2024, "Për miratimin e strukturës/organikës dhe kategoritë e pagave të Bashkisë Lushnjë dhe Ndërmarrjeve vartëse të Bashkisë për vitin 2025" dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 111, datë 26.12.2024, "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Lushnjë, institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2025" duke pasur pjesë përbërëse të saj 1 (një) Përgjegjës Sektori znj. F. M. dhe 2 (dy) Specialist znj. A. H., znj. E.P. Për periudhën Janar-Shtator 2025 znj. E. P. ka qenë me Raport (Leje lindje) duke u zëvendësuar nga znj. Y. Gj. Për periudhën nga data 22 Shtator-31 Dhjetor 2025 e në vazhdim znj. E. P.është rikthyer në marrëdhënie pune pas përfundimin e Raportit.
Përgjegjësi i Strukturës së NjAB është emëruar në shkurt të vitit 2024, por ende nuk është çertifikuar si AB. Sipas komunikimeve verbale aktualisht është në proces çertifikimi nga struktura përgjegjëse DHAB pranë Ministrisë së Financave. Ndërsa dy specialistët e tjerë janë të çertifikuar që prej muajit Korrik 2023.
- Për vitin 2025 Bashkia Lushnjë ka funksionuar në bazë të Rregullores së Brendshme të miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 196, datë 12.12.2018, "Për miratimin e Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lushnjë", ndryshuar me Vendimin nr. 36, datë 06.04.2021, "Mbi një ndryshim në vendimin e vitit 2018 "Mbi miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Lushnjë".
Në rregullore janë përcaktuar misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, mënyra e organizimit, përgjegjësitë e drejtuesit të NjAB dhe audituesve të brendshëm, detyrat funksionale të tyre, bashkëpunimi me menaxhimin dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm etj.,.
Në rregullore janë përcaktuar:

- Misioni i auditimit të brendshëm dhe roli i NjAB në njësinë publike;
- Detyrat e Përgjegjësit të Auditimit të Brendshëm;
- Detyrat e Specialistit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm;

Struktura e njësisë AB për vitin 2025

Nr.	Nga data e krijimit deri më 31.12.2025	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
Për vitin 2025							
1	F. M.	Përgjegjës	Dega Plan	28	1.8	Në proçes çertifikimi	+
2	A. H.	Specialist	Drejtësisë	10.5	5	Çertifikuar 2023	+
3	E. P.	Specialist	Financë Kontabilitet	15	3.4	Çertifikuar 2023	+
4	Y. Gj.	Specialist (zëvendësuese)	Administrim Publik	11 (muaj)		I pa çertifikuar	-

Trajnimet e NjAB dhe çertifikimet:

Referuar Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Mbi Auditimin e Brendshëm" i ndryshuar, dhe "Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve për të zgjeruar njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional (kryesisht trajnimet janë zhvilluar online). Përgjegjësia për trajnimin nuk

është vetëm e njësisë së auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo audites duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.
Në lidhje me çertifikimin e audituesve: 2 punonjës (Specialistët) e sektorit të AB, janë të Çertifikuar. Në vitin 2025 ka dalë Urdhri i Ministrit të Financave nr. 159, datë 22.12.2025, "Për hapjen e procesit të çertifikimit të auditësve të brendshëm në sektorin publik, për sezonin 2026". Ndërsa Përgjegjësi i NJAB ka aplikuar në janar pranë DHAB në MF për të marrë pjesë në Çertifikimin për Audites në Sektorin Publik dhe aktualisht është në proces çertifikimi.
- Përgjegjësi i NjAB në Bashkinë Lushnjë nuk ka përvojë pune në profesion dhe nuk është i çertifikuar si "Audites i brendshëm në sektorin publik", në kundërshtim me kërkesat e nenit 1, pika 2/b të Ligjit nr. 114.2015, "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" që përcakton se:
b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si "Audites i brendshëm në sektorin publik";

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik:

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm. NjAB në mbështetje të Urdhërit nr. 100, datë 25.10.2016, të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Lushnjë e cila është miratuar nga titullari me Urdhrin nr. 277, datë 21.10.2024, "Mbi miratimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Lushnjë". Me shkresën nr. 8627 prot., datë 23.10.2024, i është dërguar DHAB pranë MF-së në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016".

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve:

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga NjAB mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm. Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, Kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, datë 25.10.2016, përcaktohet se: "Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm".
Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2025-2027. Plani strategjik për vitet 2025-2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 janë miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 272, datë 15.10.2024, "Për miratimin e planit strategjik 2025-2027 dhe planit vjetor 2025 të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm". Me shkresën nr. 8450 prot., datë 16.10.2024, janë dërguar në DHAB pranë MF në formë elektronike dhe shkresore në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar. Bashkëlidhur ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Plani vjetor 2025 gjatë vitit është ndryshuar:
- Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 23, datë 16.01.2025, (ndryshimi i planit vjetor bashkë me arsyetimin janë dërguar në DHAB pranë MF me shkresën nr. 495 prot., datë 16.01.2025);
- Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 290, datë 15.10.2025, (ndryshimi i planit vjetor bashkë me arsyetimin janë dërguar në DHAB pranë MF me shkresën nr. 9102 prot., datë 15.10.2025);
- Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 348, datë 04.12.2025, (ndryshimi i planit vjetor bashkë me arsyetimin janë dërguar në DHAB pranë MF me shkresën nr. 10867 prot., datë 09.12.2025);

Për të ndihmuar NJAB, lidhur me procedurat që duhen zbatuar për hartimin e Planit strategjik dhe vjetor si dhe për të siguruar një format të njëjtë të treguesve që planifikohen aneksi përmban një material shpjegues mbi plotësimin e 5 pasqyrave të planit strategjik dhe vjetor:
1. Pasqyra nr. 1 "Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2025-2027";
2. Pasqyra nr. 2: "Plani strategjik i subjekteve të synuara për t'u audituar për vitet 2025-2027";
3. Pasqyra nr. 3: "Plani i angazhimeve të NjAB për vitin 2025";
4. Pasqyra nr. 4: "Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NjAB për vitin 2025";
5. Pasqyra nr. 5: "Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NjAB për vitin 2025".
Plotësimi i pasqyrave standard nevojitet për përgatitjen e pjesës së shkruar të Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB. Të dhënat e paraqitura në pasqyra duhet të gjejnë argumentim të detajuar në pjesën e shkruar të dokumentit dhe kur është e nevojshme mund të bëhen dhe shënime shtesë në fund të materialit të përgatitur. Përgatitja e pasqyrave standard ka si qëllim që të vendosë në të njëjtën linjë dhe formë planifikimin dhe rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në të gjithë sektorin publik.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NjAB për vitin 2025:

Për vitin 2025, janë planifikuar për t'u kryer **9** auditime, janë realizuar **8** angazhim auditimi si më poshtë:

Nr.	Subjekti audituar	Gjetjet sipas fushës ose sistemeve në numër										
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig.shog, sig.shendetesor, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit prones, pasurise	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Ssitemet e legalizimeve,uU rbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, suvencioneve	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Zbatimi i rekomand. 2024	**3**	**9**		**7**	**3**					**10**	F.M., A.H., Y.Gj.
2	Nj. Ad.Bubullimë				**2**						**1**	F.M., A.H., Y.Gj.
3	Nj. Ad.Karbunarë				**2**	**1**					**1**	F.M., A.H., Y.Gj.
4	Dr. Financës, QKKSh, QA, NPP (Det.prapam.)		**1**								**1**	F.M., A.H., Y.Gj.
5	Qendra Kulturore dhe Klubi Shumësportit	**3**									**2**	**F.M. A.H.**
6	Drejtoria e të Ardhurave Vendore				**2**						**1**	F.M., A.H., E.P.
7	K. "F"L.xxxx sh.a"	**2**	**3**								**4**	**F.M. A.H.**

Raporti i veprimtarisë së NJAB nr. 1713 prot., datë 13.02.2026, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 1713/1 prot., datë 13.02.2026. Për vitin 2025, janë dhënë **26** rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë zbatuar 7 masa janë në proces zbatimi 14 masa si dhe nuk janë zbatuar 5 masa. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit				sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2025	26	7	14	5	0	0	0	0
Totali		**26**	**7**	**14**	**5**	**0**	**0**	**0**	**0**

Gjatë vitit 2025 Sektori i Auditimit të Brendshëm ka planifikuar sipas plani vjetor 2025, 9 auditime nga të cilat janë realizuar gjithsej 8 (tetë) auditime ose 89% e Planit fillestar. Nga këto janë realizuar për vitin 2025 4 (katër) auditime të përputhshmërisë dhe 4 (katër) auditime të kombinuara.

Auditime të përputhshmërisë në këto subjekte: NjA Bubullimë; NjA Karbunarë; Analiza e detyrimeve të prapambetura nëntor 2024-30 Maj 2025; Vlerësimi i Statusit të Zbatimit të Rekomandimeve për vitin 2024.

Auditime të kombinuara në këto subjekte: Drejtoria e Përgjithshme e integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit dhe NPP, Qendra e Kulturës dhe Klubit Shumësportit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Klubi i Futbollit "Lushnja 1930".

Auditime jashtë planit: Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit dhe NPP.
Me Urdhër të Kryetarit nr. 23, datë 16.01.2025, është ndryshuar plani i miratuar për vitin 2025, për Auditimin tematik Auditim i procedurës së Prokurimit "Blerje Kamioni për mbledhjen e mbetjeve "Financuar nga Ambasada Japoneze në Shqipëri dhe "Klubi i Futbollit "Lushnja 1930".
Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 348, datë 01.12.2025, ku është zëvëndësuar auditimi i NjA Hysgjokaj me Klubin e Futbollit "Lushnja 1930".

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB:

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2025, auditoi dy dosjet e auditimit, që janë:
1. Dosja e auditimit të kryer në "Njësinë Administrative Bubullimë";
2. Dosja e auditimit të kryer në "Drejtorinë e të ardhurave vendore";

NjAB Lushnjë, për çdo angazhim auditimi të kryer përgjatë vitit 2025, ka respektuar proceset për realizimin e auditimeve në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitullin VI që përcakton evidentimin dhe dokumentimin e punës audituese. Dosja e përgatitur për çdo angazhim auditimi ndihmon për të verifikuar nëse janë respektuar të gjitha proceset për realizimin e angazhimit, si dhe ndihmon rishikuesit dhe audituesit e tjerë që do të përdorin atë. Për çdo angazhim auditimi përgatit një dosjet të veçantë, e cila përveç dokumentacionit që gjykohet e rëndësishme nga grupi i punës, duhet të përmbajë edhe këto dokumente:

Nr.	Viti	Subjektet e audituara	Përshkrimi i punës të Sektorit të Auditit të Brendshë
1	2025	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	**Përbërja e dosjes**
			Autorizimi nr. 9201 prot., datë 17.10.2025
			Deklaratë e pavarësisë së audituesit datë 17.10.2025,
			Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 9202 prot., datë 17.10.2025
			Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit datë 17.10.2025,
			Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë datë 17.10.2025
			Programi i angazhimit të auditimit nr. 9203 prot., datë 17.10.2025
			Takimi fillestar me organizatën (projekt-axhenda) datë 21.10.2025
			Testet individuale të auditimit të brendshëm (formati standart 9) datë 21.10.2025
			Shkresë përcjellëse e projekt raportit nr. 11113/1 prot., datë 16.12.2025
			Projekt raporti nr. 11113 prot., datë 16.12.2025
			Plani i veprimit i sugjeruar (formati standard 10) datë 15.12.2025
			Kundërshtitë (Observacionet) Nuk ka
			Shkresë përcjellëse Raportit përfundimtar nr. 11540/1 prot., datë 31.12.2025,
			Raporti përfundimtar nr. 11540 prot., datë 31.12.2025,
			Reagimet (feedback) nr. 1258 prot., datë 02.02.2026,
			Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar nr. 1258 prot., datë 02.02.2025
			Memorandumi nr. 2186 prot., datë 27.02.2026,
			Akt marrëveshje sipas aneksit 2 (kur realizohet një auditim i tillë). Nuk ka.
			Evidenca të tjera të auditimit (Po).
2	2025	Njësia Administrative Bubullimë	**Përbërja e dosjes**
			Autorizimi nr. 2456 prot., datë 17.03.2025
			Deklaratë e pavarësisë së audituesit datë 17.03.2025,
			Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit nr. 2456/2 prot., datë 17.03.2025
			Vlerësimi i riskut për mjedin e përgjithshëm të kontrollit datë 17.03.2025
			Vlerësimi i risqeve për sisteme/ fusha të veçanta të llogarisë datë 17.03.2025
			Programi i angazhimit të auditimit nr. 2456/1 prot., datë 17.03.2025
			Takimi fillestar me organizatën (project-axhenda) datë 17.03.2025
			Testet individuale të auditimit të brendshëm (formati standart 9) datë 17.03.2025
			Shkresë përcjellëse e projekt raportit nr. 3083/1 prot., datë 09.04.2025
			Projekt raporti nr. 3083 prot., datë 09.04.2025
			Plani i veprimit i sugjeruar (formati standard 10) datë 09.04.2025
			Kundërshtitë (Observacionet) nuk ka
			Shkresë përcjellëse e Raportit përfundimtar nr. 3451/1 datë 32.04.2025
			Raporti përfundimtar nr. 3451 datë 23.04.2025
			Reagimet (feedback) datë 14.05.2025
			Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar nr. 93/6 prot., datë 14.05.2025
			Memorandumi nr. 4292 prot., datë 23.05.2025
			Akt marrëveshje sipas aneksit 2(kur realizohet një auditim i tillë). Nuk ka
			Evidenca të tjera të auditimit (Po).

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm:

Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 "Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm" në fund të Kapitullit III i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësori i vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësia dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.

Nga NjAB është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm është bërë nga drejtuesi dhe dy audituesit e NJAB duke qenë se nuk ka një komitet auditimi për të pasur një vlerësim më të saktë e profesional.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm:

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet.

Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim. NjAB në Bashkinë Lushnjë ka hartuar *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të zyrës së auditimit të brendshëm", i cili* është miratuar nga titullari me Vendimin nr. 31, datë 16.03.2021. Me shkresën nr. 2065/1 prot., datë 18.03.2021, i është dërguar DHAB pranë MF.

Në përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII, i cili, referuar Standardit 1300 citon se: Programi i Siguri dhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguridhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Programi për vlerësimin e cilësisë përbëhet nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme, që përfshijnë:

- Vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë njësia e auditimit të brendshëm bazuar në politikat dhe praktikat e saj;
- Vlerësimin e jashtëm të cilësisë që kryhet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, për zbatimin e metodologjisë dhe performancës së njësisë të auditimit të brendshëm;
- Vlerësimin e pavarur të jashtëm të cilësisë që kryhet nga një person i jashtëm, audites në një njësi të pavarur të sistemit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Dosja e përhershme:

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet. Nga kontrolli i dokumentacionit, konstatohet se audituesit e brendshëm kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*

Dosja e përhershme përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

III.2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit te buxhetit.

Struktura organizative përgjegjëse e buxhetit në Bashkinë Lushnjë për vitin 2025:

Tabela nr.1

Emër Mbiemër	Pozicioni	Formimi arsimor	Periudha e ushtrimit të detyrës
J. H.	Drejtor i Përgjithshëm		
	Drejtoria e Financës dhe e buxhetit		
E. Ç.	Drejtor Drejtorie	Master Admin.Publik	03.01.2025
	Sektori i Buxhetit		
O. Q.	Përgjegjës sektori	Inxhinieri Matematike	17.07.2025
J. Xh.	Specialiste e pagave & zbatim buxheti	Ekonomik	09.02.2024
	Specialist të financës në NJA		
E. A.	Specialist PAK/Ndihmë, të ardhura dhe ndjekie debitorëve ekonomike	Ekonomik	20.03.2024
10 punonjës	Punonjës për arkëtimet dhe arkiv protokolli në NJA		
	Sektori i Menaxhimit financiar		
A. H.	Specialist për menaxhimin e aktiveve	Finance kontabilitet	18.07.2022
A. N.	Specialiste për shpenzimet dhe marëdhënie me thesarin	Ekonomik	01.01.2023
O. Q. (e komanduar)	Specialist për magazinën/arka	Inxhinieri Matematike	09.10.2023

Burimi: DFB/Bashkia Lushnjë

III.2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr. 52 datë 10.02.2024 dhe drejtuesve të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve [EMP] me Urdhrin e Kryetarit nr. 73 datë 13.03.2024 dhe me nr. 2397 prot., datë 13.03.2024; VKB nr. 105 datë 21.12.2023 "Miratimi i kalendarit të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025 të Bashkisë Lushnjë", VKB nr. 18 datë 29.02.2024 "Mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë", VKB nr. 35 datë 29.03.2024 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2025-2027", Udhëzimi i brendshëm nr. 103 datë 15.04.2024 i Kryetares së Bashkisë "Për përgatitjen e PBA 2025-2027", Shkresa nr. 8592 prot. i MF/DFV "Mendime mbi projekt dokumentin e PBA 2025-2027 (faza I)", VKB nr. 67 datë 27.06.2024 "Mbi miratimin e projektit të parë të PBA 2025-2027", Udhëzimi plotësues i MF nr. 8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e PBA Vendor 2025-2027", Udhëzimi i brendshëm plotësues me nr. 205 datë 02.08.2024 "Mbi miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2025-2027", VKB nr. 90 datë 30.09.2024 "Mbi miratimin e dokumentit të PBA 2025-2027 i Rishikuar", VKB nr. 112 datë 26.12.2024 "Mbi miratimin e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025 të Bashkisë Lushnjë". Rezulton se të gjitha aktet e mësipërme janë verifikuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Fier.

- Nga DMF janë hartuar Gjurma e auditimit në përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe Gjurma e auditimit të zbatimit të buxhetit 2025 datë 10.02.2025; Regjistri i riskut i cili çdo vit i nënshtrohet procesit të përditësimit, mbështetur në evidentimin e rrisqeve të reja të të gjitha strukturave të Bashkisë. Për vitin 2025 bazuar në kërkesën e DMF, nuk ka patur përditësim të regjistrit të riskut. Programimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 dhe i detajuar sipas programeve, pasqyrohet në *tabelën nr.1* të Aneksit/Buxheti.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr. 1/Aneksi B* (përmbledhëse), rezulton se*:*

- Në PBA 2025-2027, planifikimi i fondeve në buxhet në total ka ardhur në rritje nga viti në vit: me 34,496 mijë lekë nga 2025 në vitin 2026 me 24,123 mijë lekë nga viti 2026 në vitin 2027;
- Në planin e vitit 2025 pesha më e madhe në buxhet është parashikuar për programin AB129 "Punët publike dhe mirëmbajtja" në vlerën 685,752 mijë lekë ose 36% të buxhetit total të parashikuar; pesha më e vogël në buxhet është parashikuar për programin AF- 129 "Fondi Rezervë dhe Kontigjenca" në vlerën 11,015 mijë lekë ose 0.6% të totalit të buxhetit;
- Në 6 programet e buxhetuara në PBA 2025-2027, rezulton se programet: AA129, AB129, AC129, janë planifikuar me vlera në rritje nga viti në vit, gjë ka diktuar dhe trendin e vlerës totale të buxhetit vjetor në PBA; ndërsa programet AD129 dhe AE129 janë planifikuar me vlera në rënie nga viti në vit; programi AF129 për çdo vit të PBA është planifikuar në të njëjtën vlerë.

▪ Ndarja e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë parashikuar sipas çdo viti në PBA 2025-2027, pasqyrohet në *tabelën nr. 2* të Aneksit/Buxheti.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr.2/Aneks B* rezulton se*:*

- Nga planifikimi i fondeve në PBA 2025-2027, zëri "paga" ka vlerën më të lartë për të 3 vitet e PBA, dhe është në masën 45.4% në vitin 2025, 46.1% në vitin 2026 dhe 46.6% në vitin 2027 ndaj totalit të buxhetit respektiv;
- Zëri "*investime*" parashikuar në rritje nga viti në vit: për vitin 2025 në vlerën 405,313 mijë lekë ose 21.3% e buxhetit total, për vitin 2026 dhe vitin 2027 është në vlerën 437,316 mijë lekë ose 22.6% ndaj totalit të buxhetit të vitit respektiv;
- Zëri "*shpenzime operative*", parashikuar në vlerë në rënie nga viti në vit: 419,560 mijë lekë në vitin 2025 ose në masën 22%, në vlerën 387,557 mijë lekë në vitin 2026 ose në masën 20% dhe në vlerën 387,558 mijë lekë në vitin 2027 ose në masën 19.8% ndaj totalit të buxhetit respektiv;
- Zëri "*transfertat*" është planifikuar në të njëjtat vlera për çdo vit të PBA: llog.604 parashikuar 42,400 mijë lekë ose në masën 2.2%, llog. 604 është parashikuar 13,015 mijë lekë ose në masën 0.7% dhe llog.606 është parashikuar 11,600 mijë lekë ose 22.3% të totalit të buxhetit.

▪ Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Lushnjë për buxhetin e vitit 2025 si viti i parë në PBA 2025-2027, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2/në mijë lekë

Nr i kodit	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2025	Diferenca

		Plan	Fakt	
AA129	Aparati dhe drejtimi i bashkisë	462,732.00	347,239.70	(-)115,492.30
AB129	Sherbimet publike komunitare dhe mirëmbajtja	899,463.00	438,687.30	(-)460,775.70
AC129	Siguria publike	558,100.00	457,925.70	(-)100,174.30
AD129	Arsimi, shërbimi social, kultura dhe sporti	96,045.00	59,278.50	(-)36,766.50
AE129	Bujqësia, veterinaria dhe pyjet	150,977.00	128,209.10	(-)22,767.90
AF129	Rezerva dhe kontigjenca	30,975.00		(-)30,975.00
TOTAL	**6 programe**	**2,198,292.00**	**1,431,340.00**	**(-)766,952.00**

Burimi:Bashkia Lushnjë

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 9652/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së buxhetit", Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027" si dhe UMFE nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar[4], VKB nr. 112 datë 26.12.2024 "Për miratimin e PBA 2025-2027 buxhetin vjetor 2025" si dhe VKB nr. 103 datë 26.11.2024 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Lushnjë për vitin 2025". Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim)*, angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit)*, tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme)*.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave në *tabelën 2* rezulton se planifikimi bëhet mbi nevojat reale të bashkisë. Sipas PBA 2023-2025, PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027, tendenca e të ardhurave paraqitet në *tabelën nr.3/Aneks B*.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr. 3/Aneks B***,** rezulton se:

- Të "ardhurat e veta" është planifikuar me vlera në rënie nga viti në vit; për vitin 2025 janë parashikuar në të njëjtën vlerë 640,579 mijë lekë aq sa edhe në vitin 2024; ndërsa në vitet 2026 dhe 2027 është parashikuar në vlerën 650,548 mijë lekë ose 9,969 mijë lekë më pak se viti 2025;
- "Nga transferat" është planifikuar me vlera në rritje nga viti në vit: për vitin 2025 është planifikuar në vlerën totale 1,083,073 mijë lekë ose 177,868 mijë lekë më shumë se në vitin 2024, në vitin 2026 dhe vitin 2027 janë parashikuar 24,528 mijë lekë dhe 48,650 mijë lekë më shumë se viti 2025;
- Për vitin 2026 dhe vitin 2027 të ardhurat për të 2 kategoritë janë parashikuar në rritje prej 34,496 mijë lekë dhe 58,619 mijë lekë më shumë se viti 2025.

Nisur nga fakti që një njësi publike vetëm "të ardhurat e veta" mund t'i parashikojë sa më pranë vlerës dhe mundësive reale për t'i siguruar, ndërsa vlerat e parashikuara në PBA nga viti 2024 deri në vitin 2027 dhe diferencat e konsiderueshme, grupi i auditimit i vlerëson si rezultat i *mungesës së një analize të mirëfilltë financiare dhe historike* të realizimit apo mosrealizimit të çdo takse e tarife vendore.

Ndërsa shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në Bashkinë Lushnjë për Planin e buxhetit të vitit 2025 si viti i parë në PBA 2024-2026, pasqyrohen si në *tabelën nr. 4/Aneks B* Nga auditimi dhe analiza e të dhënave**, *konstatohet*** se buxheti në total është realizuar në masën 65.2%, ku realizimin më të lartë e ka zëri "paga" në masën 87.6% e "sigurime" në masën 85.7% dhe më të ulët e ka zëri "investime" në masën 38.1%;

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Lushnjë për PBA 2025-2027 dhe Projekt buxhetin e vitit 2025, *ka zhvilluar takime konsultative* me grupet e interesit në komunitet, konform Ligjit nr. 68/2017 "Për

[4] Bashkia Lushnjë është në grupin e 9 bashkive pilot, të cilat do e plotësojnë instrumentin e Planifikimit Financiar sipas metodologjisë së re të përcaktuar në shtojcën 5 të Udhëzimit

financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2024-2026 dhe Projekt buxheti vjetor 2024 nga ana e bashkisë Lushnjë është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.

Tabela nr. 3

Nr.prot	PBA 2025-2027	P.Buxheti 2025	Grupet pjesëmarrëse
	Datat e takimeve		
10136	05.11.2024	05.11.2024	Të rinjtë
974	05.11.2024	05.11.2024	Të ndryshëm / NJA Kolonjë
820	05.11.2024	05.11.2024	-//- / NJA Bubullime
490	06.11.2024	06.11.2024	-//- / NJA Krutje
625	06.11.2024	06.11.2024	-//- / NJA Allkaj
1033	07.11.2024	07.11.2024	-//- / NJA Fiershegan
685	07.11.2024	07.11.2024	-//- / NJA Karbunarë
324	12.11.2024	12.11.2024	-//- / NJA Ballagat
1061	13.11.2024	13.11.2024	-//- / NJA Dushk
9374	14.11.2024	14.11.2024	Qytetarë Rajoni 1,2,3,4,5
605	14.11.2024	14.11.2024	-//- / NJA Hysgjokaj
672	14.11.2024	14.11.2024	-//- / NJA Golem
12 takime			**11 NJA**

Burimi: DFB/Bashkia Lushnjë

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, neni 11-20;

Me shkresën nr. 492 prot., datë 10.06.2024, është përcjellë në Këshillin Bashkiak "rezultatet e sondazhit të prioriteteve të komunitetit të Bashkisë Lushnjë", hartuar mbi nevojat e komunitetit të njohura nga konsultimet publike.

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të njësive shpenzuese: Njësitë administrative, drejtori/sektorë të aparatit të Bashkisë Lushnjë, drejtorive të shkollave, kopshteve, etj, vërtetuar kjo nga kërkesat e dokumentuara.
- Gjatë vitit 2025 programet që kanë planifikuar fonde për "investimet", janë si në tabelën më poshtë:

Mijë lekë/Tabela nr.4

Kodi i ri	Kodi standard	Emërtimi	Kodi i produktit	Vlera në mijë lekë		Kodi standard	Kodi i ri
				Plan	Fakt		
AA129	01110	Planifikim e menaxhim	V111AAD	1,500	1,169	01110	AA129
	06140	Planifikim urban	P614AAD			06140	
	03140	Sherbimet e policise vendore	V314AAB	1,200		03140	
	04760	Turizmi	22AE815	6,576	4,861		
AB129	04240	Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit		40,373	28,975		AB129
	04520	Rrjeti rrugor rural	P452AAB	218,432	50,881	04520	
			P452AAD				
			P452ABB				
	06260	Sherbimet publike vendore	P626AAG	67,085	11,843	06260	
			P626AAD				
	06330	Furnizim me ujë	P633AAC			06330	
	00430	Mbështëtje për zhvillim ekonomik/fonde SASPAK	V043AAF			00430	
	07220	Sherbime kujdesi paresor	P722AAA	15,285	15,285	07220	
	05100	Menaxhimi i mbetjeve		16,000	15,796	05100	
AC129	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	V328AAA			03280	AC129
	09230	Arsimi i mesem i pergjithshem		30,600	30,537		
AD129	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	V912AAA	105,801	70,113	09120	AD129
	09230			34,444	8,571	09230	
	04760	Zhvillimi I turizmit	P476AAD			04760	
	00430	Mbështëtje për zhvillimin ekonomik/fonde BE	V043AAA			00430	
	08130	Sport dhe argëtim	P813AAP	8,859	7,053	08130	
AE129	04240	Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit	P424AAA	16,971		04240	AE129
	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	V426AAA			04260	
			V426AAA				
5	**17**	**Totali**		**524,007**	**200,193**	**17**	**5**

Burimi: DFB/Bashkia Lushnjë

Nga të dhënat *në tabelën 4*, rezulton se nga Bashkia Lushnjë nga 6 programe buxhetore, ka parashikuar fonde për investime në 5 programe, në vlerën totale 524,007 mijë lekë dhe realizuar 200,193 mijë lekë ose në masën 38.2%.[5].
Fondet që kanë tepruar në fund të vitit 2025 dhe që trashëgohen për vitin 2026, paraqiten në *tabelën nr. 5/Aneks B.*

Sipas tabelës financiare, vlera e fondeve të trashëguara nga viti 2025 për vitin 2026 është **757,385,776.51 lekë**.
Në artikullin ***"Paga dhe Sigurime"*** janë trashëguar fonde si rezultat i ekzistencës së vendeve vakante, të cilat nuk janë plotësuar gjatë vitit buxhetor. Gjatë vitit 2025, në Bashkinë Lushnjë dhe në ndërmarrjet e saj të varësisë kanë qenë afërsisht 65 vende vakante.
Këto vende vakante kanë qenë kryesisht të përqendruara në kabinetin e Kryetares së Bashkisë dhe në pozicione drejtuese, si Drejtor i Përgjithshëm, Nënkryetar i Bashkisë, si dhe funksione të tjera drejtuese. Si pasojë e mosplotësimit të këtyre vendeve të punës, fondet e planifikuara për paga dhe sigurime shoqërore nuk janë përdorur plotësisht dhe janë trashëguar për vitin pasardhës.
Në ***artikullin 602***, në Bashkinë Lushnjë është konstatuar mosrealizim i fondeve si rezultat i mospërdorimit të plotë të ***fondit rezervë***, ***fondit të kontingjencës***, ***fondit për emergjencat civile***, si dhe fondeve të tjera të planifikuara në programe të tjera.
- Në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike, ku është trashëguar edhe vlera më e madhe e fondeve në artikullin **"*Shpenzime Operative*"**, mosrealizimi i fondeve ka ardhur kryesisht si pasojë e kontratave në vazhdim për blerjen e materialeve (cakull, asfaltobeton ,etj)të nevojshme, të cilat përdoren nga ndërmarrja për shtrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe rrugëve brenda qytetit. Si rrjedhojë, fondet e planifikuara për këto shpenzime nuk janë përdorur plotësisht dhe janë trashëguar për vitin pasardhës.
Mosrealizimi i shpenzimeve në artikullin e investimeve ka ardhur si pasojë e disa faktorëve, konkretisht:
Investime të paprokuruara – Nga fondet e trashëguara, rreth **25%** e vlerës totale nuk është prokuruar, duke bërë të pamundur realizimin e tyre gjatë vitit buxhetor.
Investime në proces zbatimi – Për një pjesë të investimeve, kontratat janë lidhur pranë përfundimit të vitit buxhetor, duke mos krijuar mundësi për realizimin e punimeve dhe kryerjen e pagesave brenda vitit. Si rrjedhojë, fondet përkatëse janë trashëguar për t'u përdorur në vitin pasardhës.
Tepricë nga procedurat e prokurimit – Në disa raste, vlera e kontratave të lidhura ka rezultuar më e ulët se fondet e planifikuara për realizimin e investimeve, duke sjellë kursimin e një pjese të fondeve të parashikuara.

- Buxheti fillestar i miratuar dhe ndryshimet gjatë vitit 2025, pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 5

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2025			
Nr.	**PBA 2025-2027**	**P. Buxheti 2025**	**Vlera (**mije lekë)
1	VKB Nr.112 dt.26.12.2024	VKB nr.112 dt.26.12.2024	1,903,652
2		VKB nr.115 datë 26.12.2024 (ndryshim buxheti)	
03		VKB nr.114 datë 26.12.2024	
4		VKB nr. 26 datë 25.02.2025	
5		VKB nr. 34 datë 01.04.2025	
6		VKB nr. 47 datë 30.05.2025	294,640
7		VKB nr. 58 datë 30.06.2025	
8		VKB nr. 76 datë 23.07.2025	
9		VKB nr. 96 datë 29.09.2025	
10		VKB nr.111 datë 21.11.2025	
11		VKB nr.112 datë 21.11.2025	
	1	**10**	**2,198,292**

Burimi: DFB/ Bashkia Lushnjë

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit në *tabelën nr. 5*, rezulton se buxheti vjetor 2025 ka pësuar 10 ndryshime, të cilat janë miratuar me VKB konform kuadrit ligjor në fuqi për buxhetin.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se:

[5] Informacion i detajuar në rubrikën "realizimi i investimeve"

a. Bashkia Lushnjë ka hartuar "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor" për Bashkinë Lushnjë dhe njësive administrative për vitin 2025 dhe miratuar me VKB nr. 105 datë 21.12.2023, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 33; Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.
b. Me VKB nr. 35 datë 29.03.2024 janë miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Lushnjë; Janë dokumentuar takimet e GMS për çdo fazë të PBA
c. Janë miratuar me:- VKB nr. 67 datë 27.06.2024 projekti I i PBA 2025-2027; - me VKB nr. 90 datë 30.09.2024 projekti II i PBA 2025-2027 (rishikuar); PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 112 datë 26.12.2024 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2025; Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2025 ka pësuar 10 ndryshime, të cilat janë miratuar sipas VKB për shtesa/pakësime, përdorim fondesh të trashëguara nga viti paraardhës 2024 apo përdorim të fondit rezervë për tu përdorur në buxhetin e vitit 2025 etj. Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2025 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitullit, artikullit e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;
d. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2025-2027 dhe Planit vjetor 2025 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime.
e. VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Fier, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Lushnjë.

Planifikimet fillestare sipas PBA-së dhe planit vjetor 2025
Bashkia Lushnjë ka planifikuar dhe miratuar me VKB nr. 112 datë 26.12.2024, PBA 2025-2027 dhe Planin vjetor 2025 si në *tabelën nr.6/Aneks B.*
Referuar të dhënave të pasqyruara në *tabelën 8, rezulton se* Bashkia Lushnjë në planin fillestar në PBA ka parashikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 13.4% të shpenzimeve të planifikuara *për vitin 2025*. Ndërkohë nga Akt rakordimi me Degën e Thesarit rezulton se fondet buxhetore të papërdorura nga viti ushtrimor 2024 që trashëgohen për vitin 2025 janë në *tabelën nr.5.2/Aneksi B*:

Në Relacionin bashkëlidhur P/Vendimit, pasqyrohen arsyet e mospërdorimit të këtyre fondeve gjatë viti 2024, të cilat sipas tabelës financiare, vlera e fondeve të trashëguara nga viti 2024 për vitin 2025 është **566,697,377.86 lekë**:
Në artikullin ***"Paga dhe Sigurime"*** janë trashëguar fonde si rezultat i ekzistencës së vendeve vakante, të cilat nuk janë plotësuar gjatë vitit buxhetor. Gjatë vitit 2024, në Bashkinë Lushnjë dhe në ndërmarrjet e saj të varësisë kanë qenë afërsisht 45 vende vakante.
Këto vende vakante kanë qenë kryesisht të përqendruara në kabinetin e Kryetares së Bashkisë dhe në pozicione drejtuese, si Drejtor i Përgjithshëm, Nënkryetar i Bashkisë, si dhe funksione të tjera drejtuese. Si pasojë e mosplotësimit të këtyre vendeve të punës, fondet e planifikuara për paga dhe sigurime shoqërore nuk janë përdorur plotësisht dhe janë trashëguar për vitin pasardhës.
Në ***artikullin 602***, në Bashkinë Lushnjë është konstatuar mosrealizim i fondeve si rezultat i mospërdorimit të plotë të ***fondit rezervë***, ***fondit të kontingjencës***, ***fondit për emergjencat civile***, si dhe fondeve të tjera të planifikuara në programe të tjera.
- Në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike, ku është trashëguar edhe vlera më e madhe e fondeve në artikullin ***"Shpenzime Operative"***, mosrealizimi i fondeve ka ardhur kryesisht si pasojë e kontratave në vazhdim për blerjen e materialeve (cakull, asfaltobeton ,etj) të nevojshme, të cilat përdoren nga ndërmarrja për shtrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe rrugëve brenda qytetit. Si rrjedhojë, fondet e planifikuara për këto shpenzime nuk janë përdorur plotësisht dhe janë trashëguar për vitin pasardhës.

Mosrealizimi i shpenzimeve në artikullin e investimeve ka ardhur si pasojë e disa faktorëve, konkretisht:
Investime të paprokuruara – Nga fondet e trashëguara, rreth **20%** e vlerës totale nuk është prokuruar, duke bërë të pamundur realizimin e tyre gjatë vitit buxhetor.
Investime në proces zbatimi – Për një pjesë të investimeve, kontratat janë lidhur pranë përfundimit të vitit buxhetor, duke mos krijuar mundësi për realizimin e punimeve dhe kryerjen e pagesave brenda vitit. Si rrjedhojë, fondet përkatëse janë trashëguar për t'u përdorur në vitin pasardhës.
Tepricë nga procedurat e prokurimit – Në disa raste, vlera e kontratave të lidhura ka rezultuar më e ulët se fondet e planifikuara për realizimin e investimeve, duke sjellë kursimin e një pjese të fondeve të parashikuara.

Informacioni përmbledhës i shpenzimeve sipas burimit të financimit, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.5/në mijë lekë

Nr	Burimet e Financimit	Viti 2025		Diferenca	%
		plan	fakt		
1	Nga te ardhurat e veta	640,579.00	513,893.00	(-)126,686.00	80.2
2	Transferte e pakushtezuar	684,949.00	684,949.00	0	100
3	Transferte sektoriale	398,124.00	398,124.00	0	100
4	Të ardhura të trashëguara nga v.2024	445,710.11	566,697.00	120,968.89	127.2
5	Shtesa nga transferta të tjera gjatë vitit	28,930.00	28,930.00	0	100
I	***Totali i burimeve te bashkise***	**2,198,292.11**	**2,192,593.00**	**(-)**	**99.8**
4	Te ardhura dhe shpenzime jashte limitit		3,867.00		
II	**Totali**	**2,198,292.11**	**2,196,460.00**	**(-)1,832.11**	**99.9**

Burimi:DFB/Bashkia Lushnjë

Referuar Akt Rakordimit me Degën e Thesarit "mbi të ardhurën e trashëguar" dhe të dhënave të pasqyruara në *tabelën nr.5.2/Aneksi B* dhe në *tabelën nr. 5*, ***rezulton se*** shpenzimet me burim të "ardhurat" nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar: *për vitin 2025* në vlerën totale 1,086,289 mijë lekë; në fakt janë shpenzuar në vlerën 542,823 mijë lekë ose 50% e tyre;
Nga fondet e "pakushtëzuara" janë planifikuar 684,749 mijë lekë dhe shpenzuar po aq ose në masën 100% e tyre;
Nga fondet "specifike e sektoriale" janë planifikuar 398,124 mijë lekë dhe shpenzuar po aq ose në masën 100% e tyre;
Të ardhura jashtë limitit janë shpenzuar 3,867 mijë lekë.

Tabela nr.6/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani përfundimtar 2025	Sipas PBA 2025-2027	Ndryshimi
	Plani fillestar			
1	Shpenzime për pagat (600 + 601) (nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifike)	**1,011,764**	**1,011,764**	
2	Shpenzime (602, 604, 606, 609) (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar e specifike)	**486,575**	**486,575**	
3	Investime Bashkia (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar)	**405,313**	**405,313**	
4	Investime nga FZHSH			
	Total i planit fillestar	**1,903,652**	**1,903,652**	
	Shtesat nga Pushteti Qendror etj			
5	Investime grant i pakushtëzuar			
6	Shpenzime për pagat (600 + 601)			
7	Shpenzime (602, 604, 606, 609)			294,640
8	Investime nga FZHSH			
9	Të tjera (166,651,603,604,606)			
	Gjithsej	**2,198,292**	**1,903,652**	**294,640**

Burimi: DBF/Bashkia Lushnjë

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, rezulton se të ardhurat për shpenzime të planifikuara bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2024 për vitin 2025 janë 1,903,652 mijë lekë.
Ndërsa buxheti fillestar *për vitin 2025* është planifikuar në vlerën e 1,903,652 mijë lekë, me fondet e trashëguara nga viti 2024, fondet jashtë limitit dhe shtesë nga granti arrin në vlerën progresive e 2,198,292 mijë lekë. Krahasuar me planin fillestar buxheti vjetor progresiv i planifikuar është 294,640 mijë lekë më shumë se ai fillestar.

Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Lushnjë për vitin 2024 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa "dh" të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMFE nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, Udhëzimit MF nr. 6 datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"[6] si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Lushnjë.
Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor.
Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2025, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

- Struktura organizative për vitin 2025, paraqitet në tabelën më poshtë, të dhënat e numrit të punonjësve sipas strukturës së miratuar:

Tabela nr. 7

Nr.	Emërtimi	Viti 2025			
		Plani	Fakti	Status NC	Kod Pune
1	Aparati Bashkisë	274	271	143	940
2	Njësia Adminin	22			
3	Njësi vartëse	787	749		
	QK "Vaçe Zela"	*63*			
	QA	*405*			
	NPP	*301*			
4	Të tjera	18			
	QPAK	*18*			
TOTALI		**1083**	**1020**	**143**	**940**

Burimi:SBNJ/Bashkia Lushnjë

Struktura organizative është miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 314 datë 11.12.2024 dhe me nr. 10071 prot., datë 11.12.2024 dhe niveli i pagave, është miratuar me VKB nr. 111, datë 26.12.2024, në zbatim të VKM nr.503, datë 01.08.2024, "Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativ të vetëqeverisjes vendore" Bashkia Lushnjë. VKM nr. 113, datë 01.03.2023, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM 175 datë 08.03.20217 i ndryshuar, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në Arsimin Parauniversitar", VKM 350 datë 19.04.2017 i ndryshuar, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 165 dt. 02.03.2016, për grupin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksioneve" dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier.
Paketa fiskale për vitin 2025 është miratuar me VKB nr.103, datë 26.11.2024.

III.2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

[6] Bashkia Lushnjë është në grupin e 9 bashkive pilot, të cilat do e plotësojnë instrumentin e Planifikimit Financiar sipas metodologjisë së re të përcaktuar në shtojcën 5 të Udhëzimit

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës. Një informacion i përmbledhur pasqyrohet në *tabelën nr. 8* dhe i detajuar pasqyrohet në *tabelën 8/Aneks B*, bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Në tabelën e mëposhtme nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transferta e kushtëzuar.

Tabela nr.8/në mijë lekë

Bashkia Lushnjë. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar. Viti 2025									
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
Art	Emertimi	Fakti i vitit para ardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025 (sipasVKB .)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Çelja në thesar	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
Totali (korrente + kapitale)		1,344,920	1,903,652	1,903,652	2,198,292	294,640.1	1,435,208	(-)766,952	65.29

Burimi:DFB/ Bashkia Lushnjë

Nga analiza e të dhënave në *Aneks B/tabelën nr.7,* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit, ***rezulton se***:

- "shpenzimet korrente" janë realizuar në masën 73.7% të buxhetit, nga të cilat "paga e sigurime" është realizuar në masën 87.3% dhe "shpenzime operative" në masën 52%, në të cilën ka ndikuar realizimi i ulët i fondeve "mallra e shërbime" në masën 51%. Nga analiza e të dhënave vërehet një realizim prej 75.2% për "mallra e shërbime" që përbën afro 14% e totalit të fondeve për këtë zë buxhetor;
- "shpenzime kapitale" janë realizuar në masën 37.8%, e cila përbëhet nga "kapitale të trupëzuara" në masën 100%;

Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat lidhen ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale

- Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime) të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në *tabelat nr.7/Aneksi B.* Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga informacioni i pasqyruar dhe në *tabelën nr. 7/Aneksi B*, ***rezulton se*:**

Me VKB nr. 90 datë 29.09.2025 është miratuar "Përdorimi i fondit rezervë për shpërblimin e nxënësve ekselentë" me nr. 8060/2 prot., dt. 30.09.2025 prej 810,000 lekë. Praktika dokumentare bashkëlidhur VKB, përmban: shkresën e DRAP/ZVA Lushnjë me nr. 1568/1 prot., datë 16.09.2025 me listën emërore të 27 nxënësve ekselentë përcjellë Bashkisë Lushnjë; Projekt Vendimi nr. 83 datë 17.09.2025 me nr. 8060/1 prot., datë 17.09.2025 përpiluar nga Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Drejtoria Juridike; Relacioni shoqërues të Projekt Vendimit për në Këshillin Bashkiak me nr. 8060 prot., datë 17.09.2025 të Kryetarit të Bashkisë për masën e shpërblimit individual prej 30,000 lekë; VKB nr. 90 datë 29.09.2025 me nr. 8060/2 prot., datë 30.09.2025 "Për përdorimin e fondit rezervë për shpërblimin e nxënësve ekselente"; shkresën drejtuar Degës së Thesarit Lushnjë me nr. 9098 prot., datë 15.10.2025 me objekt "kërkesë për ndryshim plani dhe limiti në buxhetin e vitit 2025".

Konstatohet se:

- Në Projekt Vendimin nr. 83 datë 17.09.2025 baza ligjore mbi të cilën është hartuar ky projekt vendim, mbështetet në të drejtat dhe detyrimet e NJVQV/Këshillit Bashkiak- Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 54 pika "m"; planifikimin dhe përdorimin e fondit rezervë nga NJQV- Ligji 9936 datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar neni 6; Udhëzimit të MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të

zbatimit të buxhetit" pika 132; por nuk ka cituar aktet ligjore ku përcaktohen kriteret e kategorisë përfituese, konkretisht Ligjin nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 28, në moszbatim të Ligjit nr.44/2014 "*Kodi i Procedurave administrative*" i ndryshuar, neni 99 dhe 100;
- Shpenzimi për shpërblimin e nxënësve të ekselencës, megjithëse i parashikueshëm dhe i përvitshëm, nuk është planifikuar në programin përkatës buxhetor (AD129/606), por është financuar nga fondi rezervë,
- Në Relacionin e miratuar nga Kryetari i Bashkisë bashkëlidhur Projekt Vendimit për Këshillin Bashkiak, nuk është cituar referenca ligjore apo administrative mbi të cilën është përcaktuar masa e shpërblimit;
- Pavarësisht këtyre mangësive, Këshilli Bashkiak ka miratuar vendimin pa kërkuar plotësimin e bazës ligjore, planifikimin e fondeve në PBA /Planin vjetor dhe argumentimin e masës së shpërblimit. Mosveprimet janë në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 41,54/ç; Ligji nr. 68/2017 "*Për financat vendore*" i ndryshuar, neni 5/a, neni 6/ç,d, neni 7/3, neni 34-neni 41; Ligji nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 11, etj.

Për hartimin e projekt buxhetit vjetor 2025, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës dhe drejtpërdrejtë kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë, konform nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar.
- Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjithashtu, se është bërë analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj; gjatë vitit 2025 është bërë raportimi periodik shkresor 4, 8 dhe 12-mujor (zyrtar shkresor dhe elektronik) i realizimit të buxhetit në MF.[7]

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.


Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2025 rezultoi se PBA 2025-2027 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Lushnjë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Fier.

Nga auditimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2025, në zbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 **"**Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 44.

III.2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Lushnjë si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Për periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Lushnjë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të miratuar me Vendim të KB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, rezulton se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

[7] Informacioni i detajuar pasqyrohet mëposhtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit



- Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2025 *referuar akt-rakordimeve* me thesarin paraqitet në *tabelën nr. 9/Aneksi B*

Referuar të dhënave të pasqyruara në *tabelën nr. 9/Aneksi B*, **rezulton se** *për vitin 2025* niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 38.04% deri në 87.62%; llog. 230-231 "investime" ka mosrealizimin më të lartë në masën 38.04% dhe llog.600 "paga " ka realizimin më të lartë në masën 87.62%.

Tabela nr. 9/në mijë lekë

Artikulli	2024			2025		
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.
Totali	1,942,101	1,343,448	(-)598,653	2,198,292	1,432,804	(-)765,488
Jashte limiti		736			2,403	1,667
Totali	1,942,101	1,344,184	(-)579,917	2,198,292	1,435,207	(-)763,085
Dif. 2025-2024 plan	**256,191**					
Dif. 2025-2024 fakt	**91,023**					
Realizimi në %	**69.2%**			**65.3%**		

Burimi:DFB/Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën nr.9 (përmbledhëse)*, *rezulton se*:
- Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2024 në vitin 2025 me një diferencë prej 256,191 mijë lekë;
- Niveli i realizimit (ndaj planit) në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rënie nga viti 2024 në vitin 2025, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Lushnjë, por realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;
- Referuar vlerave të mosrealizimit të secilit zë buxhetor, rezulton se ka ardhur në rritje nga viti 2024 në vitin 2025, sipas të dhënave të tabelës.

▪ Sipas Njësive buxhetore shpenzuese për programet respektive**:** Aparati i Bashkisë dhe 3 njësive vartëse – NPP, QA, QK pasqyrohen në *tabelat nr.11.1-11.2-11.3-11.4/Aneksi B*

Referuar të dhënave në tabelat respektive, *rezulton se*:

a. - Aparati i bashkisë ka planifikuar për vitin 2025 buxhetin në vlerë 1,007,812 mijë lekë ose 45.8% e totalit të buxhetit të parashikuar;
- NPP ka planifikuar për vitin 2025 buxhetin në vlerë 595,797 mijë lekë ose 27.1% të totalit të buxhetit të parashikuar;
- QA ka planifikuar për vitin 2025 buxhetin në vlerë 452,065 mijë lekë ose 20.6% të totalit të buxhetit të parashikuar;
- QK ka planifikuar për vitin 2025 buxhetin në vlerë 142,618 mijë lekë ose 6.5% të totalit të buxhetit të parashikuar;

b.- Aparati i Bashkisë ka realizuar buxhetin në vlerën 530,087 lekë ose 37% të totalit të buxhetit të realizuar;
- NPP ka realizuar buxhetin në vlerën 374,205 mijë lekë ose 26.1% të totalit të buxhetit të realizuar;
- QA ka realizuar buxhetin në vlerën 409,759 mijë lekë ose 28.6% të totalit të buxhetit të realizuar;
- QK ka realizuar buxhetin në vlerën 121,156 mijë lekë ose 8.5% të totalit të buxhetit të realizuar;

c.- Aparati i Bashkisë e ka realizuar buxhetin 52.6% ndaj planit të vet;
- NPP e ka realizuar buxhetin 62.8% ndaj planit të vet;
- QA e ka realizuar buxhetin 90.6% ndaj planit të vet;

- QK e ka realizuar buxhetin 85% ndaj planit të vet;

d.- Aparati i Bashkisë realizimin më të lartë e ka për zërin "paga " dhe "sigurime" në masën 79% dhe atë më të ulët për zërin "Investime" në masën 34.3%;

- NPP realizimin më të lartë e ka për zërin "paga" dhe "sigurime" në masën 90.3% dhe më të ulët për zërin "shpenzime operative" në masën 46%;
- QA realizimin më të lartë e ka për zërin "paga" dhe "sigurime" në masën 94% dhe më të ulët për zërin "shpenzime operative" në masën 71.4%;
- QK realizimin më të lartë e ka për zërin "paga" dhe "sigurime" në masën 94.2% dhe më të ulët për zërin "shpenzime operative" në masën 81.5%; për zërin "investime" ka patur 0 lekë shpenzime nga fondi i parashikuar;

Sipas burimeve të financimit:

- Sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, transferta e kushtëzuar treguesit e buxhetit *janë planifikuar* si në *tabelën nr.12/Aneksi B* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Tabela nr. 10/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Totali (pa Transf.kushtezuar)	Burimi i financimit				% të ardhura të veta ndaj totalit për zë	% të ardhura të veta ndaj totalit për lloj
				Transferta pakushtëzuara +Transferta e specifike/sektoriale	Të Ardhura të veta	Transferta e kushtëzuar	Transferta te huaja		
TOTALI		**2,995,428.53**	**2,198,292.00**	**1,468,180.85**	**730,111.15**	**797,136.53**	**0**	24.4	**100**
në %		**100**	**73.4**	**49**	**24.4**	**26.6**			

Burimi: Bashkia Lushnjë

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën 10*, ***rezulton se:***

- Vlera e buxhetit progresiv në total për vitin 2025 është 2,995,429 mijë lekë, ku peshën më të madhe e kanë fondet nga "transferta e pakushtëzuar" në vlerën 1,468,181 mijë lekë ose në masën 49% të vlerës totale; dhe më të ulët fondet nga "të ardhurat e veta" në vlerën 730,111 mijë lekë ose në masën 24.4% të vlerës totale;
- Nga fondet me burim financimi **"*të ardhurat e veta*"** peshën më të madhe e zënë "*Shpenzimet operative* në vlerën 260,882 mijë lekë ose në masën 47.3% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 35.7% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

Në vlerën 229,388 mijë lekë është zëri *"pagat*" ose në masën 25.6% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 31.4% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

"*Investimet*" janë në vlerën 178,456 mijë lekë dhe zënë 30.2% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 24.5% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

Peshën më të vogël në buxhet e ka zëri *Trans.Buxh.Familjare/individ*" në vlerën 2,714 mijë lekë ose në masën 0.4% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

- Sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta dhe transferta e kushtëzuar treguesit e buxhetit *janë realizuar* si në *tabelën nr. 12.2/Aneks B.*

Tabela nr. 11/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Totali (pa transf. kushtezuar)	Burimi i financimit				% të ardhura të veta ndaj totalit për zë	% të ardhura të veta ndaj totalit për lloj
				Transferta pakushtëzuara +Transferta e specifike/sektoriale	Të Ardhura të veta	Transferta e kushtëzuar	Transferta te huaja		
TOTALI		**2,216,156.11**	**1,435,207.63**	**1,005,469.37**	**429,738.26**	**780,948.48**	**-**	**19.4**	**100**

në %	**100**	**64.8**	**45.4**	**19.4**	**35.2**			

Burimi: Bashkia Lushnjë

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën 11*, rezulton se:

- Vlera e shpenzimeve faktike në total për vitin 2025 është 2,216,156 mijë lekë, ku peshën më të madhe e kanë fondet nga "transferta e pakushtëzuar" në vlerën 1,005,469 mijë lekë ose në masën 45.4% të vlerës totale dhe në vlerën më të ulët janë shpenzimet nga "të ardhurat e veta" në vlerën 429,738 mijë lekë ose në masën 19.4% të vlerës totale;
- Nga fondet e shpenzuara me burim financimi **"*të ardhurat e veta*"** peshën më të madhe e zënë "*pagat*"në vlerën 159,021 mijë lekë ose në masën 20.2% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 37% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

Në vlerën 128,646 mijë lekë e ka zëri "*Shpenzimet operative*" ose në masën 46.5% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 29.9% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

"I*nvestimet*" janë në vlerën 83,188 mijë lekë dhe zënë 31.5% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 19.4% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

"*Transferta korrente të brendshme*" janë në vlerën 46,200 mijë lekë ose në masën 89.4% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 10.8% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta";

Peshën më të vogël e ka zëri "*Trans.Buxhet. Familjare e individ*" në vlerën 2,714 mijë lekë ose në masën 0.4% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 0.6% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta"; "*sigurime shoqërore*" në vlerën 9,969 mijë lekë ose në masën 7.6% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 2.3% ndaj vlerës totale të fondeve me burim "të ardhurat e veta".

Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore

Nga auditimi realizimi i Buxhetit pasqyrohet në *tabelën nr.12*,

Tabela nr. 12/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025	Diferenca	Trendi I planit dhe faktit
1	Shpenzimet e planifikuara	1,942,101	2,198,292	256,191	↗
2	Shpenzimet faktike	1,344,920	1,435,208	90,288	↗
	Diferenca	**(-)597,181**	**(-)763,084**		↗

Burimi: Bashkia Lushnjë/Punoi: Grupi i auditimit

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në *tabelën nr. 12* rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2024 dhe 2025 të ketë *mosrealizime*, por vlera e të cilit vjen me trend në rritje dhe në mënyrë të përmbledhur paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 13/në mijë lekë

Emërtimi	2024	2025		Diferenca ndaj faktit (I)	Diferenca ndaj planit (II)	Trendi i mosrealizimit (I)
	Fakt	Plan	Fakt			
Shpenzime	1,344,920	2,198,292	1,435,208	**90,288**	**(-)763,084**	↘
Të Ardhura	1,391,268	1,771,238	1,765,539	**374,271**	**(-)5,699**	↘

Burimi: Bashkia Lushnjë

- Bashkia Lushnjë *nuk ka aplikuar* për kredi në vitin 2025;
- Bashkia Lushnjë *ka patur* donacione nga ambasada japoneze për vitin 2025.
- Bashkia Lushnjë ka patur subvencione në vitin 2025.

▪ Një pasqyrim i përmbledhur mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike të 2 viteve të fundit në tabelën e mëposhtme, *rezulton* se vlera e të ardhurave ka trend në rënie nga viti 2024 në vitin 2025, ndërsa vlera e shpenzimeve ka trend në rritje.

Tabela nr. 14/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025	Trendi
1	Të ardhurat faktike	1,391,268	1,765,539	↗
2	Shpenzimet faktike	1,344,920	1,435,208	↗

Burimi: Bashkia Lushnjë

Miratimi i buxhetit faktik:
Bashkia Lushnjë ka miratuar Raportin vjetor të monitorimit dhe realizimit të buxhetit faktik për vitin 2025, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 44; ndërsa për vitin e mbyllur ushtrimor 2025 është brenda afatit ligjor.
Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:
Në zbatim të nenit 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 "Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore" pika 14, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", rezulton se nga DFB/Bashkia Lushnjë janë bërë raportimet 4, 8 dhe 12-mujore në MF sipas formateve të miratuara:
- Realizimi i buxhetit për periudhën 4-mujore Janar – prill 2025, Shkresa për MF nr.4254 prot,datë 22.05.2025;
- Realizimi i buxhetit për periudhën 8-mujore Janar–Gusht 2024,. Shkresa për MF nr.8556 prot,datë 30.09.2025.
- Realizimi i buxhetit për periudhën 12-mujore Janar–Dhjetor 2025, VKB nr. 38 datë 27.03.2026 dhe me nr. 2708/2 prot., datë 30.03.2026; Shkresa për MF nr. 2179 prot.,datë 27.02.2026 dhe mendimet rreth Raportit vjetor të monitorimit të buxhetit 2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të buxhetit në Ministrinë e Financave përcjellë me shkresën nr. 5310 prot., datë 30.03.2026.
Rezulton se raportimet janë dërguar në MF dhe në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe ajo postare brenda afatit ligjor.
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raportet e Monitorimit të buxhetit të vitit 2025 janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier.
Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:
Me miratimin e buxheteve parashikohen dhe Fondi Rezervë [FR], Fondi i kontigjencës [FK], Fondi i Emergjencës [FE] dhe Mbrojtja civile [MC] (nga AKMC), vlerat e planifikuar dhe përdorimit të tyre në vitin 2025, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 15/Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2025	Fakt 2025	
Fond Rezervë	7,570	7,110	
Fond Emergjence	24,000	1,478	
Fond Kontigjence	3,445	-	
Totali (transf e pakushtz+ardh e veta)	**35,015**	**8,588**	***(-)26,427***
Mbrojtja Civile (MB)	14,194	7,002	
Totali	**49,209**	**15,590**	***(-)33,619***

Burimi: DFB/Bashkia Lushnjë

Përdorimi i këtyre fondeve është realizuar me miratimin e Këshillit Bashkiak.
Me VKB nr. 112 datë 26.12.2024 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" **rezultoi se** në buxhetin vjetor të vitit 2025 vlera e planifikuar e [FR] është në vlerën totale 7,570 mijë lekë ose në masën 0.4% të vlerës totale të buxhetit fillestar të miratuar; janë shpenzuar 7,110 mijë lekë ose 94% të fondit të planifikuar; ndërsa për [FK] është në vlerën 3,445 mijë lekë ose në masën 0.2% të vlerës totale të buxhetit fillestar të miratuar dhe për vitin 2025 nuk ka patur shpenzime të tij.
Referuar kuadrit ligjor në fuqi për buxhetin, *rezulton* në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se këto fonde [FR] dhe [FK] llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara.
Fondi i Emergjencës [FE] është planifikuar në vlerën 24,000 mijë lekë ose në masën 1.3% të vlerës totale të buxhetit fillestar të miratuar dhe përfaqëson fondet që bashkia planifikon nga të ardhurat e veta në rastet e fatkeqësive natyrore, të cilat për vitin 2025 janë shpenzuar 1,478 mijë lekë ose në masën 6.2% të vlerës së [FE] së planifikuar.;

≠ Përdorimi i fondit rezervë sipas VKB:

- VKB nr. 03 datë 23.01.2025 përdoret fondi rezervë me 700,000 lekë
- VKB nr. 71 datë 23.07.2025 përdoret fondi rezervë me 100,000 lekë
- VKB nr. 90 datë 29.09.2025 përdoret fondi rezervë me 810,000 lekë

- VKB nr. 111 datë 21.11.2025 përdoret fondi rezervë me 5,500,000 lekë

≠ Përdorimi i fondit të emergjencës sipas VKB:

- VKB nr. 12 date 23.01.2025 përdoret fondi me 140,102 lekë
- VKB nr. 21 date 25.02.2025 përdoret fondi me 25,425 lekë
- VKB nr. 22 date 25.02.2025 përdoret fondi me 499,713 lekë
- VKB nr. 102 date 30.10.2025 përdoret fondi me 812,525 lekë

Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".

Nga sa më lart, nga auditimi *rezulton* se Bashkia Lushnjë për vitin 2025 fondin për mbrojtjen civile [FMC&FE] e ka planifikuar në vlerën totale 38,194 mijë lekë nga të cilat: [FMC] në vlerën 14,194 mijë lekë dhe [FE] në vlerën 24,000 mijë lekë, nga i cili janë shpenzuar në total 8,480 mijë lekë dhe vlera e mbetur prej 29,714 mijë lekë është trashëguar për vitin pasardhës 2026. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 65/1.

Realizimi i Investimeve:

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2025 për Bashkinë Lushnjë, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferta e pakushtëzuara" [TP], pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.16/ në mijë lekë

230-231	2024	2025			
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca ndaj planifikimit	Diferenca ndaj faktit
	195,763	524,007	199,331	(-)324,676	3,568

Burimi: Bashkia Lushnjë

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *tabelën nr. 16*, rezulton se për vitin 2025 realizimi i buxhetit për zërin "investime" ndaj planifikimit është me (-)324,676 mijë lekë më pak ose në masën 38% dhe se vlera e realizimit të tij në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 është me 3,568 mijë lekë më shumë;

Një pasqyrim i detajuar mbi planin dhe realizimin e zërit "investime" sipas çdo programi, në *tabelat nr.13.1 – 13.2/Aneks B* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

≠ Nga të dhënat e pasqyruara në *tabelën 13.1/Aneks B,* rezulton se:

- Për programin AA129 "Aparati dhe drejtimi i bashkisë" janë planifikuar fonde për 3 investime në vlerën 5,301 mijë lekë, konkretisht: 1 projekt investimi për nënprogramin 01110 "planifikim, menaxhim, administrim" në vlerën 1,500 mijë lekë, 1 projekt investimi për nënprogramin me kod 03140 "Shërbimet e Policisë Vendore" në vlerën 1,200 mijë lekë dhe 1 projekt investimi për nënprogramin me kod 04760 "turizmi" në vlerën 2,601 mijë lekë;

Deri në 31.12.2025 nga programi AA129 është realizuar 1 investim në funksionin/nënprogramin me kod 01110 në vlerën 1,169 mijë lekë ose në masën 78% të fondit të planifikuar;

- Për programin AB129 "Punët publike dhe mirëmbajtja" janë planifikuar fonde për 26 investime në vlerën totale 339,097 mijë lekë, konkretisht: 14 projekt investime për nënprogramin me kod 04520 "rrjeti rrugor rural" në vlerën totale 239,727 mijë lekë, 7 projekt investime për nënprogramin me kod 06260 "shërbimet publike vendore" në vlerën totale 67,085 mijë lekë, 2 projekt investime për programin me kod 04240 "menaxhim i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit" në vlerën totale 7,000 mijë lekë, 2 projekt investimi për nënprogramin me kod 05100 "menaxhimi i mbetjeve" në vlerën totale 16,000 mijë lekë dhe 1 projekt investimi në nënprogramin me kod 07220 "shërbimet e kujdesit parësor" në vlerën 15,285 mijë lekë;

Deri në 31.12.2025 janë realizuar 14 investime të planifikuara në vlerën totale 112,425 mijë lekë nga të cilat: 7 investime nga "rrjeti rrugor rural" në vlerën totale 70,363 mijë lekë ose 29.4%, nga "shërbimet publike vendore" janë realizuar 4 investime në vlerën totale 11,845 mijë lekë ose 18%,

nga “menaxhimi i mbetjeve” janë realizuar të 2 investimet e planifikuara në vlerën totale 14,934 mijë lekë ose 93%, nga “shërbimet e kujdesit parësor” është realizuar investimi në vlerën 15,285 mijë lekë ose në masën 100% dhe nga “menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit” nuk është realizuar asnjë investim;

- Për programin AC129 “Arsimi” janë planifikuar fonde për 11 projekte investimi në vlerën totale 141,244 mijë lekë, konkretisht: janë 9 projekte investimi për nënprogramin me kod 09120 ”arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” në vlerën totale 105,801 mijë lekë dhe 2 projekte investimi për nënprogramin me kod 09230 “arsimi i mesëm i përgjithshëm” në vlerën totale 35,444 mijë lekë;

Deri në 31.12.2025 janë realizuar 8 investime në vlerën totale 78,684 mijë lekë ose 56% fondit total të parashikuar për këtë program nga të cilat: 7 investime nga ”arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” në vlerën totale 70,113 mijë lekë ose në masën 66.3% dhe nga “arsimi i mesëm i përgjithshëm” është realizuar 1 investim në vlerën 8,471 mijë lekë ose në masën 24.2%;

- Për programin AE129 “Art, kultura, sporti dhe turizmi” janë planifikuar fonde për 5 projekt investime në vlerën totale 11,359 mijë lekë, konkretisht: 3 projekt investime për nënprogramin me kod 08130 “sport dhe argëtim” në vlerën totale 8,859 mijë lekë, dhe 2 projekt investimi për nënprogramin me kod 08220 “trashëgimia kulturore, muzetë, biblioteka” në vlerën 2,500 mijë lekë;

Deri në 31.12.2025 janë realizuar 2 investime të planifikuara në vlerën totale 7,053 mijë lekë ose 62% nga të cilat: janë 2 investime nga “sport dhe argëtim” në vlerën totale 7,053 mijë lekë ose në masën 79.6% dhe asnjë investim nga “trashëgimia kulturore, muzetë, biblioteka”;

- Me fonde jashtë limitit nga ambasada japoneze për programin AB129” shërbime publike komunitare” për nënprogramin me kod 05100 “menaxhimi i mbetjeve” është realizuar investimi në vlerën 861 mijë lekë;

Deri në 31.12.2025 me burim “të ardhurat e veta + transferta e pakushtëzuar” janë planifikuar në total realizuar 47 projekte investimi në vlerën totale 525,472 mijë lekë për 4 programe buxhetore dhe 12 nënprograme, dhe janë realizuar 25 investime në vlerën totale 199,331 mijë lekë ose në masën 38% të vlerës totale të planifikuar.

Nga të dhënat e pasqyruara në *tabelën 13.2/Aneks B,* rezulton se:

- Për programin AA129 “menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse” janë planifikuar fonde për 1 investim në vlerën 6,576 mijë lekë, konkretisht 1 projekt investimi për nënprogramin 04760 “turizmi”;

Deri në 31.12.2025 nga programi AA129 është realizuar 1 investim në funksionin/nënprogramin me kod 04760 në vlerën 4,861 mijë lekë ose në masën 74% të fondit të planifikuar;

- Për programin AB129 “Aparati dhe drejtimi i bashkisë” janë planifikuar fonde për 2 projekte investimi në vlerën 40,373 mijë lekë, konkretisht 2 projekt investimi për nënprogramin 04240 “menaxhim i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”;

Deri në 31.12.2025 nga programi AB129 është realizuar 2 investimet në funksionin/nënprogramin me kod 04240 në vlerën totale 28,975 mijë lekë ose në masën 71.8% të fondit të planifikuar;

- Për programin AC129 “Arsimi” janë planifikuar fonde për 2 projekte investimi në vlerën totale 30,600 mijë lekë, konkretisht 2 projekt investimi për nënprogramin 09230 “arsimi i mesëm i përgjithshëm”;

Deri në 31.12.2025 nga programi AC129 janë realizuar 2 investimet në funksionin/nënprogramin me kod 09230 në vlerën totale 30,537 mijë lekë ose në masën 99.9% të fondit të planifikuar;

- Duke iu referuar të dhënave në *tabelën.13.1-13.2/Aneks B*, një pasqyrim i përmbledhur i të dhënave për zërin “ investime”, pasqyrohen si më poshtë vijon:

Tabela nr. 17/në mijë lekë

	Burimet e Financimit	Viti 2025		% ndaj planit	% ndaj faktit
		Plan	Fakt		
% 230-231	Të ardhurat e veta	178,455.57	83,187.96	**46.6**	**31.4**
	Transferta specifike/sektoriale Transferta e pakushtëzuar	345,551.24	117,004.45	**33.9**	**44.1**
	Transferta e kushtëzuar	66,153.18	64,374.44	**97.3**	**34.3**
	Transferta e huaj/jashtë limitit	-	861.36		**0.3**
	Totali	**590,159.99**	**265,428.21**	**45.0**	**100**

Burimi: Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën nr.17,* rezulton se: realizimin më të lartë zëri investime e ka nga "*transferta e kushtëzuar*" në masën 97.3%, dhe më të ulët në masën 33.9% n*ga_ "transferta e pakushtëzuar sektoriale".*

Mosrealizimi i buxhetit në arsyetimin e grupit të auditimit, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin e viteve paraardhëse, pavarësisht faktit që të ardhurat veçanërisht të ardhurat e veta, kanë ardhur në rritje nga viti në vit, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse

III.2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor apo me fondet e trashëguara, NJVQV miratojnë një plan likuidimi për detyrimet e prapambetura progresive. Në PBA 2025-2027 dhe Planin vjetor 2025, Bashkia Lushnjë nuk ka planifikuar plan shlyerje, pasi detyrimet janë të mbartura më herët dhe dokumentacioni justifikues nuk është i plotë"[8].

- Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2025, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr. 18/Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fund të vitit i mbartur 31.12.2024	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2025	Total detyrime	Shlyerja gjate vitit 2025	Mbetja në fund të vitit 2025
a	**1**	**2**	**3=1+2**	**4**	**5=3-4**
a. Investime nga Ministritë e linjës					
b. Investime nga Bashkia	15,960,225	82,647,025	98,607,250	83,008,090	15,599,160
Investime	***15,960,225***	***82,647,025***	***98,607,250***	***83,008,090***	***15,599,160***
Mallra	1,108,920	432,105	1,541,025	432,105	1,108,920
Shërbime	3,117,440	1,123,636	4,241,077	1,123,636	3,117,440
Mirëmbajtje	3,618,125		3,618,125		3,618,125
Vendime gjyqësore					
Të tjera					
Shpronësime	90,329		90,329		90,329
Shpenzime operative	***7,934,814***	***1,555,741***	***8,379,073***	***1,555,741***	***7,934,814***
Totali	**23,895,039**	**84,202,766**	**108,097,806**	**84,563,831**	**23,533,974**

Burimi: DFB/Bashkia Lushnjë

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr.18,* ***rezulton*** **se**:

- Për zërin "investime" viti 2024 është mbyllur me vlerën totale të detyrimit të prapambetur prej 15,960,225 lekë,

Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 82,647,025 lekë, duke e çuar vlerën e detyrimeve të prapambetura për zërin "investime" të bashkisë dhe në total në shumën 98,607,250 lekë;

Gjatë vitit 2025 për zërin "investime *janë bërë likuidime* në vlerën 83,008,090 lekë, duke e mbyllur vitin 2025 në vlerën e detyrimeve të prapambetura progresive për "investimet" ***15,599,160 lekë***;

- Për zërin shpenzime /"mallra" viti 2024 është mbyllur me vlerën e detyrimit të prapambetur progresiv prej 1,108,920 lekë, ose në masën 14% të totalit të detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve operative; detyrimi për "mirëmbajtje"në vlerën 3,618,125 lekë ose në masën 45.6% të totalit për kategorinë shpenzime operative; për zërin "shërbime" në vlerën 3,117,440 lekë ose në masën 39.3% dhe detyrimi për "shpronësimet" në vlerën 90,329 lekë ose në masën 1.1% të totalit të detyrimit progresiv të 31.12.2024;

Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 84,202,766 lekë, nga të cilat 82,647,025 lekë janë nga zëri "investimet" ose në masën 98.2% dhe 1,555,741 lekë për zërin "shpenzime operative" ose në masën 1.8% të detyrimit total të krijuar në vitin 2025;

[8] Sic është përmendur edhe më lart, në PBA 2023-2025, fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar në buxhet në programin 04960 "detyrime të prapambetura".

Janë shlyer gjatë vitit 2025 shuma prej 84,563,831 lekë ose 78.2% e vlerës totale të detyrimit, nga të cilat për zërin "investime" 83,008,090 lekë ose 84.2% e vlerës totale të detyrimit për këtë zë buxhetor dhe 1,555,741 lekë për zërin "shpenzime operative" ose 18.6% e vlerës totale të detyrimit për këtë zë buxhetor.
Pra deri në 31.12.2025 vlera e detyrimit të prapambetur për "shpenzime operative": mallra, shërbime, mirëmbajtje dhe shpronësime është i njëjtë me atë të datës 31.12.2025 në vlerën 7,934,814 lekë;
Vlera progresive për "investimet" në 31.12.2025 është 361,065 lekë më pak se ajo në datë 31.12.2024;
Vlera totale e detyrimit progresiv deri në 31.12.2025 është në vlerën 23,533,974 lekë ose 361,065 lekë më pak se ajo në datë 31.12.2024.
Një informacion i detajuar mbi detyrimet e prapambetura të ndara sipas llogarive ekonomike pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 19/ në lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emërimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2024	Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2025 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2025 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2025 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2025)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2025 (situata më 31.12.2025)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur a më 31.12.2025
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6=3-5**	**7**	**8=6+7**
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta							
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore						
4864200	Detyrime për shërbime	3,117,440.43		1,123,636.44		1,123,636.44	3,117,440.43
4864300	Detyrime për mirëmbajtje	3,618,125.00					3,618,125.00
4864400	Detyrime për investime	15,960,224.52		83,008,090.89		82,647,024.68	15,599,158.31
4864400	Detyrime për nga Ministritë e Linjës (specifiko FZHR etj...)						
4865600	Detyrime për mallra	1,108,920.00		432,105.00		432,105.00	1,108,920.00
4864900	Detyrime te tjera						
4864902	Shpronësime	90,329.00					90,329.00
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta		**23,895,038.95**		**84,563,832.33**		**84,202,766.12**	**23,533,972.74**
II. Detyrime nga Granti							
4864400	Detyrime për Investime nga Ministritë e Linjës						
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore						
	Rindërtimi						
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin		-	-	-	-	-	-
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		**23,895,038.95**		**84,563,832.33**		**84,202,766.12**	**23,533,972.74**

Burimi: DFB/Bashkia Lushnjë

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Lushnjë është në procese gjyqësore, në statusin e të padituri apo paditësit, sipas informacionit në *tabelën nr. 14/Aneksi B*:
Nga informacioni i pasqyruar në *tabelë* rezultojnë 41 procese gjyqësore nga të cilat **21** procese gjyqësore janë me objekt "çështje të ndryshme" të periudhës nga viti 2024 deri në vitin 2026, të cilat kanë efekt financiar në thelb të objektit të padisë.
Nuk ka asnjë proces gjyqësor me objekt "pavlefshmëri akti lA....m nga puna/dëmshpërblim".
Proceset gjyqësore të iniciuara nga ish punonjësit apo nga OE të kontraktuar, të cilat janë në proces shqyrtimi dhe kërkojnë pavlefshmërinë e aktit administrativ përkatës, riskojnë të sjellin efekte financiare dhe administrative për Bashkinë Lushnjë, duke krijuar detyrime të mundshme buxhetore për dëmshpërblime, pagesa të prapambetura, shpenzime gjyqësore dhe ekzekutim të mundshëm të vendimeve gjyqësore.
Konkluzion: Bashkia Lushnjë ka detyrime të prapambetura *në mbyllje të vitit 2025* në vlerën totale progresive prej 23,533,974 lekë, të cilat janë me burim financimi nga fondet e veta;
Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë edhe në rrugë elektronike.
Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*", pika 106, ku citohet:

"*Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që jo më vonë se data 10 Prill 2020 për tremujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, "Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura" bashkëlidhur këtij udhëzimi.*"[9]

Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*".

Konkluzion: Bashkia Lushnjë ka detyrime të mbartura nga vitit i mbyllur ushtrimor 2025 për tu likuiduar në vitin 2026 në shumën totale 23,533,974 lekë, të ndara si më poshtë vijon:

- *Ka detyrime* të mbartura nga viti 2025 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2026 për "Investime" nga të ardhurat e veta në vlerën 15,599,160 lekë;
- *Ka detyrime* të mbartura nga viti 2025 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2026 për "mallra" nga të ardhurat e veta në vlerën 1,108,920 lekë;
- *Ka detyrime* të mbartura nga viti 2025 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2026 për "shërbime" nga të ardhurat e veta në vlerën 3,117,440 lekë;
- *Ka detyrime* të mbartura nga viti 2025 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2026 për "mirëmbajtje" nga të ardhurat e veta në vlerën 3,618,125 lekë;
- *Ka detyrime* të mbartura nga viti 2025 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2026 për "shpronësime " nga të ardhurat e veta në vlerën 90,329 lekë;
- Deri në 31.12.2025 n*uk ka detyrime* të prapambetura që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë, por ekziston rreziku potencial për krijimin e detyrimeve financiare në të ardhmen, si pasojë e proceseve gjyqësore ende në shqyrtim.

Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduar*a në fund të periudhave ushtrimore:*

Nga auditimi i PBA 2025-2027/Plani vjetor 2025, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar veçmas fondi në *programin 04960 "planifikim për detyrimet e prapambetura.* Gjatë vitit 2025 nuk është kryer asnjë pagesë nga totali i detyrimeve progresive të datës 31.12.2024, duke e mbyllur vitin 2025 me një vlerë totale të detyrimit progresiv prej 23,533,973 lekë. Bashkia Lushnjë ka dërguar rregullisht në MF "Raportet e vetëvlerësimit financiar dhe treguesit fiskal": me shkresën nr. 2116 prot., datë 30.05.2025 për periudhën janar-prill 2025; me shkresën nr. 3730 prot., datë 16.09.2025 për periudhën janar-gusht 2025 dhe me shkresën nr. 801 prot., datë 16.02.2026 për vitin 2025 miratuar dhe me VKB nr. 20 datë 19.03.2026, konform Udhëzimit nr. 35 datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për NJVQV" pika 52. Çdo raportim është miratuar paraprakisht me VKB dhe konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Fier.

Nga Bashkia Lushnjë deri në 31.12.2025 në takimet e GMS nuk është bërë asnjë analizë për hartimin e një plani masash për të mundësuar shlyerjen faktike të detyrimeve të prapambetura.

▪ Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2025 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështirësisë financiare sipas raportit vjetor të dorëzuar në MF me nr. 801 prot., datë 16.02.2026, është si në tabelat më poshtë:

Tabela nr.20/Në lekë

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 31 DHJETOR 2025	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan) 2025
I	**Të ardhurat e Pushtetit Vendor**	**513,892,979**	**640,579,000**
1	**Taksat e veta vendore**	***226,172,038***	***302,910,000***
a.	Taksa mbi pasurinë	171,916,038	217,400,000
b.	Biznesi i vogel	439,298	0
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	35,250,215	70,300,000
d.	Taksa të tjera vendore	18,566,487	15,210,000
2	**Të ardhura jotatimore**	***173,537,703***	***270,769,000***
a.	Tarifat e sherbimeve publike	123,200,282	142,779,000
b.	Tarifa administrative	19,986,666	30,740,000
c.	Të tjera jo tatimore	30,350,755	97,250,000
3	**Taksa të ndara**	***114,183,238***	***66,900,000***
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	5,970,419	10,000,000

[9] Në raportimet e bëra respektohet viti ushtrimor në të cilin realizohen shpenzimet vjetore të planifikuara në PBA

b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	59,413,607	36,000,000
c.	Renta minerare	3,701,413	6,900,000
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	45,097,799	14,000,000
e.	Të tjera		
II	**Shpenzime te Buxhetit Vendor**	**1,435,208**	**2,198,292**
1	**Shpenzime Korrente**	1,235,015	1,674,285
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	769,665	878,405
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	127,830	149,203
d.	Shpenizme Operative	337,519	646,677
e.	Të tjera korrente		
2	**Shpenzime Kapitale**	200,192	524,007
3	**Burimet e Financimit**	3,867	0
a.	Të ardhurat e veta vendore		
b.	Transferta e pakushtezuar		
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale		
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)	3,867	
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Burimi: Bashkia Lushnjë

Ndërsa niveli i vështirësisë financiare i Bashkisë Lushnjë është në *tabelën nr.21*, si më poshtë:

Tabela nr.21/Në lekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**23,533,973**		**1.64%**
Llogaria ekonomike	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	3,117,440.43		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	3,618,125.00		
4864400	Det.Prap. Investime	15,599,158.31		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	1,108,920.00		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime	90,329.00		
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**23,533,973**	**1,432,804,994**	**1.64%**

Ndërsa për ministritë e linjës vlera e detyrimit të prapambetur, e raportuar në Raportin e monitorimit në MF nga bashkia Lushnjë është në *tabelën 22*, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 22/Në lekë

Detyrime Pushteti qendror	Llogaria ekonomike	Vlera
Ministri linje xx		
FSHZH		
Fonde te Rindertimit		
Totali	**0**	**0**

Tabela nr. 23

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore 2024				
	Probleme financiare	**Vështirësi financiare**	**Vështirësi serioze financiare**	**Paaftësi paguese**
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%

1.64% normale	**0**	**0**	**0**	**0**

Burimi: Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën nr. 23* dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Lushnjë *paraqet një situatë normale të vështirësisë financiare*.

Tabela nr.24/në lekë

			Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve				
Nr.	**Bashkia Lushnjë**	**Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2025**	**Viti 2026**	**Viti 2027**	**Viti 2028**	**Diferencë (Fakt-Plan)**	**Shënime**
		23,533,973	11,766,986	5,883,493	5,883,493	0	-

Burimi: Bashkia Lushnjë

Nga auditimi ***rezultoi se*** deri në datë 31.12.2025 nga Bashkia Lushnjë është miratuar plani i shlyerjes sipas *tabelës nr. 24* për detyrimet e prapambetura, por për shkak të mungesës apo pasaktësisë së dokumenteve justifikuese në praktikën dokumentare të procedurave, ky plan rezulton të mos jetë zbatuar apo zbatuar në masë shumë të vogël.

Për sa më sipër trajtuar, përgjegjësia kryesore për veprimet apo mosveprimet i ngarkohet Titullarit të bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Koordinatorit të MFK dhe të Riskut, GMS dhe Drejtorisë së Menaxhimit financiar dhe të ardhurave vendore, përcaktuar në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 8; neni 10, neni 11, neni 12; Udhëzim nr. 16, datë 20.7.2016 për "Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Udhëzim nr. 21, datë.25.10.2016 për "Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve" dhe Rregullores së Brendshme e Bashkisë Lushnjë.

III.2.2.5 Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

Tabela nr. 1

Bashkia Lushnjë - Viti 2025						
Qarku	Qendra e Bashkisë	Nr.	NJAdministrative	Fshatrat Nr.	Nr.Banorë	Klasifikim taksapagues
Fier	Lushnjë	1	Qyteti Lushnjë	**2**	63 135[10]	**2517** BV
		2	NJA Allkaj	8		**1029** BM
		3	NJA Bubullimë	7		**33** Institucione
		4	NJA Hysgjokaj	5		**31382** familje
		5	NJA Golem	6		
		6	NJA Dushk	7		
		7	NJA Karbunarë	10		
		8	NJA Ballagat	7		
		9	NJA Fier Shegan	13		
		10	NJA Kolonjë	9		
		11	NJA Krutje	10		
Totali		**11**		**82**	**63,135**	

Punoi: Grupi i auditimit

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 115 datë 27.12.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me nr. 1/9 prot., datë 08.01.2025 "Për miratimin e PBA 2025-2027 dhe Projekt Panit vjetor 2025" i ndryshuar. Me VKB nr. 103 datë 26.11.2024 është miratuar Paketa Fiskale 2025 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Lushnjë dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2025", me nr. 9417/2 prot., datë 02.12.2024, konfirmuar për përputhshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Fier me nr. 1259/1 prot., datë 05.12.2024 të PQ Fier dhe regjistruar në Bashkinë Lushnjë me nr. 9791/1 prot., datë 10.12.2024. Si njësi përbërëse e strukturës organizative të Bashkisë Lushnjë është edhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore e organizuar në nivel Drejtorie me 4 sektorë, e konfiguruar si në tabelën nr.2 (përmbledhëse) dhe në *tabelën nr.1/Aneksi A*. Kjo drejtori në aktivitetin e saj për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave, referuar paketës Fiskale realizohet në bashkëpunim edhe me struktura të tjera pranë bashkisë, si: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të

[10] Sipas cens-it 2023

Territorit [DPTU], MZSH, Policia Bashkiake [PB] etj, ku roli i këtyre strukturave është hartimi i autorizimit për arkëtim dhe llogaritja e detyrimit, ndërsa detyrat e Drejtorit/Drejtorisë së të ardhurave vendore janë:
- ndjek dhe evidenton në mënyrë të vazhdueshme subjektet e regjistruara dhe riregjistruara pranë administratës tatimore vendore;
- ndjek në dinamikë ecurinë e realizimit të të ardhurave nga çdo inspektor duke bashkërenduar punën dhe me agjentë të tjerë;
- kryen analiza dhe raporte 6 mujore dhe vjetore mbi ecurinë e punës së zyrës dhe e paraqet pranë eprorit direkt;
- është përgjegjës për zbatimin korrekt dhe Brenda afateve të të gjithë VKB apo urdhëresave e vendimeve në fuqi;

Tabela nr. 2

Pozicioni	Numri
Drejtor I Përgjithshëm DMFAV	1
Drejtor drejtorie	1
Sektori i regjistrimit dhe i vlerësimit, asistencës dhe shërbimit ndaj taksapaguesve	(19 punonjës)
Sektori i kontrollit dhe zbatimit	(11 punonjës)
Sektori i menaxhimit të Borxhit tatimor	(3 punonjës)
Sektori i monitorimit të tregjeve dhe mbrojtje se konsumatorit	(3 punonjës)

Burimi: Bashkia Lushnjë/Punoi: Grupi i auditimit

Veç DAV, në Bashkinë Lushnjë janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, të miratuara me VKB e Paketës Fiskale 2025, sipas specifikave si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3

Struktura	Lloji i të ardhurës
Drejtoria e Taksa dhe Taksave Vendore	Taksa e pronës
	Taksat dhe tarifat vendore për biznesin dhe familjarët
Drejtoria e Planifikimi e Zhvillimit të Territorit	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale
	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi
	Aplikime të ndryshme
	Certifikatë përdorimi etj
ASHBVP	Qira e tokës Bujqësore
	Taksa nga Toka bujqësore
	Tarifa për vaditjen
	Kontrata qira dhenieje sip pyjore, kullota, etj
Sektori I transportit dhe licencimit	Tarifa e liçencë/Autorizim tregetim karburante
IMTV	Gjoba për ndërtime pa leje etj
MZSH	Tarifa sherbimesh
Policia Bashkiake	Gjoba kundërvajtjeje

Burimi: Bashkia Lushnjë/ Punoi:Grupi i auditimit

Në fillim të çdo viti DAV bën raportimin vjetor mbi analizën e të ardhurave vjetore të bashkisë, i cili është pjesë e Raportit vjetor të Monitorimit dhe e Raportit të buxhetit që prezantohet dhe në Këshillin Bashkiak.
Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *tabelën nr. 2/Aneksi A* rezulton se:
- Bashkia Lushnjë në paketën fiskale 2025 me VKB ka miratuar 10 gruptaksash dhe 9 gruptarifash; 4 lloje TA jotatimore;
- Afati fundor i pagesës së taksave dhe tarifave të vitit ushtrimor për biznesin dhe për familjarët është e përcaktuar në paketën fiskale të vitit 2025 të miratuar.
- DAV Bashkia Lushnjë informacionin tatimor e administron nëpërmjet programit *TAIS*. Të ardhurat nga taksat, sigurohen nëpërmjet arkëtimit të tyre në sportelet e UK-sha së bashku me detyrimin për ujin e pijshëm, ndërsa subjektet detyrimet vjetore për taksat dhe tarifat i paguajnë në bankat e nivelit të dytë.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve
"Paketa fiskale 2025" është miratuar me VKB nr. 103 datë 26.11.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier konform kuadrit ligjor në fuqi.
Nga të dhënat e pasqyrës përmbledhëse më poshtë *tabela nr. 3/Aneksi A*, rezulton se *për vitin 2024* të ardhurat nga taksat dhe tarifat (pa përfshirë grantin e qeverisë dhe sponsorizimet) janë realizuar në vlerën 139,276 mijë lekë ose në masën 186%; *për vitin 2025* janë realizuar në vlerën 79,135 mijë lekë ose në masën 93.1%. Nga analiza e të dhënave *rezultoi* se:

- Për vitin 2025, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 640,579 mijë lekë në po të njëjtën vlerë me vitin 2024 dhe janë realizuar në vlerën 515,768 mijë lekë ose (-) 4,772 mijë lekë më pak se realizimi në vitin 2024 dhe (-)124,811 mijë lekë më pak se planifikimi i tyre në vitin 2025. Realizimi i të ardhurave total *për vitin 2024* është në masën 81.3%; ndërsa *për vitin 2025* është në masën 80.5% ose 0.8% më pak.

Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2025

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën 3/Aneksi A*, vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura. Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse *rezulton* si mëposhtë vijon:

Kategoria Taksa Vendore

- Taksë mbi ndërtesat është parashikuar në vlerën 97,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 86,019 mijë lekë ose në masën 88.7%, krahasuar me vitin 2024 ka një rënie prej (-)5,251 mijë lekë ose me (-)5.4%;
- Taksa e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 100,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 65,640 mijë lekë ose në masën 65.6%, krahasuar me vitin 2024 ka një rënie prej (-)3,736 mijë lekë ose me (-)3.7%;
- Taksë trualli është parashikuar në vlerën 20,400 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 20,257 mijë lekë ose në masën 99.3%, me një rënie të ardhurash prej (-)1,093 mijë lekë nga viti 2024 ose prej (-)5.4%;
- Taksë fjetje në hotel për vitin 2025 është planifikuar 180 mijë lekë dhe është vjelë 531 mijë lekë ose në masën 295.2%, krahasuar me vitin 2024 ka rritje me 111 mijë lekë më shumë ose me 61.9%;
- TNI për vitin 2025 është parashikuar në shumën 70,300 mijë lekë dhe është vjelë 35,250 mijë lekë ose në masën 50.2% të saj, por vlera e saj ka ardhur në rritje prej 657 mijë lekë më shumë se në vitin 2024 ose me 0.93%;
- Taksë tabele është parashikuar në vlerën 10,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 14,135 mijë lekë ose në masën 141.4%, krahasuar me vitin 2024 rezulton në rritje prej 1,817 mijë lekë më shumë ose me 18.2%;

Kategoria Tarifa

- Tarifë pastrimi, higjene dhe ndriçimi për vitin 2025 janë planifikuar 133,279 mijë lekë dhe janë realizuar 112,566 mijë lekë ose në masën 84.5%, krahasuar me vitin 2024 ka rënie të realizimit të të ardhurave prej (-)16,103 mijë lekë ose me (-)12.1%;
- Tarifë për parkim për vitin 2025 janë planifikuar 8,000 mijë lekë dhe realizuar 8,442 mijë lekë ose në masën 105.5%, krahasuar me vitin 2024 ka rritje prej 53 mijë lekë më shumë ose me 0.67%;
- Tarifë leje transporti-licenca për vitin 2025 është planifikuar 5,030 mijë lekë dhe realizuar 3,900 mijë lekë ose në masën 77.5%, krahasuar me vitin 2024 është rritur prej 263 mijë lekë më shumë ose me 5.3%;
- Tarifë për hapësirat publike (për aktivitet biznesi) për vitin 2025 është planifikuar 1,500 mijë lekë dhe realizuar 2,182 mijë lekë ose në masën 145.5%, krahasuar me vitin 2024 ka rënie prej (-)561 mijë lekë ose me (-)37.4%;
- Tarifë për reklama dhe tarifë për therrjen e bagëtive për vitin 2025 nuk janë planifikuar të ardhura dhe as nuk ka patur arkëtime për këtë tarifë;

Kategoria Taksa të Ndara

Kjo kategori përfshin:

- Taksë e kalimit të drejt.pronësisë së pasurive të paluajtshme për vitin 2025 është planifikuar 10,000 mijë lekë dhe është vjelë 5,970 mijë lekë ose në masën 59.7%, krahasuar me vitin 2024 ka një rritje prej 2,429 mijë lekë më shumë ose me 24.3%;
- Taksë e qarkullimit të mjeteve të përdorura është planifikuar 36,000 mijë lekë dhe realizuar 59,414 mijë lekë ose në masën 165%, krahasuar me vitin 2024 ka rritje prej 6,793 mijë lekë ose me 18.9%;

- Të ardhurat personale –TAP është planifikuar 14,000 mijë lekë dhe realizuar 45,098 mijë lekë ose në masën 322%, krahasuar me vitin 2024 ka rritje prej 7,198 mijë lekë ose me 51.4%;
- Të ardhura nga Renta minerare për vitin 2025 është planifikuar 6,900 mijë lekë dhe realizuar 3,701 mijë lekë ose në masën 54%, krahasuar me vitin 2024 ka rënie me (-)1,216 mijë lekë ose me 17.6%;

Kategoria të Ardhura të tjera Bashkia

- Të ardhura nga qira ndërtese janë planifikuar 8,250 mijë lekë dhe janë realizuar 7,133 mijë lekë ose në masën 86.5%, krahasuar me vitin 2024 ka një rënie të ardhurave prej (-)326 mijë lekë ose me (-)4%;
- Të ardhura nga qira toka bujqësore&asete janë planifikuar 5,190 mijë lekë dhe janë realizuar 3,442 mijë lekë ose në masën 66.3%, krahasuar me vitin 2024 ka një rënie të ardhurave prej (-)196 mijë lekë ose me (-)3.8%;
- Të ardhura nga MZSH janë planifikuar 1,000 mijë lekë dhe janë realizuar 836 mijë lekë ose në masën 84%, krahasuar me vitin 2024 ka një rritje të të ardhurave prej 211 mijë lekë ose me 21%;
- Të ardhura të tjera janë planifikuar 82,810 mijë lekë dhe janë realizuar 18,676 mijë lekë ose në masën 22.6%, krahasuar me vitin 2024 ka një rritje prej 2,032 mijë lekë ose me 2.5%;

Njësi varësie-Qendra Arsimore

- Të ardhura nga pagesat për kopshte janë planifikuar 11,840 mijë lekë dhe realizuar 13,189 mijë lekë ose në masën 111.4%, krahasuar me vitin 2024 ka rritje me 1,349 mijë lekë ose me 1.7%;
- Të prindërve për konviktet janë planifikuar 300 mijë lekë dhe realizuar 142 mijë lekë ose në masën 47.3%, krahasuar me vitin 2024 janë në rënie prej (-)77 mijë lekë më pak ose me 26%;

Ndërmarrja e Pasurisë Publike

- Të ardhura nga vaditja janë planifikuar 10,000 mijë lekë dhe realizuar 2,179 mijë lekë ose në masën 21.8%, krahasuar me vitin 2024 ka rënie me (-)50 mijë lekë ose me 0.5%;
- Të ardhura nga parkingu janë planifikuar 3,000 mijë lekë dhe realizuar 3,951 mijë lekë ose në masën 131.7%, krahasuar me vitin 2024 ka rritje me 420 mijë lekë ose me 14%;

Qendra Kulturore & Klubi sportive

- Të ardhurat janë planifikuar 1,500 mijë lekë dhe realizuar 23.7 mijë lekë ose në masën 1.6%, krahasuar me vitin 2024 ka rënie me (-)33.4 mijë lekë ose me 2.2%;
- Të ardhura nga sponsora apo OJQ në vitin 2025 ka patur 2,138 mijë lekë ose 1,408 mijë lekë më shumë.

Mungesa e një analize të mirëfilltë për të ardhurat e (mos)realizuara në vitet paraardhëse, ka sjellë planifikimin në vlera jo reale të pastudiuara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

- Gjithashtu, nga auditimi *rezulton se* procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore realizohet jo vetëm në trendin e realizimit të të ardhurave nga vitet paraardhëse, por edhe nga kërkesat që DPFBAV iu ka përcjellë për informacion njësive të strukturës së Bashkisë që sigurojnë të ardhura, për të grumbulluar një informacion sipas, realizimit të të ardhurave të 2 viteve të fundit, për hartimin e paketës fiskale për vitin 2025.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, në strukturën e DAV/SRVASHT[11] është caktuar një person në pozicionin "operator i kontabilitetit dhe Agjentëve tatimor" i cili ka për detyrë: derdhjen ditore në bankat e nivelit të dytë nga të ardhurat ditore; të regjistrojë çdo ditë në databazën e taksave dhe tarifave veprimet e kryera në bankë; të përgatitë evidencën mujore me të ardhurat e realizuara nga drejtoria;

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR", për llogari të Bashkisë Lushnjë. Akt rakordimi me DPSHTRR realizohet çdo vit edhe nëpërmjet Degës së Thesarit Lushnjë, referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës "b", të pikës 2, në nenin 25 "*Të ardhurat nga taksat e ndara*" të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", pushtetit vendor për

[11] Sektori i regjistrimit, vlerësimit, asistencës dhe shërbimit ndaj taksapaguesit

mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT)". Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 "*Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 "*Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël*". Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023. Arkëtimet e nga detyrime të prapambetura rezultojnë në ark rakordimin me Degën e Thesarit Lushnjë.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" (ZVRPP) tani ASHK Vendore. ASHK Vendore nuk ka patur bashkëpunim me STTV/Bashkinë Lushnjë, për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Lushnjë me vlerën e përllogaritur. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

4. Për rentën minerare rakordohet nëpërmjet Degës së Thesarit. Nuk rakordohet me DPT dhe DPD.

5. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, pastrim, truall,) realizohet nëpërmjet akt marrëveshjes së lidhur me UK-sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor, në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar. Nga verifikimet dhe komunikimi me subjektin, grupit të auditimit i është komunikuar se për ato familje që nuk kanë lidhur kontratë me UK Lushnjë –sha, fatura lëshohet manualisht nga DAV dhe pagesat bëhen në sportele apo banka të nivelit të dytë.

Për arkëtimet e realizuara nga Agjentët tatimore, janë mbajtur akt rakordimet përkatëse.

Detyrimet vjetore të familjarëve

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet UK Lushnjë-sha, dhe informacioni merret nga DAV /Bashkia Lushnjë në sportelet e shërbimeve.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj, por edhe në stendat e bashkisë apo njësive administrative. Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, por edhe dorazi nëpërmjet punonjësve të terrenit, me qëllim njoftimin e taksapaguesve për të paguar në kohë detyrimin. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, pastrim)

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, në çdo rast kërkohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër kjo nuk është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga komuniteti, pasi janë bërë njoftimet në bankat e nivelit të dytë.

- Pasqyra e *familjeve të regjistruara si tatimpagues* në territorin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2025 dhe detyrimi vjetor, pasqyrohet në *tabelën nr. 4/Aneksi A* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Nga informacioni i pasqyruar në tabelë *rezulton se*:

Taksa e ndërtesës aplikohet në të 11 NJA të Bashkisë Lushnjë në vlerën totale 31,528,319 lekë për 28340 familje;

Tarifa e pastrimit aplikohet në 11 NJA të Bashkisë Lushnjë në vlerën totale 50,616,666 lekë për 31382 familje;

Taksa e truallit aplikohet në 11 NJA të Bashkisë Lushnjë në vlerën totale 2,053,725 lekë për 16,757 familje;

Tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit nuk aplikohet në territorin e Bashkisë Lushnjë për familjarët;

Taksa e tokës bujqësore sipas *tabelës 9*, aplikohet në 11 NJA të Bashkisë Lushnjë në vlerën totale 44,751,429 lekë për 14967 familje;

Taksa e tokës bujqësore

Bashkia Lushnjë ka tokë bujqësore të ndarë me Ligjin 7501 /1991 datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar, sipas regjistrave kadastralë të së cilës pasqyrohen në *tabelën nr.5/Aneksi A* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- Nga informacioni i pasqyruar në tabelë *rezulton se*: numrin më të lartë të familjeve me tokë bujqësore e ka NJA Lushnjë (qyteti) me 2550 familje me vlerën totale të taksës vjetore 7,065,967 lekë 17.8% të të ardhurave vjetore totale, ndërsa numrin më ulët e ka NJA Ballagat me 231 familje dhe vlerën totale vjetore të taksës 1,210,516 lekë ose 2.7% të të ardhurave vjetore totale.

Tabela nr.4

Njësi Administrative + Qyteti Lushnjë	Sipërfaqja në ha				Toke Bujqesore ne Ha TOTAL
	Të ndara	Të ndara		Të pandara	
		Me origjinë nga ish.Koop.bujqësore	Me origjinë nga ish.Nb. bujqësore		
Bashkia Lushnjë	28047.46	21798.74	6248.717	2483.733	**30531.19**

Burimi: NPP/Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën 10*, rezulton se tokë bujqësore në total janë 30531.19 ha, nga e cila 28047.46 ha është ndarë dhe 2483.733 ha nuk është ndarë;

Bashkia Lushnjë ka lidhur kontratë qiradhënieje për tokën bujqësore të pandarë;

- Sipas Bonitetit të tokës, informacioni i detajuar pasqyrohet në *tabelën nr.6/Aneksi A* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë *rezultoi se* NPP ka informacion mbi sipërfaqen totale të tokës bujqësore të ndarë sipas llojit, sipas Njësive Administrative dhe *të klasifikuar sipas bonitetit*, gjë që tregon saktësinë e llogaritjes së detyrimit vjetor të taksës së tokës bujqësore. Nga NPP plani vjetor për vitin 2025 ka qenë 74,277,360 lekë për 28047.46 ha tokë bujqësore të ndarë, nga e cila është mundur të arkëtohen vetëm 65,640 mijë lekë ose në masë 88.4%;

Referuar informacionit të NPP për vitin 2025, rezulton si më poshtë:

Tabela nr. 5

	Nr. familje	**Sip.toke (m2) ose ha**	**Vlera totale vjetore Taksa t.bujqësore**	**Nr. familje paguar 2025**	**Vlera e paguar 2025**	**Nr. Familje debitore 2025**	**Shuma debitore 2025**	**Numri progresiv i debitorëve**	**Vlera debitore progresive deri në 31.12.2025**
Totali 2025	**21373**	**27,649.16**	**100,000,000**	**9600**	**65,640,000**	**13900**	**25,722,640**		**406,434,528**
Diferenca 2025-2024									**4,093,071**

Burimi: NPP/Bashkia Lushnjë

Nga auditimi dhe analiza e informacionit të pasqyruar në *tabelën nr.5, rezulton se*:

- Numri i familjeve me tokë bujqësore është 21373 dhe detyrim vjetor total 100,000,000 lekë;
- në vitin 2025 kanë paguar 9600 familje në vlerën totale 65,640,000 lekë;
- nga 2025 mbeten debitorë 13900 familje në vlerë totale të debisë vjetore 25,722,640 lekë;
- deri në 31.12.2025 vlera totale progresive debitore për taksën e tokës bujqësore është 406,434,528 lekë ose 4,093,071 lekë më shumë se ajo në fund të vitit 2024.

➢ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

▪ Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2025 në Bashkinë Lushnjë, është si mëposhtë:

Tabela nr.6

Nr.	**Lloji Biznesit**	**Gjendja Në fillim 2025**	**Regjistrime të reja gjatë 2025**	**Mbyllur Aktiviteti gjatë 2025**	**Gjendja në fund të Vitit 31.12.2025**
1	Biznesi vogël	2278	396	157	2517
2	Biznes i madh	1036	31	38	1029
(1+2)	**Gjithsej**	**3314**	**427**	**195**	**3546**

Burimi:SSTV/Bashkia Lushnjë

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr. 6*, *rezulton* se Bashkia Lushnjë e ka mbyllur *vitin 2024* me **3314** biznese aktive në total, prej të cilëve: 1036 BM dhe 2278 BV;
- Janë **427** regjistrime të reja, nga të cilat 31 klasifikuar si BM dhe 396 klasifikuar si BV;
- Kanë mbyllur aktivitetin **195** subjekte, nga të i cilat 38 janë BM dhe 157 janë BV;
- Bashkia Lushnjë në fund të vitit 2025 ka në total **3546** biznese aktive ose 232 biznese më shumë se në mbyllje të vitit 2024.

Pra rezulton se numri total i subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, paraqitet me rritje nga viti 2024 në vitin 2025 me një numër prej 232 biznesesh.

▪ Subjekte fizike që kanë mbyllur aktivitetin deri në 31.12.2025 në Bashkinë Lushnjë janë si më poshtë vijon*:*

Tabela nr. 7/Në lekë

Nr.	Subjekti	Statusi	Data	Afati	Detyrimet	Penaliteti	Statusi (paguar apo jo)
1		Pezulluar					
	48 subjekte	Pezulluar	31.12.2025	Pa afat	3,334,480 leke		48 subjekte me detyrime
2		Çregjistruar					

Burimi: DAV/Bashkia Lushnjë

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *tabelën nr. 7*, *rezulton* se kanë mbyllur aktivitetin me pezullim pa afat 48 subjekte - dhe 0 subjekte janë çrregjistruar;

Rezulton se pezullimi i subjekteve nga QKB është realizuar pa marrë paraprakisht konfirmimin nga DAV e Bashkisë Lushnjë. Nga ana e DAV është njoftuar zyrtarisht QKB mbi detyrimet e subjekteve të pezulluara. Deri në 31.12.2025 nga subjektet e pezulluara debitore *nuk është bërë asnjë arkëtim* në llogari të buxhetit të Bashkisë Lushnjë si dhe nuk rezulton të jenë marrë masa për të arkëtuar vlerën debitore në buxhetin e bashkisë. Vlera debitore për taksa e tarifa vendore për subjekteve e pezulluar deri në 31.12.2025 është *3,334,480 lekë për 48 subjekte* debitore.

Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2025

Debitorët sipas kategorive të tyre.

1. Biznesi dhe Institucionet

Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve përgjatë vitit 2025, për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, etj, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.8/në lekë

Përshkrimi	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2024	Nr.	Paguar nga debia e prapambetur	Nr.	Borxhi krijuar gjatë vitit 2025	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2025
Debitorë biznes i madh **BM**	17	8,074,870			10	5,200,873	17	13,275,473
Debitorë biznes i vogël **BV**	99	2,808,660			66	2,197,524	99	5,001,734
Nëntotali I	***116***	***10,883,530***			***76***	***7,398,397***	***116***	***18,277,207***
Institucioni	***0***	***0***		***0***	***0***	***0***	***0***	***0***
Total Borxhi tatimor subjekte	**116**	**10,883,530**			**161**	**7,961,397**	**125**	**18,840,207**

Burimi: STTV/Bashkia Lushnjë

Nga auditimi *rezultoi se* nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2025, janë marrë masa vetëm lidhur me "Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie", "Bllokim i llogarive bankare", ndërsa në DPSHTRR, ASHK Rajonale dhe ASHK nuk janë dërguar urdhra bllokimi të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorëve.

Si rezultat i masave të marra është bërë i mundur arkëtimi nga borxhi në vlerën 6,171,145 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar në marrjen e masave të tjera shtrënguese si: bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestrimin e mallrave të debitorëve etj, deri në kallëzim penal.

-Veprime apo mosveprimet janë në kundërshtim me Neni 76, neni 114, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën "c" të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;
-Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar;
Shkronjën "a" të nenit 5, pikën 2 të nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore";
- VKB nr. 103 datë 26.11.2024.

- Një klasifikim i llojit të aktiviteteve referuar klasifikimit të subjekteve bashkë me detyrimin vjetor /debinë për vitin 2025, pasqyrohen në *tabelën nr. 7/Aneksi A* bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë *rezulton* se aktivitetet sipas llojit që ushtrohen në territorin e Bashkisë Lushnjë, janë parashikuar dhe miratuar në Paketën Fiskale të vitit 2025.
- Gjendja e *subjekteve debitore* e shpërndarë sipas vitit të krijimit deri në fund të vitit 2025, është në *tabelën nr.8/Aneksi A* dhe në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela nr. 9/në lekë

Emërtimi	Lëvizjet e Vlerës së debisë					
	Vlera progresive 31.12.2024	nr.	Vlera e debisë 2025	nr.	Vlera progresive 31.12.2025	nr.
Vlera e debisë	418,469,418		63,525,205.17		**447,002,711.10**	
Kamata	70,889,924				**87,807,514.88**	
Gjoba						
Vlera totale e debisë	**489,359,342**		**63,525,205.17**		**534,810,226.00**	
Trendi i debisë						

Burimi: DAV/Bashkia Lushnjë

Konkluzion: Lidhur me vlerën debitore progresive për bizneset, *rezultoi se* deri në 31.12.2025 vlera progresive është 534,810,226 lekë me kamatëvonesë dhe se trendi ka ardhur në rritje nga viti 2024 në vitin 2025;

- Një klasifikim i debitorëve të biznesit, sipas riskut të shlyerjes së detyrimit të mbartur është:

- vlera e debisë me afat 2-3 vjet është 160,460,541 lekë (pa kamatë) për periudhën 2023-2025;
- vlera e debisë me afat 3-5 vjet është 248,033,576 lekë (pa kamatë) për periudhën 2021-2025;
- vlera e debisë me afat mbi 5 vjet është 198,969,135 lekë (pa kamatë) për periudhën deri në 31.12.2020.

Nga verifikimi i dosjeve të subjekteve debitore, *rezultoi se* nga ana e DAV është bërë verifikimi në sistemin e QKB mbi statusin e tyre dhe ekstraktet e QKB-së janë bërë pjesë e dosjes.
Gjithashtu *konstatohet* se:
1. Në Bashkinë Lushnjë në takimet e zhvilluara nga GMS *nuk rezulton* të jenë trajtuar problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë dhe mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e strukturave përgjegjëse (GMS dhe DFBTT), nuk kanë hartuar një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.
2. Mungesa e Aplikimit të penaliteteve me shkresa për bllokimin e aseteve regjistruar në ASHK;
3. Mungesa e Aplikimit të penaliteteve me shkresa për bllokimin e mjeteve regjistruar në DPSHTRR;
4. Njoftimi i subjekteve debitore dhe familjare kryhet nëpërmjet shërbimit postar dhe inspektorëve në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve, si edhe me njoftimet në qendrat e NJA.
Nga auditimi i dokumentacionit dhe analiza e informacioneve, *rezultoi* se në Bashkinë Lushnjë nuk ka subjekte të cilat ushtrojnë më shumë se një aktivitet në territorin e tyre me të njëjtin Nipt dhe paguajnë detyrimet ndaj bashkisë vetëm për një aktivitet.
Sa më sipër arrihet në *konkluzionin* se nga struktura tatimore dhe ajo ligjore e Bashkisë Lushnjë, për asnjë nga subjektet, që janë debitorë në vite, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar *kallëzim penal***,** bazuar në nenin 181, "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

"*Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*"

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*"pika 1.3., ku përcaktohet se:

"*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:*
1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit."

Neni 35,"*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*"i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

2. Debitorët familjarë

tabela nr.10/në lekë

Përshkrimi	**Nr.**	**Vlera e borxhit progresive deri më 31.12.2024**	**Nr.**	**Arkëtuar 2025 nga detyrimi prapambet 2024**	**Nr.**	**Borxhi i Krijuar gjatë vitit 2025**	**Nr.**	**Vlera e borxhit progresive më 31.12.2025**
Debitorë taksa e ndërtesës familje		323,400,037		18,187,881		31,528,319		336,740,475
Debitorët taksat familje - truall		18,782,701		1,444,883		2,053,725		19,391,543
Debitorët taksat familje - pastrim, ndriçim, gjelbërim,)		495,430,711		26,785,095		50,616,666		519,262,282
Debitorët taksa e tokës bujqësore		402,341,457		40,658,358		44,751,429		406,434,528
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.		24,853,167		5,863,779		17,808,824.94		36,798,213.17
Nëntotali III		***1,264,808,073***		***92,939,996***		***146,758,964***		***1,318,627,041***
Debitorët nga qiratë	6	6,963,228			6	177,840	6	7,141,068
Nëntotali IV	***6***	***6,963,228***			***6***	***177,840***	*6*	***7,141,068***

Burimi: DAV/Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën nr.10* rezulton se, vlera debitore deri në 31.12.2024 për taksa e tarifa familjare është në vlerën totale 1,264,808,073 lekë, ku peshën më të madhe e zënë: debia për taksa "familjarë [pastrim, gjelbërim, ndriçim]" në vlerën 495,430,711 lekë, debia për taksën "toka bujqësore" në vlerën 402,341,457 lekë; debia nga taksa e "ndërtesës" në vlerën 323,400,037 lekë;

- Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar për ulje të vlerës debitore 92,939,996 lekë dhe është krijuar vlerë e re debitore prej 146,758,964 lekë, duke e mbyllur vitin 2025 me vlerë totale progresive prej 1,318,627,041 lekë ose 53,818,968 lekë më shumë se vlera e 31.12.2024.
- Arkëtimi në vlerën më të madhe për të ulur vlerën e debisë progresive ka qenë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 40,658,358 lekë dhe arkëtimi me vlerën më të vogël ka qenë për taksën /truall në vlerën 1,444,883 lekë;
- Vlera debitore më e lartë e krijuar gjatë vitit 2025 është nga mospagesa e taksës së pastrimit prej 50,616,666 lekë dhe vlera më e vogël është nga mospagesa e taksës së truallit prej 2,053,725 lekë;

Për taksat e tarifat familjare nuk aplikohet kamatëvonesë.

Pas viti 2015 nuk është ndjekur rigorozisht numri i debitorëve dhe klasifikimi i debisë sipas çdo lloj takse e tarife, por vetëm vlera debitore në total. Vlera debitore është kontabilizuar.

Mungesa e takimeve të GMS, e bashkëpunimit mes strukturave: DAV, Njësive Administrative dhe Drejtorisë Ligjore, ka sjellë situatë të rënduar të debisë progresive dhe mbi të gjitha ka shtuar vështirësinë për arkëtimin e saj.

Detyrimet nga qiratë

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit financiar dhe e të ardhurave vendore, nga NPP çdo vit është dërguar në Këshillin e Qarkut Fier, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor, tokës bujqësore etj, sipas formularëve të miratuar Formular 1, 2, 3 dhe 4.

Tabela nr. 11

Nr.	**Emërtimi i asetit**	**Nr., total i kontratave**	**Vlera**	**Afati /në vite**	**Debitorët/numër**	**Vlera debitore/lekë**
1	Tokë bujqësore	61	571,845	Nga 30-99	6	7,141,068
2	Truall	1	7,000,000	20	-	
3	Godinë	3	132,733	1	-	
4	Shesh	1	2,880,000	20	-	

5	Pyll	1	17,900	10	-	
6	Karrier	1	28,969	20	-	
Totali sipërfaqe pyjore		**68**	10,631,447		**6**	**7,141,068**

Burimi: ABAP/Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën 11, *rezulton se* janë lidhur 68 kontrata në vlerën totale 10,631,447 lekë, nga të cilat deri në 31.12.2025 janë 6 debitorë për kontrata të lidhura me objekt "dhënie me qira të tokës bujqësore" në vlerën totale 7,141,068 lekë;

- Për kontratat e lidhura me objekt "dhënie me qira truall, godinë, shesh, pyll dhe karrier" deri në 31.12.2025 nuk ka debitorë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë TNI nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Lushnjë, informacioni për vitin 2025, i paraqitur nga Departamenti i Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Lushnjë deri në 31.12.2025, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Lushnjë. Nga ZVASHK, janë dërguar informacioni dokumentar për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Bashkisë Lushnjë.

- Tabela nr. 12 (përmbledhëse) paraqet gjendjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për legalizimin e objekteve informale deri në 31.12.2025. Vlera debitore nga TNI është kontabilizuar nga DFB në pasqyrat financiare të njësisë.

Tabela nr. 12

Numri i familjeve për TNI	Vlera totale TNI	Numri i familjeve që kanë Paguar	Vlera e arkëtuar	Numri i familjeve debitore	Vlera debitore e mbetur
1024	33,013,919.99	556	15,205,095.04	**467**	**17,808,824.95**

Burimi:Bashkia Lushnjë

Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 janë 1024 debitorë me vlerë totale të TNI prej 33,013,920 lekë, janë arkëtuar 15,205,095 lekë nga 556 aplikues dhe deri në 31.12.2025 janë 467 debitorë në vlerën totale progresive 17,808,825 lekë.

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë përpilohet nga DPZHT në formën e autorizimit të punimeve dhe në bazë të autorizimit lëshohet fatura nga sektori i tatim-taksave vendore dhe pagesa kryhet brenda ditës. Një kopje e mandatit të pagesës paraqitet pranë DPZHT, pasi pa dorëzimin e mandat pagesës së TNI nuk merret autorizimi për punimet. Meqenëse pagesa kryhet direkt, nuk ka debitorë progresiv përsa i përket kësaj takse.

- Lidhur me lejet e ndërtimit të dhëna nga DPZHT/Bashkia Lushnjë, *rezulton se* në vitin 2025 janë dhënë leje ndërtimi dhe autorizime për kryerje punimesh. Një informacion i detajuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 13

Lejet e dhëna nga SUMT/Bashkia Lushnjë në vitin 2025					
Lloji i lejes	**Emërtimi i objektit**	**Numri**	**Preventivi (lekë)**	**Vlera e TNI-së (lekë)**	**Shënime mbi kontributin ndaj fondit publik për strehim social**
Ndërtim	Ndërtim objektesh	69		11,600,573	
		sasia	**tarifa**	**vlera**	
Autorizim për kryerje punimesh		48			
Leje zhvillimi		42		**8,710,499**	
Certifikatë përdorimi		17			
Total te ardhura nga DPZHT		***107***		***8,710,499***	
Totali TNI		**176**		**20,311,072**	

Burimi: DPZHT/Bashkia Lushnjë

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *tabelën nr. 13*, *rezulton s*e gjatë viti 2025 janë:

- janë miratuar në total 69 leje ndërtimi me vlerë totale të TNI prej 11,600,573 lekë;
- janë lëshuar 107 [autorizime + leje zhvillimi + çertifikatë përdorimi] me vlerën totale 8,710,499 lekë.

Taksa e Tarifa vendore të aplikuara (sipas rastit), për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Lushnjë.

Nga auditimi lidhur me tarifën e pastrim, ndriçimit, gjelbërim etj, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike, *rezultoi se* gjatë viti 2025 kanë kryer punime me procedura prokurimi 15 operatorë ekonomikë. Nga DAV nuk janë llogaritur taksat e tarifat vendore për OE fitues, pasi nuk ka patur informacion nga DPL/Sektori i Prokurimit Publik.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga SPP [Sektori i Prokurimit publik] *rezulton se* gjatë vitit 2025 janë 15 subjekte [OE] që kanë fituar procedurat e prokurimit për punë publike me fondet e Bashkisë Lushnjë në vlerë totale të kontratave të lidhura prej 312,333,748.4 lekë me TVSh dhe se rezulton të mos iu jenë aplikuar faturë detyrimesh mbi taksat e tarifat vendore atyre subjekteve që nuk janë regjistruar me nipt primar në Bashkinë Lushnjë. ***U konstatua*** se deri në 31.12.2025 për subjektet fituese të tenderave nuk iu janë aplikuar tarifat vendore.

Mungesa e bashkëpunimit mes strukturave: Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Sektorit të Prokurimit Publik, ka sjellë mungesën e aplikimit të taksa/tarifave vendore nga ana e DAV ndaj subjekteve që kanë fituar tendera në Bashkinë Lushnjë.

Tarifa për biletat e Pallatit të Kulturës dhe stadiumi

Nga informacioni i komunikuar nga subjekti, rezultoi se për vitin 2025 nuk ka pasur asnjë të ardhur nga shitja e biletave në pallatin e kulturës, pasi ambientet janë në rikonstruksion.

Tarifa për parkimin

Tabela nr. 14/në lekë

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Nipt-i	Vendodhja	Numri Parkingjeve	Vlera Plan Tarifë Parkingu	Paguar FAKT
	30 Subjekte			Lushnjë	46	2,300,000	2,300,000
Debia totale 30 Subjekte					***0***	***0***	***0***

Burimi: STTV/Bashkia Lushnjë

Bashkia Lushnjë ka parashikuar në Paketat fiskale të miratuara, shfrytëzimin rrugëve, e hapësirave apo terreneve për parkim, me qëllim rritjen e të ardhurave për buxhetin e bashkisë.

Nga Bashkia Lushnjë janë miratuar 46 vende parkimi për 30 subjekte në vlerën totale vjetore 2,300,000 lekë. Të ardhurat nga parkimi janë pasqyruar në tabelën e të ardhurave si zë më vete. Deri në 31.12.2025 nuk ka debitorë nga tarifa e parkimit.

III.Burimi i krijimit të të ardhurave jotatimore

Të ardhura nga tarifa e përkohshme "ndotja e mjedisit"

Tarifa e përkohshme e ndikimit në mjedis, është tarifë që vendoset me vendim të Këshillit Bashkiak duke e parë të nevojshme për ato subjekte që kanë ndikim të konsiderueshëm në mjedis dhe që janë objekt i Ligjit nr. 52/2020 datë 30.04.2020 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit"* i ndryshuar, me qëllimin që kjo tarifë të përdoret në shërbim të komunitetit, ku ushtrojnë aktivitetin e vet këto subjekte. Me kërkesë të KB Lushnjë, në vitin 2024 AKM ka monitoruar cilësinë e ajrit dhe nivelin e zhurmave në territorin e Bashkisë Lushnjë. Rezultoi se vlerat e regjistruara nuk i kalonin normat e lejuara sipas standardeve të miratuara.

Pra deri në 31.12.2025 nga Bashkia Lushnjë nuk është aplikuar tarifa e përkohshme nga "ndotja e mjedisit".

Debitor nga mospagesa e tarifave për vaditjen

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2025, detyrimet nga uji vaditës të ardhur nga DPMFAV/NPP e Bashkisë Lushnjë, situata për arkëtimet për tarifa nga vaditja paraqitet në tabelën nr.10/Aneksi A ndërsa informacioni i përmbledhur si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 15/në lekë

NJA	Nr. familje	vlera e detyrimit	Paguar /në nr.	Vlera /në lekë	Nr. Debitorë (sip dylym)	Vlera debitore
Totali					**2052**	**602,500**

Vlera debitore nga vaditja deri në 31.12.2025 është 602,500 lekë për 2052 dylym.

Debitor nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.

Nga auditimi, rezulton se gjatë vitit 2025 Policia Bashkiake ka regjistruar gjoba për kundërvajtje administrative dhe rrugore në territorin e Bashkisë Lushnjë si më poshtë:

Tabela nr. 16/në lekë

Gjendja 01.01.2025 numër	Nr.gjoba	Vlera	Paguar /nr.	Paguar /vlerë	Zbritje 50%	Debitorë/nr.	Vlera debitore 31.12.2025
Gjoba administrative							
	44	282,000	9	19,000	-	35	263000
Gjoba kundërvajtje rrugore							
	634	703,000	187	108,500	94,500	447	500,000
Totali	**678**	**985,000**	**196**	**127,500**	**94,500**	**482**	**763,000**

Burimi: DPMFAV/Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën 38* rezulton se deri në 31.12.2025 vlera debitore nga mospagesa e kundërvajtësve për gjoba të Policisë Bashkiake është 763,000 lekë për 482 kundërvajtës.

Nga gjobat e IMTV

Nga auditimi dhe relacioni i inspektorit të IMTV Bashkia Lushnjë, rezulton se gjatë vitit 2025 nga kontrollet periodike të ushtruara në territorin e Bashkisë Lushnjë, janë konstatuar ndërtime të jashtëligjshme dhe kundërvajtje administrative, për të cilat janë regjistruar gjoba si në tabelën më poshtë

Tabela nr. 17/në lekë

Deri në 31.12.2024		**Viti 2025**					
Nr. gjobash	Vlera në lekë	Nr. gjobash	Vlera në lekë	Paguar nr.	Paguar vlerë	**Debitorë**	**Vlera në lekë**
a	b	c	d	e	f	**g**	**e**
126	36,111,991	57	12,730,000	7	900,000	**50**	**11,780,000**
Totali						**(a+g)**	**(b+e)**
						176	**47,891,991**

DPMFAV//Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën 39*, rezulton se në mbyllje të vitit 2024 janë 126 debitorë në vlerën debitore prej 36,111,991 lekë dhe në datën 31.12.2025 janë 176 debitorë dhe vlera debitore prej 47,891,991 lekë, ose 50 debitorë më shumë dhe vlerë debitore prej 11,780,000 lekë më shumë se në 31.12.2024.

Nga aktiviteti i MZSH

Nga auditimi dhe relacioni i përcjellë nga DPMFAV për të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i MZSH, *rezulton se* gjatë vitit 2025 janë krijuar këto të ardhura:

Tabela nr. 18/në lekë

Nr. shërbimesh		**Nr. Shërbimesh**	**Vlera /në lekë**	**debitorë**
Llog. ekonomike	7113011	138	836,000	0

Burimi: DPMFAV//Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i pasqyruar në *tabelën 40*, rezulton se për vitin 2025 janë realizuar 138 lloj shërbime nga MZSH dhe arkëtuar 836,000 lekë.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste

Bashkia Lushnjë referuar kuadrit ligjor në fuqi, për vitin 2025 ka lidhur marrëveshjeve me debitorët për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura prej tyre, si dhe ka marrëveshje aktive të lidhura më parë me debitorët për shlyerjen e detyrimeve me këste, si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 19/në lekë

Akt Marrëveshje /nr.	Vlera totale sipas debisë në AM	Vlera e arkëtuar në 2025	**Debitorë 31.12.2025**	**Vlera e mbetur 3.12.2025**
57	8,559,574.44	5,641,246	**57**	**2,918,328.44**

Burimi: DPMFAV/Bashkia Lushnjë

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga DAV mbi akt marrëveshjet e lidhura me debitorët e taksa e tarifa vendore, rezulton se janë aktive 57 akt marrëveshje me vlerë totale të debisë 8,559,575 lekë, arkëtuar gjatë vitit 2025 vlera prej 5,641,246 lekë dhe deri në 31.12.2025 vlera debitore për shlyerje për periudhën në vijim është 2,918,329 lekë ose në masën 34.1% ndaj debisë totale.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Lushnjë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, iu referuam kuadrit ligjor si vijon:

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;

-Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar
-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;
-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)"
-VKB për miratimin e paketave fiskale për vitin 2025, përkatësisht VKB nr.111, datë 30.12.2024, në të cilat është përcaktuar tarifa e licencimit, si dhe sektori përgjegjës për lëshimin e licencës, faturës së arkëtimit;
Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë në Bashkisë Lushnjë paraqitet në tabelën nr.11/Aneksi A bashkëlidhur Projekt raportit të auditimit.
▪ Nga informacioni i evidencave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pasqyruar në *tabelën nr. 41*, ***rezulton*** *se* në Bashkinë Lushnjë kanë ushtruar aktivitetin 56 subjekte, nga të cilat:
- 33 subjekte janë pa licencë, 9 subjekte janë mbyllur/pezulluar apo çregjistruar dhe 1 subjekt ka ndryshuar aktivitet;
- 28 subjekte janë debitore deri në 31.12.2025 në vlerën totale 23,500,000 lekë nga të cilat: 1 subjekt aktiv me autorizim me vlerë debitore 1,000,000 lekë;
- janë 26 subjekte debitore që ushtrojnë aktivitetin pa licencë: 17 subjekte aktive me vlerë totale të debisë prej 14,300,000 lekë, janë 9 subjekte që e kanë mbyllur aktivitetin dhe kanë vlerë debitore prej 8,100,000 lekë dhe 1 subjekt ka ndryshuar aktivitet me vlerë debitore 100,000 lekë.
Nga Bashkia Lushnjë, nga Sektori i Licencimit dhe lejeve të transportit janë dërguar subjekteve njoftime për shlyerje detyrimesh, në banka të nivelit të dytë për bllokim të llogarive, etj.
▪ Kjo problematikë nuk është ngritur për diskutim në takimet e GMS dhe GMR, gjë që ka sjellë mungesën e hartimit të një plani masash konkret për të mundësuar arkëtimin nga subjektet debitore të vlerës prej 23,500,000 lekë.
Për sa më lartë, mosveprimet nga ana e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Lushnjë janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2025 me VKB nr.103, datë 26.11.2024,
Mungesa e bashkëpunimit mes strukturave: DAV, Policisë Bashkiake, IMT dhe e Drejtorisë Juridike, ka sjellë mosarkëtim edhe në tejkalim të afatit të detyrimeve vjetore nga taksa/tarifa, nga gjoba etj.

IV. Përjashtimet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese
Në Paketën Fiskale 2025, janë parashkuar nga DAV dhe miratuar me miratuar me VKB nr. 103 datë 26.11.2024 edhe disa kategori sociale për tre lloj taksa e tarifa. Numri i përfituesve nga lehtësira fiskale për: taksë ndërtese, trualli dhe tarifa pastrimi është 5045 tatimpagues (familjarë e biznes) në vlerën totale 17,786,078.11 lekë.
Komisioni i Apelimit Administrativ
Bashkia Lushnjë ka ngritur Komisionin e Hetimit Tatimor [KHT] me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 342 prot., datë 26.11.2025, në zbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 7 i tij;
KHT për periudhën deri në 31.12.2025 është i përbërë si në tabelën nr.12 /Aneksi A bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.
Nga auditimi *rezulton se* në Bashkinë Lushnjë është miratuar me Vendimin nr. 73 datë 20.06.2018 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të komisionit të apelimit të taksave dhe tarifave vendore".
- Gjatë vitit 2025, nuk ka patur raste të ankimeve nga subjekte apo familjarë, lidhur me detyrimet tatimore ndaj Bashkisë Lushnjë.
-Përgjegjësi për (mos)vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 42 "*Administrimi i mjeteve monetare*", pika 2, ku përcaktohet se:

"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.*"

Tabela përmbledhëse e debisë/Në lekë

Përshkrimi	**Nr.**	**Vlera e borxhit progresive deri më 31.12.2024**	**Nr.**	**Arkëtuar 2025 nga detyrimi prapambet 2024**	**Nr**	**Borxhi i Krijuar gjatë vitit 2025**	**Nr**	**Vlera e borxhit progresive më 31.12.2025**
Debitorë biznes i madh		394,926,261		18,025,816		48,460,239		425,360,684
Debitorë biznes i vogël		94,433,081		68,506		15,064,966		109,449,542
Nëntotali I		***489,359,342***		***18,094,312***		***63,525,205***		***534,810,226***
Institucione	-	-	-	-	-	-	-	-
Nëntotali II		***0***		***0***		***0***		***0***
Debitorë taksa e ndërtesës familje		323,400,037		18,187,881		31,528,319		336,740,475
Debitorët taksat familje - truall		18,782,701		1,444,883		2,053,725		19,391,543
Debitorët taksat familje - pastrim, ndriçim, gjelbërim,)		495,430,711		26,785,095		50,616,666		519,262,282
Debitorët taksa e tokës bujqësore		402,341,457		40,658,358		44,751,429		406,434,528
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.		24,853,167		5,863,779		17,808,824.94		36,798,213.17
Nëntotali III		***1,264,808,073***		***92,939,996***		***146,758,964***		***1,318,627,041***
Debitorët nga qiratë	6	6,963,228			6	177,840	6	7,141,068
Nëntotali IV	***6***	***6,963,228***			***6***	***177,840***	*6*	***7,141,068***
Total Borxhi tatimor (I+II+III+IV)		**1,761,130,643**				**210,462,009**		**1,860,578,335**

Burimi: DPMFAV/Bashkia Lushnjë

Konkluzion: Vlera debitore dhe numri i debitorëve sipas llojit të taksave apo tarifave vendore në Bashkinë Lushnjë, është si më poshtë vijon:

- Vlera debitore progresive për biznesin e madh në 31.12.2025 është 425,360,684 lekë dhe për vitin 2025 është 48,460,239 lekë;
- Vlera debitore progresive për biznesin e vogël në 31.12.2025 është 109,449,542 lekë dhe për vitin 2025 është 15,064,966 lekë;
- Vlera debitore nga mospagesa e detyrimeve vjetore për vitin 2025 nga 33 institucione është 0 lekë;
- Vlera debitore progresive nga Taksa e ndërtesës në 31.12.2025 është 336,740,475 lekë dhe për vitin 2025 është 31,528,319 lekë;
- Vlera debitore progresive nga taksat/tarifa familjare/truall në 31.12.2025 është 19,391,543 lekë dhe për vitin 2025 është 2,053,725 lekë;
- Vlera debitore progresive nga taksat/tarifa familjare/pastrim në 31.12.2025 është 519,262,282 lekë dhe për vitin 2025 është 50,616,666 lekë;
- Vlera debitore progresive nga taksa e tokës bujqësore është 406,434,528 lekë dhe për vitin 2025 është 44,751,429 lekë;
- Vlera debitore progresive nga TNI në 31.12.2025 është 36,798,213 lekë dhe për vitin 2025 është 17,808,825 lekë;
- Vlera debitore progresive nga qiratë në 31.12.2025 është 7,141,068 lekë për 6 subjekte debitore dhe për vitin 2025 është 177,840 lekë për 6 subjekte debitore;

Në total: Vlera debitore progresive deri në 31.12.2025 është 1,860,578,335 lekë dhe vetëm për vitin 2025 është krijuar debi në vlerën totale 210,462,009 lekë**.**

Vlera debitore është kontabilizuar.

III.2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE-së nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar (bilanci);
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e konsoliduar e performacës financiare;
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të flukseve monetare;
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësorë dhe shënime shpjeguese;

III.2.3.1 Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Lushnjë për vitin 2025 (në të cilat përfshihen pasqyrat financiare ushtrimore të Bashkisë Lushnjë të depozituara pranë Degës së Thesarit Lushnjë me shkresën nr. 3085 prot., datë 31.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Lushnjë me shkresën nr. 271 prot., datë 31.03.2026; Ndërmarrja e Pasurisë Publike të depozituara pranë Degës së Thesarit Lushnjë me shkresën nr. 529 prot., datë 31.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Lushnjë me shkresën nr. 272 prot., datë 31.03.2026; Qendrën e Kulturës dhe Klubit të Sportit të depozituara pranë Degës së Thesarit Lushnjë me shkresën nr. 78 prot., datë 19.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Lushnjë me shkresën nr. 258 prot., datë 25.03.2026; Qendrën e Arsimit të depozituara pranë Degës së Thesarit Lushnjë me shkresën nr. 198 prot., datë 25.03.2026, dhe konfirmuar nga DTH Lushnjë me shkresën nr. 259 prot., datë 25.03.2026) janë të nënshkruara nga znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, znj. E. Ç. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatuesit dhe znj. J. H. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, ku janë depozituar pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr. 4078 prot., datë 29.04.2026.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Lushnjë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2025:

Bashkia Lushnjë dhe Njësitë Shpenzuese 2025, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për t'u shqyrtuar**
Paga (600)	787,480	0.70	15
Sigurime Shoqërore (601)	130,653	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	276,844	0.70	5
Investime të brendshme (230-231)	264,567	2.00	15
Të tjera transferime korrente (606)	756,612	0.70	15
Total	**2,216,156**		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	**44,323**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**44,323**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	4,432		
Nëntotali	**39,891**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		

Vlera e precizionit	**35,902**		
Bashkia Lushnjë dhe Njësitë Shpenzuese 2025, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për t'u shqyrtuar**
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	0
Të ardhurat e veta	513,893	0.70	43
Total	**513,893**		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	**10,278**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**10,278**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,028		
Nëntotali	**9,250**		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	**8,325**		

III.2.3.2 Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2025, të pozicionit financiar të Bashkisë Lushnjë për bilancin e konsoliduar formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat financiare të mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë

Të dhënat sipas pasqyrave financiare të konsoliduara më datë 31.12.2025	
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**3,727,840,229**
Aktivet	5,819,161,940
Pasivet	2,091,321,711
Aktivet Neto	3,727,840,229

Lekë

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2025	**3,118,587,636**
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	798,319,546
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	269,880,149
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	2,050,387,941

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" më datë 31.12.2025, në pasqyrat financiare të konsoliduara				
Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	798,319,546	599,815,688	198,503,858
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		**798,319,546**	**599,815,688**	**198,503,858**

- **Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"** paraqitet më datë 01.01.2025, në vlerën 599,815,688 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 798,319,546 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 757,385,777 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 40,933,769 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pikat 49-50.

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" më datë 31.12.2025, në pasqyrat financiare të konsoliduara				
Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
31	Materiale	181,618,660	54,603,520	127,015,140
32	Inventar i imët	88,261,489	79,868,721	8,392,768
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		**269,880,149**	**134,472,241**	**135,407,908**

- Llogaritë e Klasës 3 sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar më datë 31.12.2025, paraqiten në vlerën 269,880,149 lekë dhe përbëhen nga llogaritë kontabël 31 "Materiale" në vlerën 181,618,660 lekë dhe 32 "Inventar i imët" në vlerën 88,261,489 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën 135,407,908 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" e cila paraqitet në vlerën 135,407,908 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 31 "Materiale"**, ka vlerën 181,618,660 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	54,603,520
Shtesa (K)	204,708,705
Pakësime (D)	77,693,598
Gjendja në 31.12.2023	**181,618,660**

- **Llogaria 32 "Inventarë i imët"**, ka vlerën 88,261,489 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	79,868,721
Shtesa (K)	18,494,018
Pakësime (D)	10,101,250
Gjendja në 31.12.2023	**88,261,489**

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" më datë 31.12.2025, në pasqyrat financiare të konsoliduara				
Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	1,937,266,058	1,824,920,844	112,345,214
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	113,121,883	108,778,794	4,343,089
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		**2,050,387,941**	**1,933,699,638**	**116,688,303**
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
Totali		**0**	**0**	**0**

- Gjendja e **llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 1,824,920,844 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 1,937,266,058 lekë me një rritje në vlerën 112,345,214 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi i objektit	Çelja më datë 01.01.2025	Shtesa (K)	Pakësime (D)	Gjendja më datë 31.12.2025
Aparati Bashkia Lushnjë					
1	Lista nga detyrimet e KLSH që para 2004 deri me 31.12.2007	11,499,597	0	0	11,499,597
2	Debirorë KLSH 2008	4,931,395	0	0	4,931,395
3	Lista debitorëve 2009	2,687,389	0	0	2,687,389

4	Detyrime KLSH 2010-2011	26,618,634	0	0	26,618,634
5	Detyrime e KLSH 01.01.2012 -30.06.2014	2,700,524	0	0	2,700,524
6	Detyrime e KLSH 01.07.2014-31.12.2015	4,327,578	0	0	4,327,578
7	Detyrime KLSH 2018-2020	264,425	0	0	264,425
8	Detyrime IMTV 2018-2025	36,661,991	12,730,000	1,450,000	47,941,991
9	Detyrimi i Njësive	1,850,762	0	0	1,850,762
10	Debitorë nga 10 NjA dhe nga NjA Toka Bujqësore + ndryshëm	1,729,314,247	192,475,344	105,150,537	1,816,639,054
11	Detyrime KLSH 01.01.2024-31.12.2024	0	6,541,005	205,166	6,335,839
12	Debitorë nga Kontratat e pashlyera të qirasë	0	7,141,068	0	7,141,068
Totali		**1,820,856,542**	**218,887,417**	**106,805,703**	**1,932,938,256**
Qendra e Arsimit					
1	Indivdë	435,707	177,707	435,707	177,707
Totali		**435,707**	**177,707**	**435,707**	**435,707**
Ndërmarrja e Pasurisë Publike					
1	Individë + qira	3,628,595	4,10,095	3,628,595	4,10,095
Totali		**3,628,595**	**4,10,095**	**3,628,595**	**4,10,095**
Grand Totali		**1,824,920,844**	**219,065,124**	**110,870,005**	**1,933,115,963**

- Gjendja e **llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 108,647,476 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 113,121,884 lekë me një rritje në vlerën 4,474,408 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa dhe sigurime shoqërore, furnitorë e llogari të lidhura me to dhe kreditorë të ndryshëm. Kjo llogari kuadron me përmbledhësen e llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në vlerën 12,226,871 lekë, 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 55,029,570 lekë, 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" në vlerën 3,848,457 lekë, 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 16,236,920 lekë, 436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 2,246,093 lekë dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 23,533,973 lekë ku totali shkon në vlerën 113,121,884 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë

Gjendja e llogarive të Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" më datë 31.12.2025, në pasqyrat financiare të konsoliduara					
Llogaria	**Bashkia Lushnjë**	**NPP**	**QKKS**	**QA**	**Totali**
401-408	3,975,386	3,202,974	40,421	5,008,090	12,226,871
42	19,167,378	11,109,381	3,091,974	21,660,837	55,029,570
431	1,865,779	288,528	298,878	1,395,272	3,848,457
435	5,876,510	3,144,714	922,187	6,293,509	16,236,920
436	808,324	436,407	127,978	873,384	2,246,093
467	17,679,378	5,854,595	0	0	23,533,973
Totali	**49,372,755**	**24,036,599**	**4,481,438**	**35,231,092**	**113,121,884**
4342	49,372,754	24,036,599	4,481,438	35,231,092	113,121,884
Diferenca	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
	II. Aktive Afatgjata	**2,700,574,302**	**2,799,910,298**	**(99,335,996)**
20	**1. Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**	**0**
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	0	0	0
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**2,700,574,302**	**2,799,910,298**	**(99,335,996)**
210	Toka, Troje, Terene	20,776,107	20,776,107	0
211	Pyje, Plantacione	249,000	249,000	0
212	Ndërtesa e konstruksione	1,428,891,448	1,369,419,262	59,472,186
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,062,150,590	1,228,862,722	(166,712,132)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	60,416,468	62,746,506	(2,330,038)
215	Mjete transporti	90,096,650	77,848,610	12,248,040
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	37,994,040	40,008,090	(2,014,050)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0

28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	**3. Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**	**0**
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	4. Investime	**0**	**0**	**0**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	0	0	0

1. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 20,776,107 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 20,776,107 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	210 "Toka, troje, terrene"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	15,786,107	0	0	4,990,000	20,776,107
	2	Amortizim i akumuluar	0	0	0	0	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**15,786,107**	**0**	**0**	**4,990,000**	**20,776,107**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0	0	0	0	0
	5	Amortizim i shtesës	0	0	0	0	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0	0	0	0	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	0	0
	4	Kosto historike	15,786,107	0	0	4,990,000	20,776,107
	5	Amortizim i akumuluar	0	0	0	0	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**15,786,107**	**0**	**0**	**4,990,000**	**20,776,107**

- **Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 249,000 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 249,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	211 "Pyje, kullota, plantacione"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	249,000	0	0	0	249,000
	2	Amortizim i akumuluar	0	0	0	0	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**249,000**	**0**	**0**	**0**	**249,000**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0	0	0	0	0
	5	Amortizim i shtesës	0	0	0	0	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0	0	0	0	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	0	0
	4	Kosto historike	249,000	0	0	0	249,000
	5	Amortizim i akumuluar	0	0	0	0	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**249,000**	**0**	**0**	**0**	**249,000**

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 1,369,419,262 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 134,676,998 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 723,090,587 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,428,891,448 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	212 "Ndërtesa e konstruksione"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	618,732,369	9,773,623	12,420,392	1,376,378,651	2,017,305,035
	2	Amortizim i akumuluar	158,288,612	5,377,353	3,494,795	480,725,013	647,885,773
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**460,443,757**	**4,396,270**	**8,925,597**	**895,653,638**	**1,369,419,262**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	127,908,998	0	0	6,768,000	134,676,998
	5	Amortizim i shtesës	29,417,638	219,814	446,280	45,121,082	75,204,814
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0	0	0	0	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	0	0
	4	Kosto historike	746,641,368	9,773,623	12,420,392	1,383,146,651	2,151,982,034
	5	Amortizim i akumuluar	187,706,250	5,597,167	3,941,075	525,846,095	723,090,587
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**558,935,118**	**4,176,457**	**8,479,317**	**857,300,556**	**1,428,891,448**

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë analitike 210 "Toka, troje, terrene" u konstatua se gjatë vitit 2024 janë bërë shtesa në këtë llogari troje, parcelat bujqësore dhe gurore me sipërfaqe totale 648,608 m^2 por me vlerë 17 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" konstatohet se gjatë vitit ushtrimor 2024 janë shtuar 12 ndërtesa, të cilat janë kontabilizuar në shumën 12 lekë, pra 1 lek për ndërtesë. Efekti në pasqyrat financiare të vitit 2024 është mosparaqitje e drejtë dhe e saktë e aktiveve në pozicionin financiar. Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare informacioni i pasqyruar në pozicionin financiar të Bashkisë nuk është i drejtë dhe i saktë.

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,228,862,722 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 95,601,421 lekë dhe amortizim të

akumuluar në vlerën 3,638,042,492 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,0662,150,590 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	213 "Rrugë rrjete vepra ujore"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,737,398,104	864,038,403	0	3,155,154	4,604,591,661
	2	Amortizim i akumuluar	3,095,130,084	279,492,826	0	1,106,029	3,375,728,939
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**642,268,020**	**584,545,577**	**0**	**2,049,125**	**1,228,862,722**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	84,241,890	11,359,531	0	0	95,601,421
	5	Amortizim i shtesës	145,301,982	116,909,115	0	102,456	262,313,553
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0	0	0	0	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	0	0
	4	Kosto historike	3,821,639,994	875,397,934	0	3,155,154	4,700,193,082
	5	Amortizim i akumuluar	3,240,432,066	396,401,941	0	1,208,485	3,638,042,492
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**581,207,928**	**478,995,993**	**0**	**1,946,669**	**1,062,150,590**

- Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" konstatohet se nga viti 2005 deri në vitin 2015 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 48,138,931 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sh.a Lushnjë por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Lushnjë. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Lushnjë dhe UKL Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 35-36. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Lushnjë për UKL Sh.a për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vlera kontabël	Viti
1	KUZ Fabrika e miellit-kryqëzimi në Lagjen Stan	9,461,543	2005
2	KUZ Stacioni i trenit	298,000	2006
3	KUZ Qytet	8,067,297	2008
4	KUZ Sabri Kosturi	10,233,330	2008
5	KUZ + KUB Sarave	5,270,088	2006
6	KUZ Sarave	2,510,850	2008
7	KUZ Lagja Saver	5,377,185	2013
8	KUZ Lagja 18 Tetori	3,943,148	2013
9	KUB Lagja Skënder Libohova	2,977,490	2015
Total		**526,345,079**	**145,524,758**

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 62,746,506 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 12,218,448 lekë, pakësime në vlerën 4,359,064 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 111,276,806 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 60,416,468 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	25,893,582	46,135,070	13,582,934	78,222,305	163,833,891
	2	Amortizim i akumuluar	22,881,188	27,007,475	4,600,722	46,597,998	101,087,383
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**3,012,393**	**19,127,595**	**8,982,212**	**31,624,306**	**62,746,506**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	1,168,871	9,174,240	0	1,875,337	12,218,448
	5	Amortizim i shtesës	682,857	3,825,519	898,221	8,374,911	13,781,508
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	766,978	0	0	3,592,086	4,359,064
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	3,592,086	3,592,086
	4	Kosto historike	26,295,475	55,309,310	13,582,934	76,505,556	171,693,275
	5	Amortizim i akumuluar	23,564,046	30,832,994	5,498,943	51,380,823	111,276,806
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**2,731,429**	**24,476,316**	**8,083,991**	**25,124,732**	**60,416,468**

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 77,848,610 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 25,984,800 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 110,467,378 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 90,096,650 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	215 "Mjete transporti"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	24,049,177	147,452,051	0	3,078,000	174,579,228
	2	Amortizim i akumuluar	14,610,664	79,317,014	0	2,802,940	96,730,618
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**9,438,513**	**68,135,037**	**0**	**275,060**	**77,848,610**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	5,956,800	18,108,000	0	1,920,000	25,984,800
	5	Amortizim i shtesës	0	13,627,007	0	109,753	13,736,760

	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0	0	0	0	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	0	0
	4	Kosto historike	30,005,977	165,560,051	0	4,998,000	200,564,028
	5	Amortizim i akumuluar	14,610,664	92,944,021	0	2,912,693	110,467,378
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**15,395,313**	**72,616,030**	**0**	**2,085,307**	**90,096,650**

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 40,008,089 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,416,696 lekë, pakësime në vlerën 2,305,198 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 103,688,559 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 37,994,040 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	218 "Inventar ekonomik"	Aparati	NPP	QKKS	QA	Totali
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	16,382,062	6,147,054	5,498,245	108,543,739	136,571,100
	2	Amortizim i akumuluar	14,824,462	2,291,639	3,448,323	75,998,588	96,563,012
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**1,557,600**	**3,855,415**	**2,049,922**	**32,545,152**	**40,008,089**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0	0	0	7,416,696	7,416,696
	5	Amortizim i shtesës	278,200	771,083	204,992	7,992,369	9,246,644
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	166,600	17,501	0	2,121,097	2,305,198
	7	Amortizim nga pakësimet	0	0	0	2,121,097	2,121,097
	4	Kosto historike	16,215,462	6,129,553	5,498,245	113,839,338	141,682,598
	5	Amortizim i akumuluar	15,102,662	3,062,722	3,653,315	81,869,860	103,688,559
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**1,112,800**	**3,066,831**	**1,844,930**	**31,969,479**	**37,994,040**

- Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, pesë llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pa ndryshuar në vite të shprehur përkatësisht: 210 "Toka, troje, terrene" në vlerën 4,990,000 lekë (Qendra e Arsimit) dhe 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 4,176,457 lekë, 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 478,995,993 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në vlerën 14,574,498 lekë dhe 215 "Mjete transporti" në vlerën 50,661,092 lekë (Ndërmarrja e Pasurisë Publike) gjendje të cilat nuk janë të analizuara me emërtesat çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II, pika 5, Kreu III, pika 30.

- Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata material u konstatua se, për disa llogari janë aplikuar norma amortizimi jo në përputhje me rregullat kontabël konkretisht:
a) Për vitin 2025 Qendra e Arsimit ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" vlerën 102,456 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 409,225 lekë në masën 20% (2,049,125 lekë * 20% / 100 = 409,225 lekë);
b) Për vitin 2025 Qendra e Arsimit ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" vlerën 8,374,911 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 6,699,928 lekë në masën 20% (31,624,306 lekë çelja e vitit + 1,875,337 lekë shtesa e vitit * 20% / 100 = 6,699,928 lekë) dhe Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit vlerën 898,221 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 1,796,442 lekë në masën 20% (8,982,212 lekë * 20% / 100 = 1,796,442 lekë);
c) Për vitin 2025 Bashkia Lushnjë nuk ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhej të aplikohej normë amortizimi në vlerën 3,079,062 lekë në masën 20% (9,438,513 lekë çelja e vitit + 5,956,800 lekë shtesa e vitit * 20% / 100 = 3,079,062 lekë) dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" vlerën 13,627,007 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 17,248,607 lekë në masën 20% (68,135,037 lekë çelja e vitit + 18,108,000 lekë shtesa e vitit * 20% / 100 = 17,248,607 lekë);
d) Për vitin 2025 Bashkia Lushnjë ka aplikuar normë amortizimi në vlerën 278,200 lekë për llogarinë 218 "Inventar ekonomik"; NPP vlerën 771,083 lekë; QKKS vlerën 204,992 lekë dhe QA vlerën 7,992,369 lekë në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Për më tepër QKKS ka aplikuar normë amortizimi në masën 10% për llogarinë 218 "Inventar ekonomik". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë

së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 36.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë në cilësinë e NA, znj. E. Ç. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e NZ dhe znj. J. H. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave; znj. B. D. Drejtor QKKS-së në cilësinë e NA, znj. Y. Gj. Përgjegjës i Financës në cilësinë e NP; z. M. Sh. Drejtor QA-së në cilësinë e NA, z. L. H. Përgjegjës i Financës në cilësinë e NP; z. E. Z. Drejtor NPP-së në cilësinë e NA, znj. A. C. Përgjegjës i Financës në cilësinë e NP.

- Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 7,279,000 lekë. Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë. Në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë që posedon në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë me Nipt M.....K në masën 37.79% në vlerën 3,779,000 lekë (37.79% * 10,000,000 lekë / 100 = 3,779,000 lekë) sipas Marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime me nr. 1592 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM-it, Bashkisë Lushnjë dhe Bashkisë Divjakë.
Gjithashtu në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë që posedon në Shoqërinë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" me Nipt L.C. Vlera e aksioneve të Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" është 3,500,000 lekë sipas Ekstraktit Historik në QKB dhe Vendimit nr. 60, datë 06.09.2013, të Këshillit Bashkiak Lushnjë me objekt "Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lushnjë si aksionar i vetëm në themelimin e Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" si zotërues në masën 100% të kapitalit të kësaj shoqërisë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë në cilësinë e NA, znj. E. Ç. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e NZ dhe znj. J. H. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

4. Investimet
Gjendja e llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2025 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht: Kontrata me nr. 8578 prot., datë 01.10.2025, me objekt "Rehabilitimi i shkarkuesit në rezervuarin e Kasharaj" me vlerë kontrate 32,964,687 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 17,615,760 lekë; Kontrata me nr. 8780 prot., datë 07.10.2025, me objekt "Rindërtimi i shkollës së mesme të bashkuar "Zyber Sharka" me vlerë kontrate 56,699,683 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 13,305,306 lekë;
Kontrata me nr. 10112 prot., datë 12.11.2025, me objekt "Sistemime rrugore në Lagjen "18-Tetori", ndërmjet rrugëve "Hysni Gorovelli" dhe "Athina Dhimitri" me vlerë kontrate 31,929,696 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 7,134,456 lekë. Vlera e likuiduar prej 38,055,522 lekë që i përket kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë në cilësinë e NA, znj. E. Ç. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e NZ dhe znj. J. H. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, llogaritë 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" dhe 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë të cilat kuadrojnë me shumatoren e llogarive 115 "Nga fondet e veta të investimeve" dhe 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" të cilat paraqiten në vlerën 0 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, gërma "c".

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Lushnjë më datën 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	12,226,871	8,658,530	3,568,341
42	Detyrime ndaj personelit	55,029,570	54,308,373	721,197
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	3,848,457	3,696,195	152,262
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	16,236,920	16,007,751	229,169
436	Sigurime shëndetësore	2,246,093	2,212,906	33,187
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	40,933,769	33,118,311	7,815,458
467	Kreditorë të ndryshëm	23,533,973	76,586,403	(53,052,430)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	1,937,266,058	1,824,920,844	112,345,214
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		**2,091,321,711**	**2,019,509,313**	**71,812,398**

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** më datë 01.01.2025, është në vlerën 8,658,530 lekë në të cilën duhet të paraqiten faturat e pa likuiduara nga Bashkia Lushnjë. Përgjatë vitit për këtë llogari shtesa në vlerën 261,587,167 lekë dhe pakësime në vlerën 258,018,826 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 12,226,871 lekë me një rritje në vlerën 3,568,341 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2025	8,658,530
Shtesa (K)	261,587,167
Pakësime (D)	258,018,826
Gjendja debitore në 31.12.2025	**12,226,871**

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 55,029,570 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2025 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	54,308,373
Shtesa (K)	262,764,559
Pakësime (D)	262,043,362
Gjendja debitore në 31.12.2025	**55,029,570**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	**Datë**	
1	08.01.2026	956,357
2	08.01.2026	216,420

3	08.01.2026	769,030
4	08.01.2026	835,075
5	08.01.2026	1,303,960
6	08.01.2026	6,629,162
7	08.01.2026	873,906
8	08.01.2026	399,904
9	08.01.2026	1,871,722
10	08.01.2026	719,630
11	08.01.2026	614,089
12	08.01.2026	455,351
13	08.01.2026	2,477,420
14	08.01.2026	284,296
15	08.01.2026	356,563
16	08.01.2026	72,120
27	15.01.2026	190,573
111	11.02.2026	44,724
112	11.02.2026	44,724
113	11.02.2026	44,724
17	08.01.2026	7,628
1	08.01.2026	172,377
2	08.01.2026	93,385
3	08.01.2026	1,287,240
4	08.01.2026	1,014,545
5	08.01.2026	211,754
6	08.01.2026	312,673
1	08.01.2026	14,935,782
2	08.01.2026	792,489
3	08.01.2026	756,274
4	08.01.2026	706,036
5	08.01.2026	408,250
6	08.01.2026	979,901
7	08.01.2026	2,681,805
8	08.01.2026	36,130
9	08.01.2026	133,575
10	08.01.2026	50,025
14	20.01.2026	10,000
15	20.01.2026	11,500
16	20.01.2026	17,800
17	20.01.2026	6,300
26	29.01.2026	45,111
27	29.01.2026	44,384
28	29.01.2026	45,475
1	12.01.2026	3,483,308
2	12.01.2026	5,493,427
3	12.01.2026	42,785
4	12.01.2026	544,104
5	14.01.2026	1,539,007
6	14.01.2026	6,750
Totali		**55,029,570**

Burimi i të dhënave: Bashkia Lushnjë.

- **Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",** paraqitet në vlerën 3,848,457 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	3,696,195
Shtesa (K)	27,900,954
Pakësime (D)	27,748,692
Gjendja debitore në 31.12.2025	**3,848,457**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
28	15.01.2026	136,411
29	15.01.2026	74,781
30	15.01.2026	56,938
31	15.01.2026	151,723
32	15.01.2026	1,172,752
33	15.01.2026	169,479
34	15.01.2026	65,475
35	15.01.2026	31,200
110	11.02.2026	7,020
6	08.01.2026	290,808
6	08.01.2026	8,070

11	08.01.2026	1,263,290
12	08.01.2026	59,891
13	08.01.2026	72,091
7	14.01.2026	129,592
8	14.01.2026	79,843
9	14.01.2026	65,813
10	14.01.2026	13,280
Totali		**3,848,457**

Burimi i të dhënave: Bashkia Lushnjë.

- **Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 16,236,920 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	16,007,751
Shtesa (K)	75,135,885
Pakësime (D)	74,961,886
Gjendja debitore në 31.12.2025	**16,236,920**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
28	15.01.2026	361,206
29	15.01.2026	232,809
30	15.01.2026	286,098
31	15.01.2026	512,442
32	15.01.2026	3,737,865
33	15.01.2026	481,102
34	15.01.2026	189,548
35	15.01.2026	36,485
114	11.02.2026	38,955
11	08.01.2026	5,680,939
12	08.01.2026	348,670
13	08.01.2026	263,900
7	14.01.2026	772,232
7	14.01.2026	907,756
7	14.01.2026	220,276
7	14.01.2026	25,073
8	14.01.2026	489,081
8	14.01.2026	574,910
8	14.01.2026	139,507
8	14.01.2026	15,879
11	14.01.2026	992,187
Totali		**16,236,920**

Burimi i të dhënave: Bashkia Lushnjë.

- **Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 2,246,093 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2025	2,212,906
Shtesa (K)	10,326,018
Pakësime (D)	10,300,475
Gjendja debitore në 31.12.2025	**2,246,093**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
28	15.01.2026	50,126
29	15.01.2026	32,310
30	15.01.2026	39,708
31	15.01.2026	59,060
32	15.01.2026	520,488
33	15.01.2026	66,762
34	15.01.2026	26,304
35	15.01.2026	8,160
114	11.02.2026	5,406

11	08.01.2026	788,374
12	08.01.2026	48,386
13	08.01.2026	36,624
7	14.01.2026	87,52
7	14.01.2026	102,877
7	14.01.2026	24,964
7	14.01.2026	2,842
8	14.01.2026	87,520
8	14.01.2026	102,878
8	14.01.2026	24,964
8	14.01.2026	2,842
12	14.01.2026	127,978
Totali		**2,246,093**

Burimi i të dhënave: Bashkia Lushnjë.

- **Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Lushnjë më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 33,118,311 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Përgjatë vitit për këtë llogari shtesa në vlerën 11,748,177.80 lekë dhe pakësime në vlerën 3,932,719.80 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 40,933,769 lekë me një rritje në vlerën 7,815,458 lekë. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Lushnjë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2025	33,118,311
Shtesa (K)	11,748,177.80
Pakësime (D)	3,932,719.80
Gjendja debitore në 31.12.2025	**40,933,769**

- Për 50 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Lushnjë janë ngurtësuar fonde në vlerën 20,950,887 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Lushnjë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 20,950,887 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 6-7.

- **Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"** më datë 01.01.2025, është në vlerën 23,895,039 lekë në të cilën duhet të paraqiten faturat e pa likuiduara nga Bashkia Lushnjë për investime, mallra dhe shërbime. Përgjatë vitit për këtë llogari shtesa në vlerën 93,148,823 lekë dhe pakësime në vlerën 93,941,994 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 23,533,972 lekë me një pakësim në vlerën 361,067 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	23,895,039
Shtesa (K)	93,148,823
Pakësime (D)	93,941,994
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**23,533,972**

Lekë

Nr.	**Përshkrimi**	**Gjendje 01.01.2025**	**Shtesa 2025**	**Pakësime 2025**	**Gjendje 31.12.2025**
Aparati i Bashkisë Lushnjë					
1	Shërbime	1,729,166	917	917	1,729,166
2	Mirëmbajtje	480,000	0	0	480,000
3	Investime	15,321,881	78,595,355	78,956,421	14,960,814
4	Mallra	419,068	0	0	419,068
5	Shpronësime	90,329	0	0	90,329
Ndërmarrja e Pasurisë Publike					
6	Taksa vjetore e mjeteve të prapambetura TVMP 2013 + Gjoba	1,388,274	541,418	541,418	1,388,274
7	Energji Elektrike e Prapambetur	0	6,298,385	6,298,385	0
8	Mirëmbajtje	3,138,125	0	0	3,138,125
9	Investime	638,344	0	0	638,344
10	Rehabilitimi i kanalit ujitës U-3-25,U-3-25/1,U-3-25/2	0	3,661,080	3,661,080	0
11	I.C.C G. ShPK	0	3,661,080	3,661,080	0
12	Shërbim supervizimi për punimet në kanalin U-3-25,U-3-25/1,U-3-25	0	347,190	347,190	0
13	Shërbim kolaudimi për punimet në kanalin U-3-25,U-3-25/1,U-3-25/2		43,398	43,398	0

14	Blerje materiale çakull për ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve	689,852	432,10	432,105	689,852
Totali		**23,895,039**	**93,148,823**	**93,941,994**	**23,533,972**

Nga auditimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" u konstatuan transaksione të keq klasifikuara në shumën 17,950,115 lekë. Kjo shumë përbëhet nga transaksione lidhur me shpenzime për shërbime dhe mirëmbajtje në shumën 2,209,167 lekë, transaksione lidhur me blerje mallrash në shumën 419,068 lekë si dhe transaksione lidhur me investimet në shumën 15,321,881 lekë të cilat nuk plotësojnë kriteret për t'u kontabilizuar në këtë llogari, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1 funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4.

- **Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"** më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 1,824,920,844 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 1,937,266,058 lekë me një rritje në vlerën 112,345,214 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"	
Çelje e vitit 2025	1,824,920,844
Shtesa (K)	219,489,917
Pakësime (D)	107,101,703
Gjendja debitore në 31.12.2025	**1,937,266,058**

Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe regjistrimeve kontabël të Bashkisë Lushnjë për vitin 2025 u konstatua se në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)", janë evidentuar detyrime më datë 31.12.2025, në vlerën 1,937,266,058 lekë. Nga verifikimi i trajtimit kontabël të këtyre vlerave u konstatua se, detyrimet e evidentuara në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" janë trajtuar si kundërparti të detyrimeve që kanë të tretët ndaj Bashkisë Lushnjë që janë kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm". Ndërkohë që referuar trajtimit kontabël të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", kundërpartia e saj është llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 7.

Lekë

C	**AKTIVET NETO/FONDET (A-B)**	**3,727,840,227**	**3,501,079,916**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**3,727,840,229**	**3,505,156,670**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,970,454,452	2,938,459,293
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	757,385,777	566,697,377
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	**TOTALI I PASIVEVE (B+C)**	**5,819,161,936**	**5,471,974,619**

Lekë

Fondi i konsoliduar	**Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"**			
	Mbyllje më datë 31.12.2025		**Çelje më datë 01.01.2025**	
3,727,840,229	**Debi**		**Kredi**	
			2,938,459,293	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2024
	6,664,262	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	275,898,364	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	374,283,280	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	135,407,908	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	**380,947,542**		**3,349,765,565**	
3,349,765,565 – 380,947,542 = 2,968,818,023				
2,968,818,023 – 2,970,454,452 = - 1,636,429				

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 2,938,459,293 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 275,898,364 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 135,407,908 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101

"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 6,664,262 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 374,283,280 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,636,4360 lekë. Kjo problematikë është konstatuar në Qendrën e Arsimit si pasojë e mos aplikimit të saktë të normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17. Të dhënat në mënyrë analitike mbi kuadrimin e llogarive paraqiten si më poshtë:

Lekë

Njësia Shpenzuese	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 01.01.2025	Shtesat përgjatë vitit 2025	Ndryshimi i gjendjes së invetarit	Pakësimet e përgjatë vitit 2025	Amortizimi vjetor	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 31.12.2025 sipas përllogaritjes së grupit të auditimit	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 31.12.2025, sipas pasqyrave financiare të njësive shpenzuese	Diferenca
Aparati	1,146,562,391	219,276,560	2,679,031	933,578	175,680,677	1,191,903,727	1,191,903,726	**11**
NPP	731,288,135	38,641,771	120,263,749	17,501	135,352,538	754,823,616	754,823,616	**0**
QKKS	27,699,982	0	941,677	0	1,549,493	27,092,166	27,092,166	**0**
QA	1,032,908,785	17,980,033	11,523,451	5,713,183	61,700,572	994,998,514	996,634,944	**1,636,430**
Totali	**2,938,459,293**	**275,898,364**	**135,407,908**	**6,664,262**	**374,283,280**	**2,968,818,023**	**2,970,454,452**	**1,636,441**

Burimi: Bashkia Lushnjë/Punoi Grupi i auditimit

*Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi***:** z. M. Sh. Drejtor QA-së në cilësinë e NA, z. L. H. Përgjegjës i Financës në cilësinë e NP.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 243,072,448 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 284,742,605 lekë ose me një rritje në vlerën 41,670,157 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**284,742,605**	**243,072,448**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**45,537,097**	**653,253**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	45,097,799	0
7001	Tatimi mbi fitimin	328,028	578,253
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	111,270	75,000
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**177,886,457**	**185,537,167**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	151,658,842	181,996,463
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	26,227,615	3,540,704
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**61,319,051**	**56,882,028**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	6,808,137
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	61,319,051	50,073,892
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	**5. Taksë e rrugës**	**0**	**0**
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**	**0**	**0**
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**	**0**	**0**

2. Të ardhurat jo tatimore:

- Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 181,179,367 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 161,952,114 lekë ose me një pakësim në vlerën 19,227,253 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**161,952,114**	**181,179,367**

710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**11,605,785**	**13,510,315**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	11,605,785	13,510,315
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**150,346,329**	**167,669,052**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	121,826,794	137,275,015
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	23,996,358	23,322,956
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	859,700	676,700
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	3,663,478	6,394,381
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	**3. Të tjera të ardhura jo tatimore**	**0**	**0**

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 "Grante korente",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 2,134,076,795lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,362,891,021 lekë ose me një rritje në vlerën 228,814,226 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	**V. GRANTE KORENTE**	**2,362,891,021**	**2,134,076,795**
720	**1. Grant korent i brendshëm**	**2,362,891,021**	**2,134,076,795**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	1,381,334,703	1,219,138,736
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	824,770,148	733,852,740
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	63,115,020	95,437,734
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	89,587,910	84,883,754
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	4,083,240	763,830
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	**2. Grant korent i huaj**	**0**	**0**
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

4. Të ardhura të tjera:

- **"Të ardhura të tjera",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 362,366,607 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 566,697,377 lekë ose me një rritje në vlerën 204,330,770 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhura të tjera paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	VI. Të ardhura të tjera	**566,697,377**	**362,366,607**
781	Të ardhura nga investimet në ekonomi	0	0
782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktivet afatshkurtra	0	0
783	Rimarrje shumash të parashikauar për aktivet afat gjata	0	0
784	Rimarrje shumash për shpenzime të viteve të ardhshme	0	0
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve	566,697,377	362,366,607

Nga auditimi i llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" u konstatua se shuma 566,697,377 lekë, e cila përfaqëson mjete monetare të trashëguara nga periudhat e mëparshme kontabël, është kontabilizuar në të ardhura të periudhës. Këto mjete monetare janë konstatuar, kontabilizuar dhe janë pasqyruar në pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme kontabël. Kontabilizimi sërish i këtyre mjeteve monetare në të ardhura të periudhës ka efekt në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare duke dhënë një rezultat jo të drejtë dhe të saktë të periudhës për njësinë duke e mbivlerësuar atë në shumën 362,366,608 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 21.02.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar pika 3.

5. Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve:

-**"Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 1,912,795 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,679,031 lekë ose me një rritje në vlerën 766,236 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
73	VII. Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve	2,679,031	1,912,795

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 713,433,612 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 788,271,641 lekë ose me një rritje në vlerën 74,838,029 lekë.
- **Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 118,727,086 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 130,605,216 lekë ose me një rritje në vlerën 11,878,130 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Lushnjë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	787,073,378	712,860,778
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	1,198,263	572,834
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	117,302,249	106,639,455
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	13,302,967	12,087,631
Totali		**918,876,857**	**832,160,698**

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime",** në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 281,905,881 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 280,114,806 lekë ose me një pakësim në vlerën 1,791,075 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Lushnjë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	**III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME**	**280,114,806**	**281,905,881**
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	7,120,864	5,831,268
6021	Materiale dhe shërbime speciale	93,809,669	96,127,520
6022	Shërbime nga të tretë	80,734,256	76,468,130
6023	Shpenzime transporti	51,206,917	52,809,019
6024	Shpenzime udhëtimi	9,723,975	175,776
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	9,289,920	8,270,940
6026	Shpenzime për qiramarrje	878,050	5,592,315
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	3,344,646	16,401,541
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	24,006,509	20,229,372

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi.

- **Llogaria 603 "Subvencione",** në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 52,053,379 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 53,237,777 lekë ose me një rritje në vlerën 1,184,398 lekë. Të cilat administrohen nga Bashkia e Lushnjë për llogari të QKKS-së dhe më pas nga kjo e fundit i kalojnë Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930".

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
603	**IV. SUBVENCIONE**	**53,237,777**	**52,053,379**
6030	Subvencione për diferencë çmimi	0	0
6031	Subvencione për të nxitur punësimin	0	0
6032	Subvencione për të mbuluar humbjet	0	0
6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale	0	0
6039	Subvencione të tjera	53,237,777	52,053,379

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 "Transferime të brendshme"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 0 lekë.
Gjendja e llogarisë së fondeve **606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 701,978,502 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	V. TRANSFERIME KORENTE	**701,978,502**	**706,468,919**
604	**1. Transferime korente të brendshme**	**0**	**0**
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	0	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	0	0
606	**3. Transferime për buxhetet familjare e individë**	**701,978,502**	**706,468,919**
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	701,978,502	706,468,919

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 3,378,962,149 lekë dhe totali shpenzimeve është 2,621,576,372 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 757,385,777 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 757,385,777 lekë.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

- **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to, shpërblimeve:**

Nga Bashkia Lushnjë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

III.2.3.3 Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,.

- ✓ **Aparati i Bashkisë Lushnjë:**

- Me Urdhrin nr. 351, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në magazinën e bashkisë, 5 njësitë (rajonet), në Zyrat e Gjendjes Civile, të QKR-së, Sektorit të MZSH-së, i përbërë nga znj. A. Z. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. E. A., znj. I. B., z. E. P., znj. F. K.

Me shkresën pa numrër protokolli dhe pa datë nga komisioni i inventarizimit është dërguar informacion pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në lidhje me realizimin e procesit të inventarizimit (relacioni i vlerësimit).

Me shkresën nr. 363 prot., datë 12.01.2026, znj. E. Ç. Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është hartuar Relacioni Përmbledhës i Vlerësimit për të cilën është arritur në konkluzionin se Njësitë Administrative Allkaj, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë, Kolonjë dhe Krutje nuk kanë pasur materiale për nxjerrje jashtë përdorimit ndërsa në total janë vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive në vlerën totale prej 1,723,468 lekë që i përkasin llogarive 327 "Inventar i imët" në vlerën 791,890 lekë, 214 "Instalime teknike makineri dhe pajisje" në vlerën 766,978 lekë dhe 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 164,600 lekë.

Me shkresën nr. 578 prot., datë 14.01.2026, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është adresuar Këshillit Bashkiak me një informacion mbi realizimin e procesit të inventarizimit, ku bashkëlidhur ndodhen edhe vendimet respektive mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve konkretisht:

1. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 20, datë 13.01.2026, për Qendrën e Arsimit;
2. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 21, datë 13.01.2026, për Qendrën Kulturore dhe Klubi i Sportit;
3. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 22, datë 13.01.2026, për Ndërmarrjen e Pasurisë Publike;
4. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 23, datë 13.01.2026, për Bashkinë (Bashki+Njësi Administrative);

- Me Urdhrin nr. 352, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Allkaj, i përbërë nga znj. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. G. L., z. N. Z.;
Me shkresën nr. 10 prot., datë 09.01.2026, znj. M. T. Administrator i NjA Allkaj është adresuar me njoftim mbi përfundimin e inventarizimit dhe materialet e dala jashtë përdorimit Bashkisë Lushnjë, bashkëlidhur ndodhet relacioni përkatës.
- Me Urdhrin nr. 352/1, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Ballagat, i përbërë nga z. F. M. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. V. G., znj. A. Gj.;
Me shkresën pa datë dhe pa numër protokolli znj. A. L. Administrator NjA Ballagat është adresuar me njoftim mbi përfundimin e inventarizimit dhe materialet e dala jashtë përdorimit Bashkisë Lushnjë, bashkëlidhur ndodhet relacioni përkatës.
- Me Urdhrin nr. 352/2, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Bubullimë, i përbërë nga z. D. M. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. E. K., z. A. K.;
Me shkresën nr. 1090 prot., datë 30.12.2025, është hartuar relacioni pas përfundimit të procesit të inventarizimit ku janë vlerësuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 84,000 lekë që i përkasin 327 "Objekte inventari" në vlerën 1,750 lekë dhe 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 82,250 lekë.
- Me Urdhrin nr. 352/3, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Dushk, i përbërë nga z. B. V. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. B. E., znj. O. L.;
Me shkresën nr. 3 prot., datë 06.01.2026, z. B. V. Administrator i NjA Dushk është adresuar me njoftim mbi përfundimin e inventarizimit dhe materialet e dala jashtë përdorimit që i përkasin llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 6,500 lekë.
- Me Urdhrin nr. 352/4, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Fiershegan, i përbërë nga z. F. M. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A. T., z. A. H.;
Me shkresën nr. 949 prot., datë 23.12.2025, është hartuar relacioni pas përfundimit të procesit të inventarizimit ku janë vlerësuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 70,850 lekë që i përkasin 327 "Objekte inventari" në vlerën 1,000 lekë dhe 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 70,850 lekë.
- Me Urdhrin nr. 353, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Golem, i përbërë nga z. O. S. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. S., z. A. S.;
Me shkresën pa datë dhe pa numër protokolli, është hartuar relacioni pas përfundimit të procesit të inventarizimit ku janë vlerësuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 88,560 lekë që i përkasin 327 "Objekte inventari" në vlerën 1,560 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje" në vlerën 81,000 lekë dhe 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 6,000 lekë.
- Me Urdhrin nr. 353/1, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Hysgjokaj, i përbërë nga z. H. D. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. E. M., znj. E. Xh.;
Me shkresën nr. 7 prot., datë 06.01.2026, z. H. D. Administrator i NjA Allkaj është adresuar me njoftim mbi përfundimin e inventarizimit dhe materialet e dala jashtë përdorimit Bashkisë Lushnjë, bashkëlidhur ndodhet relacioni përkatës.
- Me Urdhrin nr. 353/2, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Karbunarë, i përbërë nga znj. N. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. P. B., z. R. A.;
Me shkresën pa datë dhe pa numër protokolli nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar raporti përmbledhës pas përfundimit të procesit të inventarizimit.
- Me Urdhrin nr. 353/3, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Kolonjë, i përbërë nga z. A. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. T. B., z. E. A.;

Me shkresën nr. 2 prot., datë 05.01.2026, z. A. A. Administrator i NjA Kolonjë është adresuar me njoftim mbi përfundimin e inventarizimit dhe materialet e dala jashtë përdorimit Bashkisë Lushnjë, bashkëlidhur ndodhet relacioni përkatës.
- Me Urdhrin nr. 353/4, datë 05.12.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në Njësinë Administrative Krutje, i përbërë nga znj. L. Ç. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. B., z. Xh. Z.;
Me shkresën nr. 968 prot., datë 30.12.2025, z. L. G. Administrator i NjA Krutje është adresuar me njoftim mbi përfundimin e inventarizimit dhe materialet e dala jashtë përdorimit Bashkisë Lushnjë, bashkëlidhur ndodhet relacioni përkatës.
- Me Urdhrin nr. 84, datë 24.03.2026, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për dhënien në përdorim/tjetërsim e aktiveve dhe/ose nxjerrjen jashtë përdorimit i përbërë nga znj. A. K. kryetar i komsionit dhe anëtarët znj. G. Z., znj. Xh. I., znj. A. S., znj. J. Xh.
Me shkresën nr. 4906 prot., datë 25.05.2026, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar Ndërmarrjes së Pasurisë Publike me anë të një kërkese ka kërkuar mbështje për vendosjen një mjet në dispozicion për transportimin e aktiveve të vlerësuara për t'u asgjesuar si dhe autorizim për përdorimin e Landfillit duke marrë në konsideratë faktin që, ndërmarrja ka kontratë aktive me Landfillin Impiantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.
Me shkresën nr. 6286 prot., datë 26.06.2026, nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar procesverbali për asgjesimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit për vitin 2025, në vlerën totale prej 1,723,468 lekë. Bashkëlidhur ndodhen edhe fotot përkatëse së bashku me fletën e peshimit të datës 23.06.2026, ora 12:05.
- Nga auditimi i llogarive të aktivit të pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 215 "Mjete transporti" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 15,395,313 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë edhe vlera prej 3,669,000 lekë që i përket 4 (katër) mjeteve të dëmtuara jashtë funksionit të konstatuara dhe të vlerësuar si të tilla nga komisioni i vlerësimit përgjatë procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për të cilat janë hartuar procesverbalet përkatëse konkretisht: Procesverbali me nr. 1062 prot., datë 27.01.2026, për mjetin Ford me targë LU....B me vlerë kontabël 1,490,000 lekë dhe procesverbali nr. 1063 prot., datë 27.01.2026, për mjetet Autoveturë Benz 2500 me targë LU....B në vlerën 1,388,000 lekë; Motoçliketë IS 150-AF3 me targë 4..AA në vlerën 392,500 lekë dhe Motoçikletë IS 150-AF3 me targë 4..AA në vlerën 398,500 lekë.
Në referencë të procesverbaleve të sipërpërmendura, këto aktive duhej të kontabilizoheshin në gjendjen e llogarisë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi nr. 1, pika 2.1. Vlera prej 3,669,000 lekë që i përket aktiveve të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Pra nga llogaria 215 "Mjete tranporti" duhet të zbritet vlera e aktiveve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".
*Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi***:** znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë në cilësinë e NA, znj. E. Ç. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e NZ dhe znj. J. H. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

✓ **Ndërmarrja e Pasurisë Publike:**

- Me Urdhrin nr. 140, datë 03.12.2025, të z. E. Z. Drejtor i Ndërmarrjes së Pasurisë Publike është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të institucionit i përbërë nga z. L. S. kryetar i komsionit dhe anëtarët z. B. Ç., z. E. S., z. Sh. S., z. Dh. Sh.
- Nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar relacioni përmbledhës pa numër protokolli dhe pa datë, pas përfundimit të procesit të inventarizimit. Bashkëlidhur këtij dokumenti ndodhet edhe procesverbali i datës 30.12.2025, në të cilin është përfshirë edhe lista e aktiveve të vlerësuara dhe të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit që i përkasin llogarisë 327 "Inventar i imët" në vlerën 17,501 lekë. Në referencë të Relacionit Përmbledhës së Vlerësimit i mbajtur nga z. E. Z. Drejtor i NPP-së mbi kryerjen e inventarizimit dhe gjendjen e aktiveve, Kryetari i Bashkisë ka nxjerr Vendimin nr. 22, datë 13.01.2026, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve për Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në vlerë 17,501 lekë që i përkasin aktiveve të llogarisë 327 "Inventar i imët".

- Me shkresën nr. 490/1 prot., datë 23.06.2026, nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar procesverbali për asgjesimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit për vitin 2025, në vlerën totale prej 17,501 lekë. Bashkëlidhur ndodhen edhe fotot përkatëse së bashku me fletën e peshimit të datës 23.08.2026, ora 12:05.

✓ **Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit:**

- Me Urdhrin nr. 86, datë 26.11.2025, të znj. B. D. Drejtor i Qendrës së Kulturës dhe Klubit të Sportit është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të institucionit i përbërë nga znj. E. S. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. P. H., z. F. M.
- Bashkëlidhur urdhrit të sipërcituar ndodhet edhe Relacioni me shkresën nr. 338 prot., datë 31.12.2025, për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2025, miratuar nga titullari i institucionit.
- Me shkresën nr. 4 prot., datë 08.01.2026, znj. B. D. Drejtori i QKKS-së ka dërguar pranë Bashkisë Lushnjë informacionin përmbledhës për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2025.
- Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 21, datë 13.01.2026, është miratuar procesi i inventarizimit, ku ndër të tjera nuk ka aktive për nxjerrje jashtë përdorimit.

✓ **Qendra e Arsimit:**

- Me Urdhrin nr. 34, datë 22.10.2025, të z. M. Sh. Drejtor i Qendrës së Arsimit është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të institucionit i përbërë nga znj. A. Q. kryetar i komsionit dhe anëtarët znj. Xh. B., znj. M. B., znj. F. S., z. F. S.
- Nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar relacioni përmbledhës pa numër protokolli dhe pa datë, pas përfundimit të procesit të inventarizimit. Bashkëlidhur këtij dokumenti ndodhet edhe lista e aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 6,514,378 lekë që i përkasin llogarive 327 "Inventar i imët" në vlerën 801,195 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje" në vlerën 3,592,086 lekë dhe 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 2,121,097 lekë.

Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 20, datë 13.01.2026, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve në vlerën 6,514,378 lekë.

- Me Urdhrin nr. 5, datë 11.03.2026, të z. M. Sh. Drejtor i Qendrës së Arsimit është ngritur komisoni për dhënien në përdorim/tjetërsimin nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjesimit të aktiveve për vitin 2025 i përbërë nga znj. L. H. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. F. Q., z. L. Ç., z. S. Sh., z. S. H.

Nga komisoni i sipërcituar është hartuar procesverbali mbi realizimin e procesit të asgjesimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit më datë 16.03.2026.

III.2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në zbatim të pikes **4** të programit të auditimit: *"**Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm".***

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, 405/17 prot., datë 21.10.2025.
- Korespondenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Lushnjë dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga strukturat e bashkisë dhe raportimet në Këshill Bashkiak për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit në RPA dërguar me shkresën 737/7 prot. dt. 15.10.2025, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 203 datë 15.10.2025, mbërritur në Bashkinë Lushnjë dhe regjistruar me nr. 1647/17 prot., datë 18.10.2025, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja

e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pa zbatuara si më poshtë vijon:

a. Masa për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi ***nuk është*** lënë masë;

b. Masa Organizative janë lënë **33** nga të cilat janë pranuar **33** masa: **4** masa janë zbatuar, 1**3** masa janë në proces zbatimi, **2** masa janë pjesërisht zbatuar dhe **14** masa janë pa zbatuar;

c. Masa për Shpërblim dëmi janë lënë **12** në vlerën totale 6,871,004 lekë nga të cilat janë pranuar 12 masat në vlerë të plotë: **2** masa në vlerë totale 382,066 lekë janë zbatuar dhe **10** masa në vlerë totale 6,488,938 lekë janë pjesërisht zbaruar;.....

d. Masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) janë lënë **2** masa në vlerën totale 1,761,812,376 lekë dhe janë pranuar 2 masat: , e cila rezultojnë.në proces zbatimi;

e. Masa disiplinore për 6 punonjës është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar;

- **Drejtimet e auditimit**

I. *Mbi hartimin dhe miratimin e "Planit të veprimit" dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA*

- Në Bashkinë Lushnjë, nga kryetari i bashkisë është miratuar plani i veprimit dhe është dërguar në KLSH me shkresën nr. 9229/3 prot., datë 29.10.2025 "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA", në të cilin janë caktuar dhe personat përgjegjës për ndjekjen e çdo rekomandimi dhe afatet konkrete për zbatimin e tyre.

"Plani i veprimit" ***është dërguar*** në KLSH *brenda afatit 20 ditor*, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin në afat të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit "Bashkia Lushnjë* ***ka kthyer përgjigje*** *zyrtare në KLSH brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon "Planin e Veprimeve", duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.*

Zbatuar

II. *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm*

- Në zbatim të ligjit nr.154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt "Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit", është dërguar në KLSH me shkresën nr. 3571/1 prot., datë 15.04.2026 *brenda afatit 6 mujor*.

Zbatuar

III. *Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të KLSH, sipas përcaktimeve në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".*

- Bashkia Lushnjë ka ***raportuar*** në Këshillin Bashkiak lidhur me "Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së"

Zbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK nga Bashkia Lushnjë rezultoi se, strukturat përgjegjëse nuk kanë marrë masa për krijimin e Komitetit të Auditimit; Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë; Nuk është hartuar dhe miratuar "Gjurma e

unifikuar e auditimit". Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" neni 9, pika 1/1 germa 'b'; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 4, pika 20. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë, të marrë masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive, sipas komponentëve të MFK për plotësimin e mangësive të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Përsa i përket vlerësimit të nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së nga institucioni evidentohen disa problematika të cilat ende nuk janë marrë masat e duhura për përmirësimin dhe hartimin e këtyre dokumenteve konkretisht, gjurmën e auditimit, strategjinë e riskut apo raporte mbi mngësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, plane mujore pune et.,.
Rekomandimi nr. 1.1, Nuk është Zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023 dhe 2024, rezultoi se kjo njësi ka funksionuar me **3** punonjës, **1** përgjegjës i njësisë i pa certifikuar dhe me përvojë më pak se tre vite në fushën e auditimit, si dhe **2** specialist auditi të certifikuar. Emërimi i përgjegjës së sektorit të AB, me vendimin nr. 74, datë 09.02.2024, të kryetarit të Bashkisë Lushnjë, është në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", neni 11, "Punësimi i audituesit të brendshëm", pika 2. Gjithashtu Sektori i Auditit të Brendshëm nuk ka respektuar përcaktimet ligjore të Manualit të Auditimit të Brendshëm mbi vlerësimin e nivelit të riskut. Konkretisht për periudhën 2023-2025 dhe 2024-2026 kjo strukturë nuk ka planifikuar angazhime me një frekuencë më të lartë mbi bazë risku për sektorë apo veprimtari të caktuara si sistemi i pagave dhe ai i prokurimeve. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Njerëzore të marrin masa për certifikimin e audituesve duke respektuar përcaktimet ligjore për stafin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Në referencë të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 159, datë 02.12.2025, nga Bashkia Lushnjë është dërguar kërkesa e datës 14.01.2026, për ndjekjen dhe çertifikimin si "Auditues i brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2026", kërkesë e administruar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm me praktikën nr. 1849 prot., datë 18.02.2026, por ende ky proces nuk ka përfunduar.
***Rekomandimi nr. 2.1, është në Proces Zbatimi*.**

3. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2023-2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 1,253,879 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 1,008,331 mijë lekë ose në masën 80.4% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 245,548 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse, me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 2837 prot., datë 24.03.2026, z. D. N. Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore ka informuar personin përgjegjës znj. J. H. Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave Vendore mbi mënyrën e planifikimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2026, konkretisht për këtë vit planifikimi është në vlerën 640,579,000 lekë. Verifikimi mbi ecurinë dhe zbatimin e këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e radhës.
Rekomandimi nr. 3.1, është në Proces Zbatimi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të ardhurat e realizuara nga Agjentët Tatimorë *(Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë; ASHK Lushnjë për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; Drejtoria Rajonale e Tatime Fier në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR Fier në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura dhe Dega e Doganës Fier për rentën minerare)* derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogarinë e Bashkisë Lushnjë dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Lushnjë duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor të datës nr. 12, datë 16.01.2024, dhe nr. 12, datë 17.01.2025. Bashkia Lushnjë ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu nuk janë mbajtur akt-rakordime për vitet 2023-2024 me agjentët tatimorë si DRSHTRR, Degën e Doganës Fier, ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë dhe DRT Fier. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 15, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008 *"Për taksat kombëtare"*. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnjë të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka nisur procesi i rakordimit dhe kryqëzimit të të dhënave me institucionet përkatëse, duke u dërguar shkresa zyrtare për rakordimin vjetor të vitit 2025 dhe për kryerjen e rakordimeve mujore për vitin 2026 konkretisht: DRSHTRR shkresën nr. 1781 prot., datë 17.02.2026; ASHK shkresën nr. 1778 prot., datë 17.02.2026, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shkresën nr. 1783 prot., datë 17.02.2026; DRT shkresën nr. 2194 prot., datë 27.02.2026, dhe shkresën nr. 2837 prot., datë 24.03.2026.
Rekomandimi nr. 4.1, është Zbatuar Pjesërisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore rezultoi se programi TAIS është implementuar në vitin 2018, duke regjistruar tatimpaguesit biznes duke filluar me përditësimin e të dhënave nga QKB, ngarkimin e detyrimeve tatimore dhe dërgimin e njoftimit mbi detyrimet me postë. Aktualisht Drejtoria e të Ardhurave Vendore përdor programin "Excel" i uploduar në programin One Drive për aksesim nga ana e Punonjësve Specialist për taksat dhe tarifat vendore në çdo njësi administrative për të kryer vlerësimin për kategorinë tatimpagues familjarë, tatim pagues familjarë për detyrimet e taksës mbi tokën bujqësore për pasuri që shtrihen në 10 lagje të qytetit të Lushnjës dhe tatimpaguesit ambulant, biznes i vogël, biznes i madh, qiradhënës, të cilat janë të

ngarkuar në sistemin TAIS, *sistem i cili nuk është në proces mirëmbajtje nga Kompania e cila ka kryer implementimin e tij.*
Aktualisht sistemi TAIS është i implementuar në 6 *(gjashtë)* kompjuter, si dhe nuk ka akses në përdorimin e serverit qendror nga punonjësit e Bashkisë Lushnjë, mungojë të dhënat për t'u aksesuar (username, pasword). Referuar të dhënave të vëna në dispozicion Drejtoria e të Ardhurave Vendore disponon të dhëna të plota për 2,249 subjekte biznes i vogël, 983 subjekte biznes i madh, 279 ambulant dhe 54,237 taksapagues familjarë.
Nga auditimi i proceseve të sistemit TAIS të implementuar në Bashkisë Lushnjë konstatohet se:
a. Aplikacioni TAIS i taksave vendore Lushnjë dhe kodi në burimin e tij nuk janë të regjistruara si aset i Bashkisë Lushnjë. Politikat e sigurisë së informacionit mbulojnë të gjitha risqet operacionale dhe ka mundësi të mbrojë në mënyrë të arsyeshme të gjitha asetet e informacioneve kritike kundrejt, humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. *(Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe politika të tjera të brendshme, procedura ose rregulla të aplikueshme).* Mbajtja e pronësisë së proceseve të biznesit;
b. Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve *(Versioni 48 1.0, datë 02.12.2008)* miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit përkatësisht:
Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit. Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit. Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme.
Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.
Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës;
c. Prodhuesi i sistemit TAIS ka shoqëruar sistemin me rregullore dhe manuale për përdoruesit dhe administratorët të cilat nuk janë të miratuara nga ana e Bashkisë Lushnjë. Në mbështëtje të kërkesave kryen ndryshime të sistemit dhe zhvillime në përputhje edhe me ndryshimet e legjislacionit në fuqi pa pasqyruar ndryshimet në manuale. Duke mos përmbushur përcaktimet e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 64, gërma *"j";*
ç. Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Taksave Vendore të Bashkisë Lushnjë nuk ka rregulla të shkruara për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin TAIS;
d. Nuk ka raporte të problemeve/incidenteve dhe aksesit të paautorizuar;
dh. Nuk ka rregulla të shkruara dhe formale të sigurisë së informacionit;
e. Nuk ka Procedura formale për menaxhimin e risqeve dhe Regjistër të risqeve;
f. Bashkia Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka plan emergjence të miratuar dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike për sistemin TAIS. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për:
- Vlerësimin dhe regjistrimin si aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.
- Miratimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të Rregulloreve dhe manualeve të Aplikacionit TAIS.
- Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemet e teknologjisë së informacionit, procesi i hapjes mbylljes si dhe rastet e incidenteve dhe aksesit të paautorizuar duhet të dokumentohet.
- Të vlerësuar burimet, duke marrë masa për krijimin e Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendërzuar të sigurt për kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.
- Hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën TI si dhe të ngrejë mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.
- Hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, si dhe procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
- Konfigurimin firewall, switch dhe mikrotik të sistemit TAIS (dhe ruajtjen e konfigurimeve) në përputhje me rekomandimet e prodhuesve dhe standardet e praktikat më të mira të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga verifikimin mbi masat e marra nga Drejtoria e të Ardhurave lidhur me implementimin e kërkesave të parashikuara në këtë rekomandimin evidentohet se, kjo situatë ka mbetur në fazën e rekomandimit për arsye se nga strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnjë nuk janë miratuar dhe impementuar rregullat konkrete sipas manualeve përkatëse për administrimin dhe sigurinë e sistemit TAIS.
***Rekomandimi nr. 5.1, Nuk është Zbatuar*.**

6. Gjetje nga auditimi: Në Qendrën Kombëtare të Biznesit përgjatë viteve 2023-2024 kanë aplikuar për çregjistrim 167 subjekte me seli në qytetin e Lushnjës, sipas verifikimeve të kryera nga grupi i auditimit më datat 26.12.2024, 27.12.2024, 28.01.2025 dhe 29.01.2025, në faqen zyrtare të QKB-së, rezultoi se këto subjekte figurojnë ende me status aktiv, ku 65 subjekte janë debitorë ndaj Bashkisë Lushnjë në një shumë totale prej 4,284,843 lekësh. Nga data e aplikimit për mbyllje nga DAV Bashkia Lushnjë nuk janë përllogaritur më detyrimet tatimore për këto subjekte. Në lidhje verifikimin e gjendjes funksionale, pra ushtrimit të aktivitetit nga subjektet që kanë aplikuar për çregjistrim nga DAV janë hartuar procesverbale në aplikacionin Google Docs *(aplikacion i pa liçensuar)* ku këto subjekte nuk ushtrojnë aktivitet. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa të menjëhershme për kryerjen e inspektimeve në terren në lidhje me statusin e subjekteve që kanë aplikuar për çregjistrim në QKB, për rastet që konstatohet se këto subjekte ushtrojnë aktivitet t'u përllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Në referencë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave u konstatua se, për vitet 2025-2026 nga kjo drejtori janë kryer 91 akt-konstatime në terren. Gjithashtu nuk disponohet një dokument mbi rakordimin e aktkonstatimeve gjendjes faktike me atë në QKB, me qëllim përllogaritjen e detyrimeve tatimore.
***Rekomandimi nr. 6.1, Në proces zbatimi*.**

7. Gjetje nga auditimi: Përgjatë viteve 2023-2024 në territorin e Bashkisë Lushnjë kanë ushtruar aktivitet 12 subjekte në fushën e ndërtimit, të cilat nuk janë të pajisur me NIPT Sekondar në zbatim të përcaktimeve të nenit 22 dhe neneve 48-49, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, *"Për regjistrimin e biznesit"* i ndryshuar, ku këto subjekte duhet të shlyejnë detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj institucionit referuar kontratave si më poshtë:
- Kontrata nr. 11407 prot., datë 28.12.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe BOE *"Z."* & *"T."* Shpk me objekt *"Rehabilitimi i palestrës, shkolla "Foto Puka"*, me vlerë kontrate 26,065,008 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 62 ditë kalendarike më datë 01.04.2023. Me shkresën nr. 5815/1 prot., datë 18.07.2023, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 18.08.2023.
- Kontrata nr. 7936 prot., datë 12.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"C. R. 20."* Shpk me objekt *"Sistemim asfaltim i segmentit rrugor "Taulla Sinani"-"E. D."*, me vlerë kontrate 18,491,131 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 72 ditë kalendarike më datë 01.12.2022. Me shkresën nr. 10553/2 prot., datë 01.12.2022, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 06.01.2023.
- Kontrata nr. 7941 prot., datë 12.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"Z."* Shpk me objekt *"Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës "Unazë e ish depos së duhanit"*, me vlerë kontrate 25,301,537 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 175 ditë kalendarike më datë 10.03.2024. Me shkresën nr. 2016/2 prot., datë 10.03.2023, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 28.04.2023.
- Kontrata nr. 4405 prot., datë 30.05.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"Sh. 0."* Shpk me objekt *"Rindërtimi i rrugës "Lazgush Poradeci" segmenti pas përroit"*, me vlerë kontrate 24,000,000 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 130 ditë kalendarike më datë 13.10.2023.
- Kontrata nr. 6156 prot., datë 25.07.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"2."* Shpk me

objekt *"Urbanizimi i bllokut të banimit në lagjen Savër"*, me vlerë kontrate 30,000,000 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 259 ditë kalendarike më datë 09.04.2024. Me shkresën nr. 6443/2 prot., datë 05.08.2024, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 24.09.2024.
- Kontrata nr. 7647 prot., datë 20.09.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"L. C."* Shpk me objekt *"Urbanizimi i bllokut të banimit në Dushk Sektor"*, me vlerë kontrate 31,607,970 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 90 ditë kalendarike më datë 03.01.2024. Me shkresën nr. 1033/1 prot., datë 04.01.2024, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 18.01.2024.
- Kontrata nr. 7869 prot., datë 26.09.2023, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"Ll."* Shpk me objekt *"Punime ndërtimi në territorin e varrezave"*, me vlerë kontrate 34,634,671 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 111 ditë kalendarike më datë 14.01.2024. Me shkresën nr. 335/2 prot., datë 17.01.2024, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 14.02.2024.
- Kontrata nr. 831 prot., datë 29.01.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"N."* Shpk me objekt *"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Irakli Bozo" Golem"*, me vlerë kontrate 30,536,684 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 120 ditë kalendarike më datë 11.07.2024. Me shkresën nr. 5568/2 prot., datë 12.07.2024, është kryer amendim i kontratës me datë përfundimi të punimeve në fakt 0810.2024.
- Kontrata nr. 2658 prot., datë 26.03.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"A. C."* Shpk me objekt *"Mur me pilota në rrugën Vëllezërit Frashëri"*, me vlerë kontrate 6,829,200 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 60 ditë kalendarike.
- Kontrata nr. 5247 prot., datë 24.06.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe OE *"Sh. 0."* Shpk me objekt *"Rindërtim i shkollës 'Hysen Xheka' - Karbunarë"*, me vlerë kontrate 53,297,198 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 180 ditë kalendarike.
- Kontrata nr. 5244 prot., datë 24.06.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe BOE *"I. G."* Shpk & *"V. G."* Shpk me objekt *"Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Bubullimë"*, me vlerë kontrate 25,405,480 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 120 ditë kalendarike.
- Kontrata nr. 7222 prot., datë 10.09.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe BOE *"N. 19."* Shpk & *"V. K."* Shpk & *"B. II."* Shpk me objekt *"Rikonstruksioni i godinës dhe palestrës së shkollës së mesme 'Jani Nushi'"*, me vlerë kontrate 73,460,940.50 lekë me TVSh me afat përfundimi të punimeve 210 ditë kalendarike. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike Prokurimeve Publike dhe Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore të marrë masa që në të ardhmen të gjithë subjektet që kanë lidhur kontratë investime/punë publike me bashkinë, të pajisjen me NIPT sekondar duke përllogaritur detyrimet e taksave dhe tarifave vendore deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 2782 prot., datë 17.02.2026, Drejtoria e të Ardhurave është adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Legjislacionit dhe Burimeve Njerëzore që për çdo kontratë punë publike civile që nënshkruhet me Bashkinë Lushnjë si Autoritet Kontrator t'u përlloagritet detyrimet tatimore vendore në referencë të afateve të kontratave përkatëse.
***Rekomandimi nr. 7.1, është në Proces Zbatimi*.**

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i 20 dosjeve për vitet 2023-2024 të biznesit të madh konstatohet se, në 1 rast taksa e ndërtesës është përllogaritur pa dokumentacionin e pronësisë së objektit dhe 1 një rast taksa e reklamës është përllogaritur pa dokumentacion justifikues. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKB-në nr. 62, datë 31.08.2023 *"Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr. 117, datë 21.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Lushnjë dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2023". (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa në vijimësi që për çdo përllogaritje apo ndryshim të taksës së truallit, ndërtesës dhe reklamës të kryhet mbi bazën e dokumentacionit të pronësisë dhe procesverbaleve faktike të sipërfaqes së shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është marrë asnjë masë mbi përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për subjektet që janë rekomanduar në këtë gjetje, pra pajisjen e dosjes me dokumentacionin përkatës plotësues me qëllim përllogaritjen e saktë të këtyre taksave.
***Rekomandimi nr. 8.1, Nuk është Zbatuar*.**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçensuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje me pakicë të karburanteve, njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit, si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB konstatohet se përgjatë viteve 2023-2024 në territorin e Bashkisë Lushnjë kanë ushtruar në total 78 subjekte, nga të cilat 68 subjekte me aktivitet karburant dhe 10 subjekte me aktivitet tregtim gazi. Për 39 subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse pa licencë/autorizim, Bashkia Lushnjë, me shkresat nr. 3835 prot., datë 02.05.2024 dhe nr. 8598 prot., datë 22.10.2024, ka dërguar dhe ridërguar njoftime për përllogaritjen e detyrimeve financiare në vlerën 27,500,000 lekë, e cila mbulon periudhën nga viti 2021 dhe për një afat 5-vjeçar. Megjithatë, pavarësisht njoftimeve të dërguara, nuk janë marrë masa konkrete për bllokimin e aktivitetit tregtar të këtyre subjekteve të paautorizuara. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën nr. 6.1, të VKM nr. 344, datë 19.04.2017, si dhe nenit 25, të Ligjit nr. 8450/1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre" të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/liçencë.

Menjëherë

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është marrë asnjë masë mbi zbatimin e këtij rekomandimi, pra nuk evidentohet një korrespodencë me ISHTI me qëllim pajisjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitet për tregtimin e hidrokarbureve dhe derivateve të tyre, me autorizimet përkatëse, duke shlyer njëkohësisht edhe detyrimet që lindin nga këto autorizime.
***Rekomandimi nr. 9.1, Nuk është Zbatuar*.**

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Lushnjë dhe Njësive Shpenzuese janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:
- Për vitin 2023, Bashkia Lushnjë ka nxjerrë aktive jashtë përdorimit në vlerën 2,625,836 lekë dhe Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit vlerën 2,676,667 lekë për të cilat në procesverbalet e asgjësimit nuk evidentohet/dokumentohet mënyra e asgjësimit, transporti si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve. Gjithashtu në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cila konsiderohen të dëmshme *(pajisje elektrike dhe elektronike)*, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Në të dy rastet nga Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk disponohet asnjë korrespodencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.
- Nga komisioni i inventarizimit të NPP dhe QKKS pas përfundimit të procesit të inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë

dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej Nëpunësit Autorizues të institucionit. Relacioni për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit është kryer nga komisioni i inventarizimit, proces i cili duhet të kryhet nga komisioni i vlerësimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"* i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit"* i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, *"Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"*, Kreu I, pika 1, dhe pika 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 85, gërma *"c"*, pika 96, pika 122. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve të NPP dhe QKKS pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit. Gjithashtu relacionet për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit të kryhen nga komisioni i vlerësimit.

10.2. Rekomandimi: Nga komisionet për asgjësimin e aktiveve të Bashkisë Lushnjë dhe QKKS të merren masa që gjatë zhvillimit të procesit të asgjësimit, të respektohen kriteret për mbrojtjen e mjedisit si dhe të dokumentohet i gjithë procesi sipas kritereve të përcaktuara në dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Në referencë të auditimit të procesit të inventarizimit të aseteve për Aparatin e Bashkisë dhe Njësitë Shpenzuese janë marrë masat e duhura ku pas përfundimit të procesit të inventarimit dhe vlerësimit është hartuar raporti për inventarin fizik ku me shkresat respektive Njësitë Shpenzues janë adresuar Titullarit të Bashkisë Lushnjë mbi rezultatet e inventarizimit. Për sa i përket procedurës së nxjerrjes apo asgjesimit të aktiveve afatgjata materiale u konstatua se, për vitin 2025 janë zhvilluar tre procedura asgjesimi ku bashkëlidhur ndodhet praktika përkastëse që nga urdhrat për ngritjen e komsioneve të asgjesimit, vendim miratimi për nxjerrjen dhe asgjesimin e aktiveve, konfirmim për depozitimin e tyre në landfillin që ndodhet në qytetin e Fierit për të cilën Ndërmarrja e Pasurisë Publike diponon kontratën përkatëse, procesverbalin e asgjesimit, foto përkatëse dhe fletën e peshimit të lëshuar nga landfilldi. Theksojmë se, lidhur me zbatimin dhe verifikimin e këtij rekomandimi shprehemi vetëm për procesin e inventarizimit për vitin 2025.
Rekomandimet nr. 10.1, dhe nr. 10.2, janë Zbatuar Plotësisht.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/a, *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)"*, Pasqyrës nr. 7/b, *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* dhe llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* pjesë e pasqyrave financiare ushtrimore për vitin 2023 konstatohet se, Qendra Arsimore ka nxjerrë jashtë përdorimit vlerën totale prej 12,539,342 lekë**,** për llogaritë 327 *"Materiale"* në vlerën 4,002,314 lekë, 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje"* në vlerën 2,205,586 lekë dhe 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën 6,331,442 lekë. Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka nxjerrë jashtë përdorimit vlerën totale prej 1,544,545 lekë për llogaritë 327 *"Materiale"* në vlerën 151,453 lekë dhe llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje"* në vlerën 1,393,092 lekë. Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit konstatohet se nga QA dhe NPP për vlerën totale prej 14,083,888 lekë të nxjerrë jashtë përdorimit të cilat janë shkarkuar nga kontabiliteti, për të cilat nuk disponohet një urdhër për ngritjen e komisionit e asgjësimit të aktiveve, nuk është kryer një procedurë vlerësimi (sipas llojit në skrap, dru etj.,) dhe asgjësimi pra, nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110, dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pikat 89-90. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Lushnjë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune, i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të

kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale **14,083,888 lekë,** që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga Qendra e Arsimit dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe asaj të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, diferenca në inventar nga personat përgjegjës.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrave finanicare të Njësive Shpenzuese QA dhe NPP mbi sistemimin dhe rakordimin e vlera të nxjerra jashtë përdorimit pa dokument justifikues u konstatua se, me shkresën nr. 321 prot., datë 20.02.20226, NPP i ka kthyer përgjigje Bashkisë Lushnjë se nuk janë marrë masat për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kësaj situate. Kjo situatë evidentohet edhe në rastine Qa pra nuk disponohet një urdhër për ngritje komisoni për verifikimin e gjendjes faktike për vlerat e nxjerrja jashtë përdorimit.
Rekomandimi nr. 11.1, Nuk është Zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"* paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 237,093,841 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 387,931,083 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 *"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"* në vlerën 361,627,778 lekë dhe llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në vlerën 25,564,475 lekë. Llogaria *"Disponibilitete në thesar"* është mbivlerësuar në vlerën 738,830 lekë. Mos kuadrimi i llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* është konstatuar si problematikë në Pasqyrat Financiare Ushtrimore të Njësive Shpenzuese Qendra e Arsimit, Ndërmarrja e Pasurisë Publike dhe Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit. Në këtë kontekst krijohet ideja se ndërmarrjet kanë dalë me humbje por kjo situatë ka ndodhur se në gjendjen e llogarisë 85 *"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"* është kontabilizuar diferenca e ndryshimit të gjendjes së iventarit *(pra gjendja e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit")*. Për më tepër gjendja e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* duhet të paraqitet në vlerën 0 lekë më datën 31.12.2023, duke marrë në konsideratë faktin që janë Njësi Shpenzuese të Bashkisë Lushnjë dhe nuk mund të trashëgojë të ardhura për vitin pasardhës. Këto veprime janë në kundërshtim Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra Arsimore, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit të marrë masa që në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 798,319,546 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 757,385,777 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 40,933,769 lekë.
Rekomandimi nr. 12.1, është Zbatuar Plotësisht.

13. Gjetja nga auditimi: Llogaritë e Klasës 3 sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 111,347,252 lekë dhe përbëhen nga llogaritë kontabël 31 *"Materiale"* në vlerën 33,013,111 lekë dhe 32 *"Inventar i imët"* në vlerën 78,334,141 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën 241,252.10 lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* e cila paraqitet në vlerën 2,622,780.10 lekë. Llogaria 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* është mbivlerësuar në vlerën 2,381,528 lekë. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se llogaria 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* për Njësinë Shpenzuese Qendra e Arsimit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,190,764 lekë

ndërkohë që kjo llogari duhet të paraqitej në vlerën - 1,190,764 lekë. Problematika ka ndodhur si pasojë e mos kryerjes së saktë të veprimit kontabël, pra diferenca e ndryshimit të gjendjes së inventarit për vitin ushtrimor paraardhës me vitin ushtrimor të mbyllur del negative dhe në gjendjen e llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* duhej të pasqyrohej pozitive. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshua5 pika 4.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Qendrën e Arsimit të marrë masa që në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit",* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Llogaritë e Klasës 3 sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar më datë 31.12.2025, paraqiten në vlerën 269,880,149 lekë dhe përbëhen nga llogaritë kontabël 31 "Materiale" në vlerën 181,618,660 lekë dhe 32 "Inventar i imët" në vlerën 88,261,489 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën 135,407,908 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" e cila paraqitet në vlerën 135,407,908 lekë.
Rekomandimi nr. 13.1, është Zbatuar Plotësisht.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* konstatohet se nga viti 2005 deri në vitin 2015 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 48,138,931 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sh.a Lushnjë, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Lushnjë. Pra, nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Lushnjë dhe UKL Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Këto veprime janë në kundërshtim me *U*dhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë për vlerën kontabël 48,138,931 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Në referencë të analizës së gjendjes së llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" u konstatohet se, vlera prej 48,138,931 lekë vazhdon e regjistruar në kontabilitetin e Bashkisë Lushnjë. Pra nuk janë marrë masa e duhura për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Lushnjë dhe UKL Sh.a.
***Rekomandimi nr. 14.1, Nuk është Zbatuar*.**

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Lushnjë dhe Njësive Administrative Dushk, Allkaj, Bubullimë, Fier-Shegan, Golem, Krutje, Kolonjë, Hysogjokaj, Ballgat dhe Karbunarë konstatohet se:
1. Me VKM-të përkatëse i janë kaluar kësaj njësie vendore, gjithsej **6,462 pasuri** nga të cilat 3,249 në pronësi dhe 3,158 në përdorim, por nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37, pika 1, ku

përcaktohet që, *"Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji"*.

2. Për sa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave në zbatim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive"* i ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike"*, pika 25, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e kësaj VKM-je. Për sa më sipër llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* nuk paraqet gjendjen reale për pasqyrat financiare të vitit 2023, pasi nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Lushnjë, të transferuara me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike"*.

3. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene",* 211 *"Pyje, kullota, plantacione"*, dhe 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* të kontabilizuara në pasqyrat financiare vetëm 77 prej tyre janë pajisur me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 35, gërmat *"a, b, c"*, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështëtur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Lushnjë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve respektive sipas llogarive 210 *"Toka, troje, terrene"*, 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* dhe 212 *"Ndërtesa e konstruksione". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Lushnjë të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

15.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Lushnjë në bashkëpunim me NPP, QA, QKKS të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene", 211 "Pyje, Kullota Plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Lushnjë ka filluar angazhimi për pajisjen me çertifikatë pronësie të aseteve që disponon në pronësi konkretisht për vitin 2024, janë pajisur me çertifikatë pronësie 50 pasuri duke i kontabilizuar në kontabilitet me vlerën 1 lekë.
***Rekomandimi nr. 15.1 dhe Rekomandimi 15.2 janë në Proces Zbatimi*.**

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)"* për llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"* është përllogaritur normë amortizimi vjetor në vlerën 17,151,373 lekë *(kosto historike)* ose në masën 20%. Amortizimi për këtë llogari nuk paraqitet i saktë për arsye se është kryer në total për vlerën e çeljes së gjendjes së llogarisë më datë 01.01.2023, duke marrë në konsideratë faktin që kjo llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime përgjatë vitit 2023, ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 *"Pajisje kompjuterike"* nga aktivet e llogarisë bazë 218 *"Inventar ekonomik"* e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Lushnjë në gjendjen e llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* të klasifikojë veçmas llogarinë 218/6 "*Pajisjet kompjuterike*" në regjistrin e

aseteve të njësive dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

Deri më datë 31.03.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë mbetet ende pa u sistemuar si veprim sistemues në pasqyrat financiare të konsoliduara konkretisht: për vitin 2025 Bashkia Lushnjë ka aplikuar normë amortizimi në vlerën 278,200 lekë për llogarinë 218 "Inventar ekonomik"; NPP vlerën 771,083 lekë; QKKS vlerën 204,992 lekë dhe QA vlerën 7,992,369 lekë në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Për më tepër QKKS ka aplikuar normë amortizimi në masën 10% për llogarinë 218 "Inventar ekonomik".
***Rekomandimi nr. 16.1, Nuk është Zbatuar*.**

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"*, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 7,279,000 lekë. Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* më datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 0 lekë. Në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet në masën 37.79% që Bashkia Lushnjë posedon në *Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë* në vlerën 3,779,000 lekë, si dhe aksionet në masën 100% të kapitalit që posedon në Shoqërinë *"Klubi i Futbollit Lushnja 1930"*, ku vlera e aksioneve është 3,500,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar pika 2.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
17.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Lushnjë të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet në vlerën 7,279,000 lekë

Deri më datë 31.03.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë evidentohet përsëri në pasqyrat financiare të Aparatit të Bashkisë Lushnjë, ku llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që nuk janë masat e duhura për kontabilizimin e aksioneve që disponon institucioni në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë dhe Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnjë 1930", në vlerën totale prej 7,279,000 lekë.
Rekomandimi nr. 17.1, Nuk është Zbatuar.

18. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Lushnjë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 25,564,475 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 39 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Lushnjë *(33 objekte në vlerën 5,856,814 lekë)* + Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit *(3 objekte në vlerën 17,550 lekë)* + Qendra e Arsimit *(3 objekte në vlerën 175,813 lekë)* janë ngurtësuar në total fonde në vlerën 6,050,177 lekë, për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Lushnjë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar pika 3.3; Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Qendrën e Arsimit, Qendrën Kulturore dhe Klubit të Sportit të marrin masa për të njoftuar të gjitha subjektet për paraqitjen e dokumentacionit për likuidim, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.03.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë evidentohet përsëri në pasqyrat financiare pasi evidentohet një numër i konsiderueshëm operatorësh ekonomik në vlerën 20,950,887 lekë për të cilët ende institucioni disponon fonde të ngurtësuara mbi 5% e garancive të punimeve dhe nuk është kryer çlirimi i këtyre garancive edhe pas përfundimit të kontratave të punëve publike.
***Rekomandimi nr. 18.1, Nuk është Zbatuar*.**

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar konstatohet se, Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka disa llogari në aktiv dhe pasiv të pa analizuara me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave sipas llogarive 468 *"Debitorë të ndryshëm"* në vlerën 3,366,482 lekë; 210 *"Toka, troje, terrene"* në vlerën 4,990,000 lekë; 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 4,627,654 lekë; 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* në vlerën 591,344,323 lekë; 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"* në vlerën 14,574,498 lekë; 215 *"Mjete transporti"* në vlerën 50,661,092 lekë; 466 *"Kreditorë për mjete të ndryshme"* në vlerën 7,529,229 lekë dhe 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* në vlerën 11,201,937 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, *"Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale"* i përmirësuar, pikat 29-30, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5, Kapitulli II, seksioni 2.2, pika 3.2, Aneksi 1, pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
19.1. Rekomandimi: Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Dega e Financës të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë 468 *"Debitorë të ndryshëm"*, 210 *"Toka, troje, terrene"*, 212 *"Ndërtesa e konstruksione"*, 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"*, 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"*, 215 *"Mjete transporti"*, 466 *"Kreditorë për mjete të ndryshme"* dhe 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

Deri më datë 31.03.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë evidentohet përsëri në pasqyrat financiare të Njësive Shpenzuese të Bashkisë Lushnjë konkretisht për pesë llogari: 210 "Toka, troje, terrene" në vlerën 4,990,000 lekë (Qendra e Arsimit) dhe 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 4,176,457 lekë, 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 478,995,993 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në vlerën 14,574,498 lekë dhe 215 "Mjete transporti" në vlerën 50,661,092 lekë (Ndërmarrja e Pasurisë Publike) gjendje të cilat nuk janë të analizuara me emërtesat çfarë përfaqësojnë.
***Rekomandimi nr. 19.1, Nuk është Zbatuar*.**

20. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 1,728,338,087 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,768,183,907 lekë ose me një rritje në vlerën 39,845,820 lekë. Kjo llogari është kontabilizuar si kundërparti e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"*. Ndërkohë që kundërparti e llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* është llogaria 470 *"Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë"* e pa pasqyruar në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, pika 3.2, *"Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4)"* dhe pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2024 të marrë masa për sistemimin e vlerës 1,768,183,907 lekë të kontabilizuar në mënyrë të pasaktë në llogarinë 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* duke i kontabilizuar si kundërparti në llogarinë 470 *"Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë"*.

Deri më datë 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Në gjendjen e llogarisë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)", janë evidentuar detyrime më datë 31.12.2025, në vlerën 1,937,266,058 lekë. Detyrimet e evidentuara në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" janë trajtuar si kundërparti të detyrimeve që kanë të tretët ndaj Bashkisë Lushnjë që janë kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm". Ndërkohë që referuar trajtimit kontabël të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", kundërpartia e saj është llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë".
***Rekomandimi nr. 20.1, është Nuk Zbatuar*.**

21. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,954,537,711 lekë. Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 317,224,467 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 3,616,010 lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*. Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 35,839,338 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 327,007,722 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"*. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është mbivlerësuar në vlerën 28,523,486 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
21.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra Arsimore, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit, në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2024 të kryejnë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.12.2025

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë është kontatuar vetëm në Njësinë Shpenzues Qendrën e Kulturore dhe Klubi i Sportit konkretisht Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 2,938,459,293 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 275,898,364 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 135,407,908 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 6,664,262 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 374,283,280 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,636,4360 lekë.
***Rekomandimi nr. 21.1, Nuk është Zbatuar*.**

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë për vitin 2023 nga Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit konstatohet se, në 1 rast është zhvilluar projekt artistik në vlerën 1,470,480 lekë, për të cilin nuk është përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit. Miratimi i fondit për realizimin e këtij projekti është parashikuar në buxhetin vjetor të Bashkisë Lushnjë miratuar me VKB nr. 119, datë 21.12.2022, *"Mbi miratimin e buxhetit të vitit*

2023". Nga QKKS për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, për 1 subjekt është zhvilluar projekt artistik në vlerën 1,470,480 lekë, e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të prokurimit publik, duke i përjashtuar këto procedura. Shpenzime të kryera për këtë projekt janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar, nenet 7-9 dhe nenet 65-70; Ligjin nr. 25/2014*"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe Kulturën"*, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës dhe Klubi i Sportit të nxjerr përgjegjësit për të gjitha rastet e **e**videntuara të cilat janë objekt të shpenzimeve me aktivitete social-kulturore, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Duke marrë në konsideratë të dhënat e ditarëve të bankës të QKKS-së pra edhe urdhër shpenzimet e kryera nga kjo drejtori, evidentohet se kjo problematikë përgjatë vitit 2025 është zbatuar. Për rastet e aktivitete kulturore janë ndjekur procedurat përkatëse ligjore duke aplikuar rregullat e LLP-së. Vlen të theksojmë se ky proces është verifikuar për disa praktika, ecuria mbi zbatimin dhe verifikimin e këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e radhës me objekt "Përputhshmërinë".
Rekomandimi nr. 22.1, është në Proces Zbatimi.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 20 nga 49 procedurave të prokurimit të zhvilluara nga Bashkia Lushnjë dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike me fond limit 579,391 mijë lekë pa TVSh dhe realizim kontrate me vlerë 394,887 mijë lekë pa TVSh, për periudhën 01.01.2023, deri më 31.12.2024, u konstatuan parregullsitë si më poshtë:
- Në 10 procedura ("Rindërtim i rrugës Lasgush Poradeci segmenti pas përroit" Lagja 18 Tetori, Lushnjë"; "Urbanizimi i bllokut të banimit në Lagjen Savër, Lushnjë", "Rehabilitim i godinës së palestrës në Krutje", "Punime ndërtimi në territorin e varrezave" "Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Bubullimë", "Rindërtim i shkollës 'Hysen Xheka' - Karbunarë" "Rindërtimi i shkollës 9- vjecare "Irakli Bozo" Golem", "Rikonstruksioni i godinës dhe palestrës së shkollës së mesme 'Jani Nushi", "Urbanizim i bllokut të banimit Dushk Sektor" dhe "Blerje materiale për investime në infrastrukturën rrugore rurale"), projekt-preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me liçencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi*t", i ndryshuar, neni 5;
- Në 1 procedurë *("Blerje Gazoili për nevojat e NPP dhe Bordit të Ujitjes dhe Kullimit"-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj")* me vlerë të fondit limit prej 35,583,333 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 35,583,333 lekë pa TVSh, nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit konkretisht nuk argumentohen shërbimet që do të ofrojë institucioni duke kuadruar me disponibilitetin/kapacitetin e flotës së mjeteve dhe normativave mbi konsumin e karburantin. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 76, pika 2.
- Në 1 procedurë *("Rehabilitim i kanalit ujitës U-3-24, U-3-25/1, U-3-25/2 në fshatin Krutje e Poshtme, Njësia Administrative Krutje, Bashkia Lushnjë")* me vlerë të fondit limit prej 23,964,203 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 14,466,276 lekë pa TVSh, në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht, në mos përputhje me kërkesat e nenit 78, pika 2, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.
- Në 15 procedura *("Rindërtim i rrugës Lasgush Poradeci segmenti pas përroit" Lagja 18 Tetori, Lushnjë"; "Urbanizimi i bllokut të banimit në Lagjen Savër, Lushnjë"; "Rehabilitim i godinës së palestrës në Krutje"; "Blerje materiale për investime në infrastrukturën rrugore (rurale)"; "Rehabilitim i kanalit ujitës U-3-24, U-3-25/1, U-3-25/2 në fshatin Krutje e Poshtme, Njësia*

Administrative Krutje, Bashkia Lushnjë"; "Blerje Gazoili për nevojat e NPP dhe Bordit të Ujitjes dhe Kullimit"-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj"; "Blerje materiale për ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve (çakëll, stabilizant)-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik me afat 12 muaj"; "Blerje materiale elektrike", "Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Bubullimë", "Rindërtim i shkollës 'Hysen Xheka' - Karbunarë", "Rindërtimi i shkollës 9- vjecare "Irakli Bozo" Golem", "Rikonstruksioni i godinës dhe palestrës së shkollës së mesme 'Jani Nushi", "Blerje e makine teknologjike", "Blerje materiale për shtrimin me asfalt të rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnjë" dhe "Blerje materiale për ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve (binder)-Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik me afat 12 muaj") me vlerë të fondit limit prej 567,744 mijë lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 388,719 mijë lekë pa TVSh, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Lushnjë dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT. Duke shpallur fitues OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"* dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 78.

- Në 2 procedura *("Blerje materiale për investime në infrastrukturën rrugore (rurale)" dhe "Blerje materiale elektrike")* me vlerë të fondit limit prej 31,787,776.70 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 23,596,934.80 lekë, bazuar në të dhënat e DT të publikuara në SPE dhe Kontratave dypalëshe ndërmjet Ndërmarrjes së Pasurisë Publike si AK dhe OE, nuk përcaktohet kohëzgjatja e kontratës (afati i lëvrimit të mallrave). Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, , datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"*, neni 52, pika 1, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 59, pikat 1-2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 82-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë në cilësinë e Titullarit të AK të marrë masa që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me liçensat përkatëse.

23.2. Rekomandimi: Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnjë, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit publik, të vendos kritere në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, të mirëargumentuara, në përputhje me procedurën e parashikuar, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së ofertuesve dhe konkurrencën e lirë.

23.3. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masa përpara kualifikimit të operatorit fitues në çdo rast të verifikojnë dhe vlerësojnë ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar ofertat të cilat përmbushin të gjitha kërkesat për kualifikim.

23.4. Rekomandimi: Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Njësia e Prokurimit të specifikojë në DT afatin e zgjatjes së lëvrimit të mallrave në rastin e marrëveshjeve kuadër.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Ecurimi mbi verifikimin dhe zbatimin e këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e radhës që do të zhvilloj KLSH me objekt "Përputhshmërinë".
***Rekomandimet nr. 23.1-23.4, janë në Proces Zbatimi*.**

25. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i procedurave me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2024, konstatohet se;

- Në 3 raste në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike dhe në 2 raste në Bashkinë Lushnjë fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.
- Nga verifikimi në sistemin elektronik APP rezultoni se në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në 8 raste nuk janë respektuar afatet nga shpallja e operatorit ekonomik fitues deri në konfirmimin e operatori ekonomik fitues pas ankimimit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 5, datë 26.06.2021, "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" pika19,

- Nga verifikimi në sistemin elektronik APP rezultoi se në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në 1 rast nuk janë respektuar afatet kohore të kalimit të operatorit ekonomik të radhës pas tërheqjes së operatorit ekonomik të klasifikuar më lart.", veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 5, datë 26.12.2021 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", pika 16.
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në 5 raste nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së Fondit Limit pasi nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së sasisë së mallrave/shërbimeve që do të përdoret për kryerjen e shërbimit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", pika 2,
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në 1 rast nuk janë specifikuar në ftesën për ofertë kriteret teknike për mallin/shërbimin që do të prokurohet, veprime këto jo në përputhje ligjore me Udhëzimin nr. 5, datë 26.12.2021, Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", pika 9, gërma b),
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në Bashkinë Lushnjë në 2 raste nuk janë respektuar kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Ftesën për Ofertë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 82-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor, të marrë masa që në vijimësi, në organizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të argumentojë fondin limit bazuar në dokumentacionin justifikues, si dhe të ngrihen grupe pune me specialistë të fushës për përcaktimin e nevojave për punë, mallra e shërbime, të argumentojë hartimin e kritereve dhe specifikimeve për kualifikim, si dhe të respektojë përcaktimet ligjore në zbatimin e afateve për kalimin në operatorin ekonomik të radhës si afatet e konfirmimit të operatorit ekonomik fitues pas ankimimit.

25.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Lushnjë dhe në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike ta marrë masa për likuidimin e faturave brenda afateve ligjore, me qëllim parandalimin e riskut për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Ecurimi mbi verifikimin dhe zbatimin e këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e radhës që do të zhvilloj KLSH me objekt "Përputhshmërinë".
***Rekomandimet nr. 25.1-25.2, janë në Proces Zbatimi*.**

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Lushnjë rezultoi se për 75 raste, është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, ndajë kundërvajtësve për të cilat vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV. *Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pika a dhe nenin 51 të ligjit 107/2017 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 222-226 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), për të cilat ka një vendim prishje objekti, të bëj kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Ecurimi mbi verifikimin dhe zbatimin e këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e radhës që do të zhvilloj KLSH me objekt "Përputhshmërinë".
***Rekomandimi nr. 26.1, është në Proces Zbatimi*.**

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në 7 (shtatë) raste, mungojnë vërtetimet e statusit aktiv për të gjithë subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore**,** polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit elektrik është jashtë afatit të mbulimit si dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të

azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:
1. Leje ndërtimi për objektin "Magazinë për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore ", miratuar me Vendim Nr. 175 Prot; datë 26.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
2. Leje ndërtimi për objektin "Njësi për magazinimin e materialeve të ndërtimit dhe fushave të tjera të ngjashme me to", me adresë në lagjen Karbunarë e Poshtme ", miratuar me Vendim Nr. 212 prot; datë 02.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
3. Leje ndërtimi për objektin "Magazinë për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore", me adresë në fshatin Krutje e Poshtme ", miratuar me Vendim Nr. 130 prot; datë 06.06.2023, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
4. Leje ndërtimi për objektin "Magazinë 1 kt për grumbullimin, përpunimin e produkteve bujqësore ", miratuar me Vendim Nr. 62 Prot; datë 11.04.2024, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
5. Leje ndërtimi për objektin "Kapanon për grumbullimin, përpunimin e produkteve bujqësore", miratuar me Vendim Nr. 58 Prot; datë 02.04.2024, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
6. Leje ndërtimi për objektin "Magazinim dhe tregtim artikuj të ndryshëm", me adresë fshati Plug, Bashkia Lushnjë ", miratuar me Vendim Nr. 13 prot; datë 15.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
7. Leje ndërtimi për objektin "Stallë për mbarështimin e zogjve", me adresë në fshatin Plug, Bashkia Lushnjë", miratuar me Vendim Nr. 239 prot; datë 30.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b), ë), g); pika 1/1, nënpika i), iii); Ligjin nr. 111/2018 "*Për kadastrën*", i ndryshuar, neni 19, pika 2; L. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 206-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

27.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Lushnjë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet me: plotësinë dhe saktësinë e projekteve ndërtimore; studimet sizmologo – inxhinierik dhe studimit gjeologo-inxhinierik; vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore; licencat profesionale dhe çertifikatat për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore; ngarkimin e deklaratave të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, si dhe saktësinë e tyre; policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, si dhe të jenë brenda afateve, në raport me datën e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 2914 prot., datë 26.03.2026, znj. A. B. Drejtor i DPZHTM është drejtuar grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve në Bashkinë Lushnjë, se do të angazhohet maksimalisht për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nr. 27.1, është në Proces Zbatimi.

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:
KLSH ka dërguar në Bashkinë Lushnjë rekomandimet e auditimit të fundit me shkresën nr. 866/7 prot., datë 29.01.2024. Bashkia Lushnjë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 919/2 prot., datë 13.02.2024, duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh si dhe me shkresën nr. 6195/1 prot., datë 26.07.2024 ka kthyer përgjigje brenda gjashtë muajve, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit duke ngarkuar me përgjegjësi drejtoritë përkatëse. Bashkia Lushnjë nuk **ka raportuar në** Këshillin Bashkiak, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Neni 50-Auditimi i jashtëm.
Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë*:*
a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 16 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 6 masa, në proces zbatimi 3 masa dhe pa zbatuar 7 masa. Nga 7 masa të zbatuara pjesërisht ose pa zbatuar nuk ri kërkohen 3 masa (1.1, 1.2 dhe 4.1), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe është pjesë e raportit përfundimtar.

B. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash. janë rekomanduar 8 masa në vlerën **3,005,116,268** lekë të cila janë në proces arkëtimi.

d. Janë rekomanduar 12 masa disiplinore. Nga verifikimi rezulton se statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i zbatuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 7, faqe 226-244, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

a. Për 4 masë organizative

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlera e akumuluar e amortizimit dhe vlera e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre dhe ekzistencës fizike.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të marrë masa për kryerjen e procedurave të plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave paraprake të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuara të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Rajonale Lushnjë.

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë të marrë masa për ngritjen e strukturës (drejtori/sektorë/njësi) të dedikuar për Informacionin Gjeohapësinor, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes në dhënien e lejeve.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë të marrë masa për rritjen e kontributeve profesionale në inspektoratin e mbrojtjes të territorit, të rekrutojë në strukturën e IMT punonjës me formim profesional inxhinier ndërtimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së punës së Inspektoratit dhe bashkëveprimin me strukturat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Menjëherë

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Për sa i përket këtij rekomandimi u konstatua se, mbetet në të njëjtën fazë pra nuk ka marrje masash për zbatimin e këtij rekomandimi.
***Rekomandimi nr. 28.1, Nuk është Zbatuar*.**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja "b" dhe "c" -Të drejtat e KLSH, dhe mbështëtur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe pikën 93 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Lushnjë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,871,004 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "Urbanizimi i bllokut të banimit në Dushk Sektor", me nr.7647 prot., datë 20.09.2023, të lidhur midis

AK Bashkisë Lushnjë dhe OE "L. C." ShPK. me vlerë 31,607,970 lekë me TVSh dhe afat 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,761,169 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimin nr.3 datë 15.2.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës prej **1,761,169 lekë pa TVSh** nga OE "L. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7647 prot., datë 20.09.2023, me objekt: "Urbanizimi i bllokut të banimit në Dushk Sektor", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9886 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "L. C." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 405, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "L. C." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 1,761,169 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 7647 prot., datë 20.09.2023, me objekt "Urbanizimi i bllokut të banimit në Dushk Sektor", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
***Rekomandimi nr. 1.1. është në Proces Zbatimi*.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Urbanizimi i bllokut të banimit në lagjen Saver"* me nr. 6156 prot., datë 25.07.2023, të lidhur midis AK Bashkisë Lushnjë dhe OE "2." ShPK me vlerë 30,000,000 lekë me TVSh dhe afat kohorë 259 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **872,980 lekë pa TVSH.** Gjithashtu për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve brenda afateve të kontratës dhe amendamentit të sajë me rreth 22 ditë vonesë, kontraktorit i është llogaritur një **penalitet në vlerën 330,000 lekë me TVSh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **872,980 lekë pa TVSh** nga OE "2." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6156 prot., datë 25.07.2023, me objekt: "*Urbanizimi i bllokut të banimit në lagjen Saver*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e **penalitetit në vlerën 330,000 lekë me TVSh**.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9884 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "2." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me
Vendimin nr. 404, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "2." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 872,980 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 6156 prot., datë 25.07.2023, me objekt "Urbanizimi i bllokut të banimit në Lagjen Savër", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
***Rekomandimet nr. 2.1, dhe nr. 2.2, është në Proces Zbatimi*.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt:*"Rindertimi i rruges "Lasgush Poradeci"* me nr. 4405 prot., datë 30.05.2023, të lidhur midis AK Bashkia Lushnjë dhe OE "Sh.7" ShPK. me vlerë kontrate 24,000,000 lekë me TVSh dhe afat kohorë 130 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **489,472 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **489,472 lekë pa TVSh** nga OE "Sh.7" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4405 prot., datë 30.05.2023, me objekt: "Rindërtimi i rrugës "Lasgush Poradeci", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9874 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "Sh.7." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 399, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "Sh.7." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 489,472 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 4405 prot., datë 30.05.2023, me objekt "Rindërtimi i rrugës Lasgush Poradeci segmenti pas përroit", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
***Rekomandimi nr. 3.1, është në Proces Zbatimi*.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos se duhanit",* me nr. 7941 prot., datë 12.09.2022, të lidhur midis AK Bashkia Lushnjë dhe OE "Z." ShPK me vlerë kontrate 25,301,537 lekë me TVSh dhe afat kohorë 175 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **618,289 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **618,289 lekë pa TVSh** nga OE "Z." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7941 prot., datë 12.09.2022, me objekt: "*Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos se duhanit*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9882 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S.
Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "Z." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 403, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "Z." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 618,289 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 7941 prot., datë 12.09.2022, me objekt "Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish-depos së duhanit", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
***Rekomandimi nr. 4.1, është në Proces Zbatimi*.**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Sistemim asfaltim i segmentit rrugor 'Taulla Sinani' – 'Esma Dervishi",* me nr.7936 prot., datë 12.09.2022, të lidhur midis AK Bashkia Lushnjë dhe OE "C.R.20." shpk me vlerë kontrate 18,491,131 lekë me TVSh dhe afat kohorë 75 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **456,855 lekë pa TVSh.** Ndërsa për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve brenda afateve të kontratës dhe amendamentit të sajë me rreth 9 ditë vonesë, Kontraktorit i është llogaritur një penaliteti në vlerën **305,681 lekë me TVSh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **456,855 lekë pa TVSh** nga OE "C.R.20." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7936 prot., datë 12.09.2022, me objekt: "*Sistemim asfaltim i segmentit rrugor 'Taulla Sinani' – 'Esma Dervishi*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

5.2. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e **penalitet në vlerën 305,681 lekë me TVSH**.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9878 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "C.R. 20." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 401, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "C.R.20." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 456,855 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 7936 prot., datë 12.09.2022, me objekt "Sistemim, asfaltim i segmentit rrugor Taull Sinani-Esma Dervishi", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
Me shkresën nr. 9888 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "C. R. 20." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 406, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "C. R. 20." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 305,681 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 7936 prot., datë 12.09.2022, me objekt "Sistemim, asfaltim i segmentit rrugor Taull Sinani-Esma Dervishi", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
Rekomandimet nr. 5.1, dhe nr. 5.2, janë në Proces Zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Punime ndërtimi në territorin e varrezave",* me nr.7869 prot., datë 26.09.2023, të lidhur midis AK Bashkisë Lushnjë dhe OE "LL." ShPK me vkerë 34,634,671 lekë me TVSh dhe afat kohorë 111 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **205,166 lekë pa TVSh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **205,166 lekë pa TVSh** nga OE "LL." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7869 prot., datë 26.09.2023, me objekt: "*Punime ndërtimi në territorin e varrezave*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9876 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "Ll." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 400, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "Ll." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 205,166 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 7869 prot., datë 26.09.2023, me objekt "Punime ndërtimi në territorin e varrezave", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Me shkresën nr. 20 prot., datë 11.11.2025, është lëshuar fatura për arkëtim në vlerën 205,166 lekë e cila është likuiduar nga OE "Ll." ShPK me transaksionin e datës 12.11.2025, në Raiffeisen Bankë.
Rekomandimi nr. 6.1, është Zbatuar Plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare 'Irakli Bozo' Golem",* me nr. 831 prot., datë 29.01.2024, të lidhur midis AK Bashkia Lushnjë dhe OE "N." ShPK me vlerë kontrate 30,536,684 lekë me TVSh dhe afat kohorë 120 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **537,675 lekë pa TVSh.** Gjithashtu për shkak të vonesave në përfundimin e punimeve brenda afateve të kontratës dhe amendamentit të sajë me rreth 30 ditë vonesë, Kontraktorit i është llogaritur një penaliteti në vlerën **916,100.5 lekë me TVSh, që do të konsiderohet si dëm ekonomik.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **537,675 lekë pa TVSh** nga OE "N." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 831 prot., datë 29.01.2024, me objekt: "*Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare 'Irakli Bozo' Golem*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
7.2. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e **penalitetit në vlerën 916,100.5 lekë me TVSH**.

Brenda datës 31.12.2025

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9870 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "N." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 397, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE
"N." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 537,675 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 831 prot., datë 29.01.2024, me objekt "Rindërtim i shkollës 9-vjeçare "Irakli Bozo" Golem", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Me shkresën nr. 9890 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar OE "N." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 407, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që OE "N." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 305,681 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 7936 prot., datë 12.09.2022, me objekt "Sistemim, asfaltim i segmentit rrugor Taull Sinani-Esma Dervishi", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
Rekomandimet nr. 7.1, dhe nr. 7.2, janë në Proces Zbatimi.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Rehabilitimi i palestrës, shkolla 'Foto Puka",* me nr.11407 prot., datë 28.12.2022, lidhur midis AK

Bashkia Lushnjë dhe BOE "Z." ShPK & "T." ShPK. me vlerë kontrate 26,065,008 lekë me TVSh dhe afat kohorë 62 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **200,717 lekë pa TVSh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **200,717 lekë pa TVSh** nga BOE "A." ShPK & "H. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11407 prot., datë 28.12.2022, me objekt: "*Rehabilitimi i palestrës, shkolla 'Foto Puka*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9872 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar BOE "Z." ShPK & "T." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 398, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që BOE "Z." ShPK & "T." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 200,717 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 11407 prot., datë 28.12.2022, me objekt "Rehabilitimi i palestrës, shkolla 'Foto Puka", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
Rekomandimi nr. 8.1, është në Proces Zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "*Rikonstruksion i qendrës Shëndetësore Bubullimë"* me nr. 5244 prot., 24.06.2024, të lidhur midis AK Bashkia Lushnjë dhe BOE "I. G. & V. G." ShPK. me vlerë kontrate 25,405,480 lekë me TVSh dhe afat kohorë 120 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **176,900 lekë pa TVSh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe Udhëzimin nr.2 datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" dhe nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 188-206 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **176,900 lekë pa TVSh** nga BOE "I. G. & V. G." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5244 prot., 24.06.2024, me objekt: "*Rikonstruksion i qendrës Shëndetësore Bubullimë*", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2025

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 9880 prot., datë 05.11.2025, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë është drejtuar BOE "I. G. & V. G." ShPK me njoftim për shpërblim dëmi për punimet e pakryera, referuar Raportit Përpundimtar të KLSH me nr. 1345/14 prot., datë 16.10.2025. Me Vendimin nr. 402, datë 05.11.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka vendosur që BOE "I. G. & V. G." ShPK të paguajë dëmin në vlerën prej 176,900 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën lidhur me AK Bashkia Lushnjë me nr. 5244 prot., datë 24.06.2024, me objekt "Rikonstruksion i qendrës Shëndetësore Bubullimë", si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Me shkresën nr. 6 prot., datë 20.01.2026, është lëshuar fatura për arkëtim në vlerën 177,195 lekë e cila është likuiduar nga OE "I. G." ShPK me transaksionin e datës 14.04.2026, në Raiffeisen Bankë.
***Rekomandimi nr. 9.1, është Zbatuar Plotësisht*.**

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri më datën 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë, biznesi i madh dhe i vogël në vlerën **1,681,040,017 lekë.** Përgjatë vitit 2024 janë shtuar debitorë në vlerën **197,692,335 lekë** nga e cila është arkëtuar vlera **149,418,105 lekë** ku gjendja debitore më datë 31.12.2024, është në vlerën **1,729,314,247 lekë, të cilët i përkasin debitorëve të pa arkëtuar, e përbërë nga:**

1. nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore ne vlerën **402,341,457 lekë:**
2. nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit Vlera **495,430,711** ;
3. nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës Vlera **323,400,037 lekë** ;
4. nga mos arkëtimi i taksës së truallit Vlera **18,782,701 lekë** ;
5. nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i vogël Vlera **94,433,081 lekë** ;
6. nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i madh Vlera **394,926,261 lekë**:

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Kreu XI *"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara"*, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 *"Të drejtat dhe përgjegjësitë"*, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e qeverisjes vendore"*, neni 35 *"Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore"*. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2024, në **vlerën totale 1,729,314,457 lekë,** e cila përbëhet nga:

-**402,341,457 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore;
-**495,430,711 lekë** detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit;
-**323,400,037 lekë** detyrime për taksës së ndërtese;
-**18,782,701 lekë** detyrime për taksës së truallit;
-**94,433,081 lekë** detyrime nga biznesi i vogël;
-**394,926,261 lekë** detyrime nga biznesi i madh;

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Deri më datë 31.12.2025, gjendja e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore paraqitet në vlerën 1,933,155,963 lekë. Evidentohet se nga Drejtoria e të Ardhurave nuk janë masa konkrete për ujen e këtij detyrimi konkretisht: njoftime për shlyrjen e detyrimeve deri në bllokimin e llogarive bankare etj., deri në rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e këtij detyrimi.
***Rekomandimi nr. 1.1, është në Proces Zbatimi*.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Dega Lushnjë janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi u konstatua se deri më datë 31.12.2023, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është në vlerën 41,915,341.70 lekë për 1,408 përfitues. Përgjatë vitit 2024 janë shtuar debitorë në vlerën 7,033,501 lekë nga e cila është arkëtuar vlera 16,450,713 lekë ku gjendja debitore më datë 31.12.2023, është në vlerën 7,923,879.71 lekë për 134 përfitues. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2024, është në vlerën **32,498,129 lekë për 1,542 përfitues, të cilët konsiderohen debitorë të pa arkëtuar.** Për më tepër nga Bashkia Lushnjë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK Lushnjë për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë

03.04.2006, *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*, neni 27, pika *"d"*, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, *"Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim"* i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për *"Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet"* dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerë progresive prej **1,542 debitorë në vlerën 32,498,129 lekë,** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Lushnjë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Deri më datë 31.12.2025, gjendja e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore paraqitet në vlerën 1,933,155,963 lekë. Evidentohet se nga Drejtoria e të Ardhurave nuk janë masa konkrete për ujen e këtij detyrimi konkretisht: njoftime për shlyrjen e detyrimeve deri në bllokimin e llogarive bankare etj., deri në rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e këtij detyrimi.
***Rekomandimi nr. 2.1, është në Proces Zbatimi*.**

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil apo për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58 "llojet e masave disiplinore" të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" i ndryshuar dhe, nenin 64 germa g, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a- <u>"Vërejtje"</u>

1. Z. M. Sh. Drejtor i Qendrës së Arsimit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

2. Znj. L H. Përgjegjës i Degës së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

3. Z. E. Q. Drejtor i Ndërmarrjes së Pasurisë Publike në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

4. Z. F. K. Përgjegjës i Degës së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

5. Znj. B. D. Drejtor i Qendrës Kulturore dhe Klubit të Sportit.

6. **Z. Y. Gj.** Përgjegjës i Degës së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

<u>Për shkeljet e konstatuara</u> në procesin e inventarizimit të aktiveve dhe procedurat e nxjerrjes aktive jashtë përdorimit për vitin 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, dat 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, *"Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, pikat 89-90. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për punonjësit e tjerë të cilët kanë rezultuar me mangësi gjatë ushtrimit të detyrave institucionale, nuk rekomandojmë masë disiplinore për shkak të nivelit të ulët të materialitetit sasior dhe cilësor.

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Me Urdhrin nr. 15, datë 15.01.2026, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë ka ngritur komisionin për dhënien e masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, i përbërë nga z. B. H. kryetar i komisonit dhe anëtarët znj. E. Q., znj. A. B.
Titullari i institucionit me shkresën nr. 709 prot., datë 16.01.2026, nr. 710 prot., datë 16.01.2026, nr. 711 prot., datë 16.01.2026 dhe nr. 712 prot., datë 16.01.2026, për punonjësit z. M. Sh., znj. L. H., znj. B. D., znj. Y. Gj.
Me shkresën nr. 652/1 prot., datë 23.01.2026, anëtarët e komisonit dhe punonjësit pjesë e procesit disiplinor kanë mbajtur procesverbalin e mbledhjes për njohjen dhe trajtimin e masave disiplinore të lënga KLSH.
Në vijim të këtij rekomandimi nga Kryetari i Bashkisë Lushnjë janë marrë masa konkrete duke dal me vendimet përkatëse për dhënien e masave disiplinore konkretisht:
- Vendimi nr. 38, datë 28.01.2026, "Për mos dhënie masë disiplinore" për z. E. Q. Drejtor i NPP pasi punonjësi në fjalë me vendimin nr. 339, datë 03.10.2025, ka përfunduar marrëdhëniet e punës;
- Vendimi nr. 39, datë 28.01.2026, "Për mos dhënie masë disiplinore" për z. F. K. Përgjegjës i Financës në NPP pasi punonjësi në fjalë me vendimin nr. 91, datë 20.02.2024, ka përfunduar marrëdhëniet e punës;
- Vendimi nr. 40, datë 28.01.2026, "Për dhënie masë disiplinore" për znj. B. D. Drejtor i QKKS është dhënë masa disiplinore "Vërejte";
- Vendimi nr. 41, datë 28.01.2026, "Për dhënie masë disiplinore" për znj. Y. Gj. Përgjegjës i Financës së QKKS është dhënë masa disiplinore "Vërejte";
- Vendimi nr. 42, datë 28.01.2026, "Për dhënie masë disiplinore" për znj. L. H. Përgjegjës i Financës së QA është dhënë masa disiplinore "Vërejte";
- Vendimi nr. 43, datë 28.01.2026, "Për dhënie masë disiplinore" për z. M. Sh. Drejtor i QA është dhënë masa disiplinore "Vërejte";
Rekomandimi nr. 1-6, është Zbatuar Plotësisht.

Konkluzion: Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **48** rekomandime të lëna në total, janë pranuar nga Subjekti Bashkia Lushnjë **48** rekomandime; janë verifikuar **48** rekomandimet nga të cilat: janë zbatuar 7 masa ose **14.6%** e tyre; 15 masa janë në proces zbatimi; 12 masa janë pjesërisht zbatuar dhe 14 masa janë e pa zbatuar; pra 26 masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti Bashkia Lushnjë për periudhën në vijim.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuara dhe të zbatuara nga Bashkia Lushnjë (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që:
- Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R10.1; R10.2; R12.1; R13.1 (janë zbatuar), Rekomandimet R2.1; R3.1; R7.1; R15.1; R15.2; R23.1; R23.2; R23.3; R23.4; R25.1; R25.2; R26.1; R27.1; (janë në proçes zbatimi);
- Për kategorinë "Masa Shpërblim dëmi"- Rekomandimet R6.1; R9.1 në vlerën totale 382,066 lekë (janë zbatuar);
- Për kategorinë "Masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara)"- Rekomandimet R1.1; R2.1; (janë në proçes zbatimi),
- Për kategorinë "Masa Disiplinore" për 6 punonjës (është zbatuar);
janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga Bashkia Lushnjë, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

Në mbështëtje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit në RPA dërguar me shkresën 973/7 prot. dt. 12.02.2026, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 21 datë 12.02.2026, mbërritur në Bashkinë Lushnjë dhe regjistruar me nr. 1736 prot., datë 12.02.2026, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja e

masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pa zbatuara si më poshtë vijon:

f. Masa për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi ***nuk është*** lënë masë;

g. Masa Organizative janë lënë **14** nga të cilat janë pranuar **14** masa: **7** masa janë zbatuar, **0** masa janë në proces zbatimi, **1** masë është pjesërisht zbatuar dhe **6** masa janë pa zbatuar;

h. Masa disiplinore për 1 punonjës është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi;

- **Drejtimet e auditimit**

I. *Mbi hartimin dhe miratimin e "Planit të veprimit" dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA*

- Në Bashkinë Lushnjë, nga kryetari i bashkisë është miratuar plani i veprimit dhe është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1736/2 prot., datë 05.03.2026 "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA", në të cilin janë caktuar dhe personat përgjegjës për ndjekjen e çdo rekomandimi dhe afatet konkrete për zbatimin e tyre.

"Plani i veprimit" ***është dërguar*** në KLSH *brenda afatit 20 ditor*, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin në afat të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit "Bashkia Lushnjë* ***ka kthyer përgjigje*** *zyrtare në KLSH brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon "Planin e Veprimeve", duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.*

Zbatuar

II. *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm*

- Në zbatim të ligjit nr.154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt "Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit", ende nuk është përmbushur afati 6 mujor për raportimin mbi statusin e rekomandimeve të lëna në RPA përcjellë me shkresën nr. 973/7 prot., datë 12.02.2026, afat i cili përfundon më datën 13.08.2026. Grupi i auditimit në zbatim të programit të auditimit nr. 737/1 prot., datë 30.06.2026 "Auditim financiar në Bashkinë Lushnjë" i ndryshuar, ka ndjekur ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në RPA deri më datë 27.07.2026.

Brenda afatit të zbatimit

III. *Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të KLSH, sipas përcaktimeve në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".*

- Bashkia Lushnjë ka raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me "Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së"

Zbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

- **Rekomandime të lëna në RPA me shkresën përcjellëse nr. 973/7 prot. dt. 12.02.2026**

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i llogarisë analitike 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" u konstatua se nuk kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" në pasqyrën e performancës financiare. Konstatohet mosrakordim në shumën 18,040,444 lekë mes llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" pasqyruar në shumën 48,231,432 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar e cila është rezultat i detyrime për paga, për tatime taksa dhe sigurime shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to dhe llogarisë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" pasqyruar në shumën 30,190,988 lekë në pasqyrën e performancës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i

ndryshuar, Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat që në vijim me mbylljen e periudhave kontabël të bëjë rakordimin e llogarive kontabël financim i pritshëm nga buxheti me operacione me shtetin (të drejta) në mënyrë që të kemi një pasqyrë të drejtë të pozicionit financiar dhe performancës financiare ne mbyllje të periudhave kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, llogaria 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" paraqitet në vlerën 49,372,754 lekë. Si kundërparti referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, pika 58, parashikohet të jetë llogaria 7206 "Financimi i pritshëm nga buxheti". Në këtë pike citohet se: "Ky rast përbën një detyrim të shtetit ndaj njësisë, i cili kërkon mbulim me fonde dhe në periudhat e ardhshme. Për këtë arsye, ky detyrim duhet të jetë real dhe të përfaqësojë vetëm atë pjesë të konstatuar si shpenzim në vitin që raportohet, duke qenë gjithmonë brenda fondit (grantit nga buxheti) të parealizuar të vitit ushtrimor raportues". Në këtë llogari janë përfshirë detyrimet që vijinë nga llogaritë 401-408 "Furniturë e llogari të lidhura me to" në vlerën 3.975,386 lekë; 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 19,167,378 lekë; 431 "Detyrime ndaj shtetit pëtr tatim taksa" në 1,865,779 lekë; 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 5,876,510 lekë dhe 436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 808,324 lekë, ku totali shkon në vlerën 31,693,377 lekë i cili kuadron me llogarinë7206 "Financimi i pritshëm nga buxheti" në vlerën 31,693,377 lekë.
***Rekomandimi nr. 1.1, është Zbatur Plotësisht*.**

2. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë analitike 210 "Toka, troje, terrene" u konstatua se gjatë vitit 2024 janë bërë shtesa në këtë llogari troje, parcelat bujqësore dhe gurore me sipërfaqe totale 648,608 m^2 por me vlerë 17 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" konstatohet se gjatë vitit ushtrimor 2024 janë shtuar 12 ndërtesa, të cilat janë kontabilizuar në shumën 12 lekë, pra 1 lek për ndërtesë. Efekti në pasqyrat financiare të vitit 2024 është mosparaqitje e drejtë dhe e saktë e aktiveve në pozicionin financiar. Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare informacioni i pasqyruar në pozicionin financiar të Bashkisë nuk është i drejtë dhe i saktë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurat Vendore të marrin masat menjëherë për përcaktimin e saktë të vlerës së aseteve të shtuara gjatë vitit 2024 dhe kontabilizimin e vlerave të sakta në llogaritë e aktiveve afatgjata sipas kërkesave dhe tekN...ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Menjëherë

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Në referencë të analizave të llogarive të aktivit u konstatua se, në llogaritë 210 "Toka, troje terrene" dhe 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" vazhdojnë ende të kontablizuara aktive të pasqyruara me vlerën 1 lekë edhe pse janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Lushnjë nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procesit të vlerësimit me qëllim pasqyrimin me vlerë reale të tyre në kontabilitet.
***Rekomandimi nr. 2.1, Nuk është Zbatuar*.**

3. Gjetje nga audimi: Nga auditimi analitik i llogarisë së aktiveve afatgjata u konstatua se;
- Për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", norma e aplikuar nga subjekti është në masën 20%. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së saktë të amortizimit përllogaritet në shumën 120,425,254 lekë, si nënvlerësim i pozicionit financiar.
- Për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" norma e amortizimit e aplikuar nga subjekti është në masën 13%. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së

pasqyrave financiare, si rezultat i mos aplikimit të normës së saktë të amortizimit përllogaritet në shumën 409,043 lekë, si mbivlerësim i pozicionit financiar.
- Për llogarinë 215 "Mjete transporti" Bashkia Lushnjë nuk ka përllogaritur amortizim vjetor. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar si rezultat i mosaplikimit të normës së amortizimit përllogaritet në shumën 1,887,703 lekë, si mbivlerësim i pozicionit financiar.
- Për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" norma e amortizimit e aplikuar nga subjekti është në masën 14%. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së saktë të amortizimit përllogaritet në shumën 153,862 lekë, si mbivlerësim i pozicionit financiar. Mosaplikimi i normave të duhura të amortizimit për aktivet ka sjellë si efekt mospasqyrimin e saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.
Nga auditimi i pasqyrës "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" u konstatua se nga përllogaritjet e amortizimeve sipas klasave të aktiveve nga grupi i auditimit, vlera neto e aktiveve është nënvlerësuar në shumën 117,974,646 lekë. Për aktivet e pasqyruara në kolonën "Pakësimet gjatë vitit" në shumën 2,814,524 lekë janë bërë me kosto historike dhe për to nuk është bërë rimarrja e amortizimit të akumuluar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 36.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për evidentimin dhe sistemimin e transaksioneve që lidhen me diferencën e konstatuar në shumën 117,974,646 lekë. Të bëhen stornimet e kontabilizimeve të pasakta dhe të ribëhen kontabilizimet e sakta të transaksioneve të llogarive 213, 214, 215 dhe 218, si dhe efekti i rillogaritjeve të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit kontabël 2025, sipas kërkesave dhe tek N...ve kontabël me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, të pasqyrave financiare të Aparatit të Bashkisë Lushnjë konkretisht aktiveve afatgjata material u konstatua se, për disa llogari janë aplikuar norma amortizimi jo në përputhje me rregullat kontabël konkretisht:
- Nuk ka aplikuar nomrë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhej të aplikohej normë amortizimi në vlerën 3,079,062 lekë në masën 20% (9,438,513 lekë çelja e vitit + 5,956,800 lekë shtesa e vitit * 20% / 100 = 3,079,062 lekë);
- Ka aplikuar normë amortizimi në vlerën 278,200 lekë për llogarinë 218 "Inventar ekonomik". Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%.
***Rekomandimi nr. 3.1, Zbatuar Pjesërisht*.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 401-408, "Furnitorë e llogari të lidhura me to" u konstatuan keq klasifikime në shumën 1,851,488 lekë. Kjo shumë përbëhet nga detyrime të Bashkisë ndaj anëtarëve të Këshillit Bashkiak në shumën 1,562,890 lekë si dhe tatimit në burim në shumën 318,598 lekë lidhur me këto detyrime. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që në konstatimet dhe kontabilizimet e detyrimeve të plotësohen dhe respektohen kërkesat dhe tek N.T. kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë, si dhe të bëjë riklasifikimin kontabël të shumës 1,851,488 lekë në llogaritë e pagueshme të detyrimeve afatshkurtra sipas kritereve kontabël të secilës llogari.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Kjo vlerën prej 1,851,488 lekë është kryer si veprim sistemues pasi është likuiduar nëpërmjet pagesave të muajit Janar të vitit 2025 për llogari të detyrimeve të muajt

dhjetor të vitit 2024.
Rekomandimi nr. 4.1, është Zbatuar Plotësisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve afatshkurtra për llogarinë 42 "Detyrime ndaj personelit" konstatohet se për periudhën e auditimit detyrimi për pagat neto nuk rakordon me vlerat sipas listë pagesës E-sig025 të muajit dhjetor, diferenca e konstatuar përllogaritet në shumën 2,215,819 lekë. Për llogarinë "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" konstatohet një diferencë në shumën 119,001 lekë mes detyrimit të konstatuar dhe detyrimit të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për llogarinë 435 "Sigurime shoqërore" dhe llogarinë 436 "Sigurime shëndetësore" të cilat përfaqësojnë detyrimin e kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor për vitin 2024 konstatohen diferenca në shumën 683,838 lekë për sigurimet shoqërore dhe në shumën 94,912 lekë për sigurimet shëndetësore mes detyrimeve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe detyrimeve të konstatuara në listë pagesën e deklaruar E-sig025 të muajit dhjetor në organet tatimore në sistemin C@ts. Veprime e mësipërme vijnë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksi 1 "*Detyrimet afatshkurtra*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat që për konstatimet dhe kontabilizimet e detyrimeve afatshkurtra të plotësohen dhe respektohen kërkesat dhe tekN.t. kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Për verfikimin dhe zbatimin e këtij rekomandimi u krahasuan të dhënat e shkarkuara nga Sistemi ESIG me llogaritë në kontailitet u konstatua se:
- Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 1,865,779 lekë e njëjtë me atë të Sistemit ESIG;
- Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 5,876,510 lekë e njëjtë me atë të Sistemit ESIG;
- Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 808,324 lekë e njëjtë me atë të Sistemit ESIG;

Dokumenti i ESIG është dorëzuar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimore Fier më datë 06.01.2026.
Rekomandimi nr. 5.1, është Zbatuar Plotësisht.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" u konstatuan transaksione të keq klasifikuara në shumën 17,950,115 lekë. Kjo shumë përbëhet nga transaksione lidhur me shpenzime për shërbime dhe mirëmbajtje në shumën 2,209,167 lekë, transaksione lidhur me blerje mallrash në shumën 419,068 lekë si dhe transaksione lidhur me investimet në shumën 15,321,881 lekë të cilat nuk plotësojnë kriteret për tu kontabilizuar në këtë llogari, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksi 1 funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që në konstatimet dhe kontabilizimet e detyrimeve të plotësohen dhe respektohen kërkesat dhe tek N.T. kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë, si dhe transaksionet e keqklasifikuara në shumën 17,950,115 lekë të sistemohen në llogaritë e pagueshme te detyrimeve afatshkurta sipas kritereve kontabël të secilës llogari.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i veprime të kryera në gjendjen e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm", për vlerën 17,950,155 lekë pjesë e Pasqyrave Financiare të Apratit të Bashkisë Lushnjë nuk janë kryer veprimet sistemuese duke mos u kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 401-408.

Rekomandimi nr. 6.1, Nuk është i Zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" u konstatua se shuma 362,366,608 lekë, e cila përfaqëson mjete monetare të trashëguara nga periudhat e mëparshme kontabël, është kontabilizuar në të ardhura të periudhës. Këto mjete monetare janë konstatuar, kontabilizuar dhe janë pasqyruar në pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme kontabël. Kontabilizimi sërish i këtyre mjeteve monetare në të ardhura të periudhës ka efekt në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare duke dhënë një rezultat jo të drejtë dhe të saktë të periudhës për njësinë duke e mbivlerësuar atë në shumën 362,366,608 lekë. Nga auditimi i llogarisë 73 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve" konstatohet se teprica e kësaj llogarie në shumën 1,912,795 është kontabilizuar në mënyrë jo të saktë sepse kjo llogari përdoret për njësitë që merren me aktivitet prodhimi. Efekti në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos pasqyrimit të saktë të të ardhurave jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të rezultatit të periudhës për njësinë duke e mbivlerësuar atë në shumën 1,912,795 lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 21.02.2021 "*Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09/03/2018* "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që në konstatimet dhe kontabilizimet e të ardhurave të plotësohen dhe respektohen kërkesat dhe tekN...t kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare e cila ndikon drejtpërdrejt pasqyrën e pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Aparatit të Bashkisë Lushnjë evidentohet e njëjta problematikë ku në gjendjen e llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" është kontabilizuar vlera prej 566,697,377 lekë.
Rekomandimi nr. 7.1, Nuk është Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" konstatohet një diferencë në shumën 2,800,500 lekë shpenzime të pakonstatuara si shpenzime periudhe. Nga auditimi i llogarisë 601 "Kontribute të Sigurimeve" shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore konstatohet një diferencë në shumën 1,084,147 lekë shpenzime të pakonstatuara si shpenzime periudhe. Nga auditimi i llogarisë 602 "Blerje mallra e shërbime" konstatohet se ka diferencë në shumën 291,313 lekë shpenzimeve të pakonstatuara si shpenzime periudhe duke sjellë një pasqyrim jo të saktë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për periudhën kontabël. Diferencat e konstatuara lidhur me llogaritë e mësipërme janë përllogaritur duke marrë në konsideratë detyrimet e pasqyruara në çelje dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 në pasqyrën e pozicionit financiar si dhe shpenzimet e pasqyruara në pasqyrën e performancës financiare të vitit 2024. Efekti në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos konstatimit të saktë të shpenzimeve jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të rezultatit të periudhës për njësinë. Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar rubrika 2.3 paragrafi 20. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për konstatimin dhe kontabilizimin e saktë të të gjitha transaksioneve të cilat kanë ndikim në rezultatin e periudhës përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Referuar të dhënave të kontabilizuara në gjendjen e llogarisë 600 "Paga", 601 "Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore" dhe 602 "Shpenzimeve

operative" u konstaua se, janë kryer veprimet sistemuese në mbylljen vjetore të vitit pasaardhës në zbatim të pagesave sipas urdhrave të shpenzimeve korrente.
Rekomandimi nr. 8.1, është Zbatuar Plotësisht.

9. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" konstatohet se kjo llogari ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes nuk është pasqyruar drejtë në shumën prej 1,912,795 lekë, sepse përveçse në llogarinë 63 kjo vlerë duhet të ishte përfshirë edhe në shpenzime të tjera në operacionet e korrigjimit të rezultatit. Gjithashtu kjo shumë do të duhej të pasqyrohej në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* i ndryshuar, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e saktë të të gjitha transaksioneve të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet apo transaksionet të cilat kanë ndikim në rezultatin e periudhës kontabël me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe asaj të pozicionit financiar.

Menjëherë

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Llogaritë e Klasës 3 sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar më datë 31.12.2025, paraqiten në vlerën 269,880,149 lekë dhe përbëhen nga llogaritë kontabël 31 "Materiale" në vlerën 181,618,660 lekë dhe 32 "Inventar i imët" në vlerën 88,261,489 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në vlerën 135,407,908 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" e cila paraqitet në vlerën 135,407,908 lekë.
***Rekomandimi nr. 9.1, është Zbatuar Plotësisht*.**

10. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare pjesës së seksionit "Shpenzime të tjera" u konstatua se janë përfshirë shpenzimet për investime nga fondet buxhetore në shumën 150,151,979 lekë, të cilat nuk kontabilizohen në shpenzime të tjera për efekt të operacioneve për korrigjimin e rezultatit. Gjithashtu konstatohet se në "Shpenzime të tjera" janë përfshirë fondet transferuar njësive në shumën 294,996,476 lekë, ndërkohë që nga pasqyra e flukseve monetare fondet transferuar njësive "Lëvizje e brendshme e transferta të tjera (+-)" janë në shumën 132,280,211 lekë. Lëvizje e brendshme e transferta të tjera (+-) të mjeteve monetare nga pasqyra e likuiditeteve duhet të rakordojnë me fondet transferuar njësive, konstatohet një diferencë në shumën 162,716,265 lekë. Nga auditimi konstatohet se në operacionet e korrigjimit të rezultatit nuk janë përfshirë "Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura (-)" në shumën 17,820,343 lekë, si dhe "Derdhje e Transferime të të Ardhurave në Buxhet (-)" në shumën 2,283,097 lekë. Si rezultat i mosrakordimit të plotë, të drejtë dhe të saktë të transaksioneve të llogarive kontabël kemi rezultat periudhe jo të saktë me një devijim të përllogaritur në shumën 170,255,419 lekë, rezultat i cili ndikon në pozicionin financiar duke na dhënë një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, rubrika 4.1 *Operacionet e korrigjimit të rezultatit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve, të cilat kanë ndikim apo rregullojnë rezultatin e periudhës përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i

akumuluar" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 2,938,459,293 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 275,898,364 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 135,407,908 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 6,664,262 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 374,283,280 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,636,4360 lekë. Kjo problematikë është konstatuar në Qendrën Kulturore dhe Klubi i Sportit si pasojë e mos aplikimit të saktë të normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale.
Rekomandimi nr. 10.1, Nuk është Zbatuar.

11. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i pasqyrës së flukseve monetare pjesës së parë "Veprimtaritë e shfrytëzimit" konstatohen mosrakordime mes fondeve buxhetore për shpenzime korrente dhe totalit të fondeve për shpenzime të shfrytëzimit nga transfertat buxhetore të fondeve, në shumën 732,767,593 lekë. Nga auditimi konstatohet se "Të hyra nga mjetet në ruajtje (+)" janë pasqyruar në shumën -8,814,934 lekë, ndërsa nga auditimi i llogarisë analitike 466 "Mjete në ruajtje" konstatohet se veprimet në kredi të llogarisë për vitin 2024 janë në shumën 8,814,934 lekë. Efekti në pasqyrën e flukseve monetare është në shumën 17,629,868 lekë. Nga auditimi i pjesës së dytë të pasqyrës së flukseve "Veprimtaritë e Investimeve" fondet buxhetore të akorduara për shpenzime kapitale nuk rakordojnë me fondet për investime të alokuara sipas pasqyrës së transfertave të fondeve buxhetore në shumën 55,257,657 lekë. Nga auditimi konstatohet se pagesat për "Për detyrime e investime të vitit ushtrimor (-)" në shumën 170,423,241 lekë nuk është e saktë sepse shuma e aktiveve të shtuara gjatë vitit ushtrimor sipas pasqyrës "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata" është në shumën 180,681,620 lekë, diferenca e konstatuar është në shumën 10,258,379 lekë të pasqyruara më pak në pasqyrën e fluksit. Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimeve të plota dhe të sakta të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të fluksit monetar të subjektit. Me degën e thesarit është bërë rakordimi i tepricës së fund vitit për disponibilitetet në thesar në shumën 591,168,571 lekë, por diferencat e konstatuara më sipër nuk japin në mënyrë të saktë lëvizjet e mjeteve monetare të Bashkisë gjatë vitit 2024. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, pika 72, 75, 76. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve që lidhen më mjetet monetare në mënyrë të saktë, duke i rakorduar ato me pasqyrat e tjera pjesë të setit të pasqyrave financiare vjetore, si dhe me raportet nga dega e thesarit përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së fluksit monetar, pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Në referencë të kuadrimit të pasqyrave fiananciare janë kryer veprimet sistemuese të kanë konkluduar me mbylljen e gjendjes së llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" e cila më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 798,319,546 lekë duke kuadruar me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 757,385,777 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 40,933,769 lekë.
Rekomandimi nr. 11.1, është Zbatuar Plotësisht.

12. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i pasqyrës së ndryshimeve në aktivitet neto/Fonde neto u konstatuan mospasqyrime të transaksioneve gjatë periudhës ushtrimore, konkretisht:
- Për llogarinë 115 "Nga grantet e brendshme kapitale (+)", gjatë vitit ushtrimor janë evidentuar transaksione në debi në vlerën 30,529,641 lekë;

- Për llogarinë 105 "Nga grantet e brendshme kapitale (+)", gjatë vitit ushtrimor janë kryer transaksione në debi në vlerën 150,151,979 lekë;
- Llogaria 1013 "Nga konsumi i AAGJ" nuk përfshin shumën 185,943,385 lekë, e cila i përket amortizimit vjetor të aseteve.
- Llogaria 1015 "Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet" nuk pasqyron shumën 2,814,524 lekë, që lidhet me pakësimet vjetore të aktiveve. Mospasqyrimi i këtyre transaksioneve krijon vështirësi në përcaktimin e saktë të ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore mbi fondet neto, duke mos ofruar siguri të arsyeshme mbi mënyrën dhe vlerën e ndryshimit të tyre gjatë periudhës kontabël. Mosrakordimet e konstatuara sjellin një pasqyrim jo të drejtë të strukturës së fondeve të konsoliduara të njësisë, si dhe të ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore. Si rrjedhojë, efekti në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, për shkak të mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare, rezulton në një pasqyrim jo të drejtë, jo të saktë dhe jo të plotë të pozicionit financiar të subjektit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, "*Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve që lidhen me ndryshimet e aktiveve neto gjatë periudhës kontabël në mënyrë që të pasqyrohen të gjitha ndryshimet në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto nga e cila derivojnë tepricat sintetike që përbëjnë fondin e konsoliduar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Statusi i rekomandimi: I Pranuar*.**
Koment i Grupit të Auditimit: Pavarësisht se, shumatorja e llogarive të aktiveve në proces kuadron me llogarinë 105-115, u konstatua se në aktiv në llogaritë 212 dhe 213 janë kontabilizuar aktive afatagja të cilat janë në proces duke u përllogaritur normë amortizimi ende pa filluar jetën e dobishme aktivi në vlerën totale 38,055,522 lekë
Rekomandimi nr. 12.1, Nuk është Zbatuar.

13. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve u konstatua se veprimet kontabël në kredi të llogarive të burimeve të financimit nuk janë të sakta. Sipas pasqyrës së fluksit monetar akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale pasqyrohen në shumën 284,843,932 lekë shtuar me fonde nga të ardhurat e veta në shumën 30,529,641 lekë marrim totalin e mjeteve monetare gjatë vitit për investime në shumën 315,373,573 lekë, ndërkohë që në pasqyrën e burimeve të investimeve ato pasqyrohen në shumën 180,681,620 lekë, konstatohet një diferencë në shumën 134,691,953 lekë e pa kontabilizuar në llogaritë e burimeve të financimit të investimeve. Nga auditimi i pjesës së parë të pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve shpenzimet mbyllen me tepricë 0 lekë në fund të vitit, ndërkohë që sipas kësaj tabele teprica në fund të vitit për llogarinë 231 duhet të ishte 46,408,080 lekë. Ekzistenca e kësaj diference nuk jep siguri mbi transaksionet e shpenzimeve për investime nëse këto investime janë në proces apo të përfunduara dhe nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare. Transaksionet në debi të llogarisë 231 "Shpenzime për investime" nuk rakordojnë me pagesat "Për detyrime e investime të vitit ushtrimor" konstatohet mosrakordim në shumën 33,462,419 lekë. Nga auditimi konstatohet se për investimet e kapitalizuara në llogaritë e klasës 2, një pjesë e tyre nuk janë të përfunduara por janë në proces, pra janë kapitalizuar investime pjesore. Kapitalizimi i tyre në llogaritë e aktiveve afatgjata materiale ka bërë që ti nënshtrohen amortizimit vjetor duke ulur vlerën e tyre pavarësisht se nuk janë përfunduar dhe marrë në dorëzim. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar pika 88. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për të kryer dhe pasqyruar saktë investimet e kryera, si

dhe burimet e tyre sipas rregullave kontabël, që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të tekN...ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Pavarësisht se, shumatorja e llogarive të aktiveve në proces kuadron me llogarinë 105-115, u konstatua se në aktiv në llogaritë 212 dhe 213 janë kontabilizuar aktive afatagja të cilat janë në proces duke u përllogaritur normë amortizimi ende pa filluar jetën e dobishme aktivi në vlerën totale 38,055,522 lekë
Rekomandimi nr. 13.1, Nuk është Zbatuar

14. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit konstatohet se në komisionin e inventarizimit merr pjesë në cilësinë e anëtarit të komisioni një punonjës nga Drejtoria e Financës. Nga komisionet përkatëse është kryer procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi, efekti financiar i procesit është kontabilizuar në pasqyrat financiare pavarësisht se mungon urdhri i titullarit për kontabilizimin e efektit financiar të procesit në pasqyrat financiare. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pika 82 si dhe Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 22 pika 3. b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për shmangien e përfshirjes së të njëjtit punonjës në disa procese pune, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Referuar procesit të inventarizimit të kryer nga Aparati i Bashkisë Lushnjë evidentohet se, grupet e punës janë ngritur në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe janë ndjekur proceset e duhura mbi agjesimin e aktiveve duke rruajtur edhe njëkohësisht kuadrin ligjor mbi mjedisin.
Rekomandimi nr. 14.1, është Zbatuar Plotësisht.

B. MASA ADMINISTRATIVE DHE DISIPLINORE
Mbështëtur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, të analizojnë dhe vlerësojë parregullsitë e shkeljet e konstatuara si dhe të marrë masat e nevojshme disiplinore e administrative, sipas çështjeve dhe përgjegjësive të trajtuara në raportin Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur të gjitha procedurat dhe afatet ligjore për punonjësit si më poshtë vijon:
- **Znj. J. H.** në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare për parregullsitë e konstatuara në pasqyrën e pozicionit financiar konkretisht mosparaqitjen e saktë të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të aktiveve afatgjata, mosparaqitjen e drejtë e llogarive të detyrimeve. Në pasqyrën e performancës financiare rezultat periudhe jo i drejtë dhe i saktë. Në pasqyrën e mjeteve monetare pasaktësi në kontabilizime të transaksioneve financiare. Në pasqyrën e ndryshimeve në aktivitet neto/fonde neto mospasqyrim i saktë dhe i plotë i transaksioneve ekonomike.

Statusi i rekomandimi: I Pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Me Vendimin nr. 2/1, datë 06.01.2025, të znj. E. S. Kryetar i Bashkisë Lushnjë është ngritur komisoni disiplinor në shërbimin civil i përbërë nga pesë anëtarë. Me shkresën nr. 7085 prot., datë 16.07.2026, znj. E. S. Kryetar i Bashkisë ka paraqitur pranë Komisionit Disiplinor kërkesën për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH. Me shkresën nr. 7085/1 prot., datë 17.07.2026, Komisioni Disiplinor është adresaur me njoftim për

mbledhje znj. J. H. Me shkresën nr. 7085/2 prot., datë 17.07.2026, Komisoni Disiplinor ka paraqitur kërkesën për rendine ditës. Me shkresën nr. 7085/3 prot., datë 17.07.2026, nga Komisioni Disiplinor është hartuar relacioni mbi përcaktimin e masës për znj. L. H. Me shkresën nr. 7165/1 prot., datë 20.07.2026, Komisioni Disiplinor ka njoftuar znj. L. H. se më datë 27.07.2026, do të merret në shqyrtim trajtimi në lidhje me masën disiplinore.
***Rekomandimi nr. 11.1, është Në Proces Zbatimi*.**

Konkluzion: Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **15** rekomandime të lëna në total, janë pranuar nga Subjekti Bashkia Lushnjë **15** rekomandimet; janë verifikuar **15** rekomandimet nga të cilat: janë zbatuar 7 masa ose **46.7%** e tyre; 1 masë është në proces zbatimi; 1 masë është pjesërisht zbatuar dhe 6 masa janë e pa zbatuar; pra 7 masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti Bashkia Lushnjë për periudhën në vijim.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuara dhe të zbatuara nga Bashkia Lushnjë (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që:
- Për kategorinë "Masa Organizative"- Rekomandimet R1.1; R4.1; R5.1; R8.1; R9.1; R11.1; R14.1; (janë zbatuar),
- Për kategorinë "Masa Administrative e Disiplinore" për 1 punonjës (është në proçes zbatimi);
janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga Bashkia Lushnjë, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, rezultoi se:
- Objektivat e miratuara nga Bashkia nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet email-it apo shkresave zyrtare;
- Pavarësisht hartimit të regjistrit të riskut nuk është konkluduar me hartimin e një strategjie risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë ka ndryshime thelbësore mjedisi i riskut;
- Nuk vlerësohet mundësia e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi;
- Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues; - Nuk është ndërtuar gjurma e auditimi për proceset kryesore të punës;
- Nuk është hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 2.2.1, germat "a-d", pika 2.3.1 dhe Manuali i MFK-së miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016, Kapitulli III, pika a/3.1, Kapitulli IV. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 16-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse të marrin masa për hartimin e strategjisë së risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Lushnjë, në plan-veprimin për menaxhimin e riskut dhe regjistrin e risqeve të bëhet pjesë edhe risku i mashtrimit; të krijohet sistemi i raportimit mbi shkeljet e konstatuara gjatë proceseve të punës; të hartohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës, si dhe të dokumentohet procesi i monitorimit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për përdorimin e fondit rezervë për shpërblimin e nxënësve me arritje të shkëlqyera rezultoi se, me VKB nr. 90, datë 29.09.2025, *"Për*

përdorimin e fondit rezervë për shpërblimin e nxënësve ekselentë", me nr. 8060/2 prot., datë 30.09.2025, është miratuar përdorimi i fondit rezervë në shumën 810,000 lekë.
Nga shqyrtimi i Projektvendimit nr. 83, datë 17.09.2025, relacionit dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi se baza ligjore e përdorur nuk është e plotë, pasi, krahas dispozitave që përcaktojnë kompetencat e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe përdorimin e fondit rezervë, nuk është referuar dhe zbatuar në mënyrë të shprehur dispozita e nenit 28, pika 4, shkronja "b", të Ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, e cila parashikon mbështetjen e nxënësve me arritje të shkëlqyera sipas kritereve të miratuara nga këshilli i njësisë vendore. Për rrjedhojë, në dokumentacionin e shqyrtuar nuk rezulton të jenë përcaktuar në mënyrë të qartë kriteret mbi bazën e të cilave është përcaktuar kategoria e përfituesve.
Gjithashtu, në relacionin e paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak nuk rezulton të jetë argumentuar dhe dokumentuar baza mbi të cilën është përcaktuar masa e shpërblimit, si dhe lidhja ndërmjet numrit të përfituesve, masës individuale dhe shumës totale prej 810,000 lekë. Në këto kushte, vendimmarrja nuk është mbështetur në një argumentim të plotë faktik, financiar dhe ligjor, në kundërshtim me kërkesat e neneve 99 dhe 100 të Ligjit nr. 44/2015, *"Kodi i Procedurave Administrative"*, të ndryshuar.
Nga ana tjetër, u konstatua se ky shpenzim nuk ishte planifikuar në programin buxhetor përkatës AD129/606 dhe as në procesin e planifikimit të PBA-së, por është financuar nëpërmjet fondit rezervë. Duke qenë se shpërblimi i nxënësve me arritje të shkëlqyera përbën një shpenzim të parashikueshëm dhe të përsëritshëm, përdorimi i fondit rezervë për këtë qëllim nuk përputhet me funksionin e fondit rezervë**,** i cili sipas nenit 6 të Ligjit nr. 9936/2008, të ndryshuar, përdoret për shpenzime të paparashikuara ose të pamundura për t'u parashikuar gjatë procesit të hartimit të buxhetit.
Në këto rrethana, Këshilli Bashkiak ka miratuar përdorimin e fondit rezervë pa u siguruar paraprakisht për plotësimin e bazës ligjore, përcaktimin e kritereve të përfitimit, argumentimin e masës së shpërblimit dhe planifikimin e nevojshëm buxhetor, duke mos garantuar një vendimmarrje të mbështetur plotësisht në kërkesat e legjislacionit për financat vendore dhe disiplinën buxhetore.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar*, neni 28, pika 4, shkronja "b"; Ligjit nr. 9936/2008, neni 6 dhe neni 11; Ligjit nr. 68/2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar *neni 5/a*, neni 6/ç, neni 7/3, nenet 34-41; Ligjit nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, nenet 41 dhe 54/ç; si dhe Ligjit nr. 44/2015, *"Kodi i Procedurave Administrative"* i ndryshuar, nenet 99 dhe 100, (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria Ligjore dhe e Burimeve njerëzore të marrin masat që në periudhat në vijim shpërblimi i nxënësve me arritje të shkëlqyera të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi duke:
- Planifikuar fonde në programin përkatës buxhetor;
- Hartuar projekt vendimin mbi një bazë të plotë ligjore dhe duke përcaktuar qartë kategoritë përfituese;
- Përcaktuar paraprakisht masën e shpërblimit për çdo kategori përfituese dhe miratuar atë me Vendim të Këshillit Bashkiak për tu zbatuar në periudhat në vijim.
2.2. Rekomandimi: Këshilli Bashkiak të sigurojë që në shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimeve të propozuara, dokumentacioni shoqërues të përmbajë bazën e plotë ligjore, kriteret dhe kategoritë përfituese si dhe propozimin e argumentuar për masën e shpërblimit, përpara marrjes së vendimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe realizimit të fondeve për investimet u konstatua se:
- Në PBA 2025-2027 dhe projekt planin vjetor 2025 me burim "të ardhurat e veta + transferta e pakushtëzuar" janë planifikuar në total 47 projekte investimi në vlerën totale 525,472 mijë lekë për 4 programe buxhetore të 12 funksioneve, dhe janë realizuar 25 investime në vlerën totale 199,331 mijë lekë ose në masën 38% të vlerës totale të planifikuar.

- Referuar Relacionit shoqërues të Raportit të monitorimit përcjellë në Këshillin Bashkiak dhe Akt rakordimit me thesarin, rezultoi se mosrealizimi i fondeve buxhetore për zërin investime ka ardhur si rezultat i fondeve të papërdorura: nga viti 2024 për vitin 2025 në vlerën 171,195 mijë lekë dhe nga viti 2025 për vitin 2026 në vlerën 238,740 mijë lekë, nga të cilat rreth 20% e vlerës totale nuk është prokuruar dhe pjesa tjetër nga lidhja e kontratave në fund të vitit buxhetor apo nga diferenca plan-kontratë; Nga sa më lartë, mosrealizimi i plotë i programeve të investimeve, vonesat në zbatimin e procedurave dhe pamundësia kohore për riadresimin e fondeve të lira, ka të bëjë me paqartësi apo pasaktësi në përzgjedhjen e programeve dhe investimeve më prioritare gjatë hartimit të PBA-së. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 36, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, dhe Manuali MFK, Paragrafi 2.4; Ligjin nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 5, neni 12. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Grupi Menaxhimit Strategjik të marrin masa që gjatë procesit të hartimit të PBA dhe projekt buxhetit vjetor, të tregojnë vëmendjen e duhur në përzgjedhjen e investimeve prioritare, duke përfshirë projekte të realizueshme brenda vitit buxhetor dhe të zbatohen në afatet kohore të përcaktuara, me qëllim rritjen e eficencës në realizimin e investimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuiditeteve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën e detyrimeve të prapambetura, rezultoi se gjatë vitit 2025 kanë lindur detyrime të reja në shumën 84,202,766 lekë, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2024 në shumën totale progresive 108,097,806 lekë për "investime", "mallra", "shërbime" dhe "mirëmbajtje" dhe "shpronësime". Gjatë vitit 2025 është kryer pagesë në vlerën totale 84,563,831 lekë nga totali i detyrimeve progresive, duke e mbyllur vitin 2025 me një vlerë totale të detyrimit progresiv prej 23,533,974 lekë;

- Nga auditimi rezultojnë 41 procese gjyqësore nga të cilat 21 procese gjyqësore janë me objekt "çështje të ndryshme" të periudhës nga viti 2024 deri në vitin 2026, të cilat kanë efektin financiar në thelb të objektit të padisë. Duke qenë në fazë shqyrtimi, këto procese riskojnë të krijojnë detyrime të mundshme buxhetore për dëmshpërblime, pagesa të prapambetura, shpenzime gjyqësore dhe ekzekutim të mundshëm të vendimeve gjyqësore.
- Bashkia Lushnjë çdo vit ka miratuar planin e shlyerjes për detyrimet e prapambetura, por për shkak të mungesës apo pasaktësisë së dokumenteve justifikuese në praktikën dokumentare të procedurave, ky plan rezultoi të mos jetë zbatuar apo zbatuar në masë shumë të vogël.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 25.05.2022, *"Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 3 datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*, VKM nr. 50, datë 05.02.2014, *"Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit"* i ndryshuar, Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014, *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"* i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për inventarizimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, pikat 34-50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Grupi i Menaxhimit të Riskut, Koordinatori i Riskut, Drejtoria e Financës dhe buxhetit dhe Drejtoria Ligjore dhe e burimeve njerëzore, të marrin masa për:

- Hartimin dhe përditësimin e strategjive dhe regjistrit të riskut, me vlerësim real të risqeve që lidhen me lindjen e detyrimeve financiare dhe proceseve gjyqësore, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të kontratave për investime, shërbime dhe mallra, si dhe të vendimeve gjyqësore;
- Analizimin e çdo rasti të detyrimeve të prapambetura dhe proceseve gjyqësore, me qëllim evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë krijimin e detyrimeve financiare, plotësimin e dokumentacionit të munguar dhe marrjen e masave, brenda kuadrit ligjor në fuqi, për shlyerjen në masë të plotë ose uljen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 23,533,974 lekë;
- Parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja, nëpërmjet zbatimit korrekt dhe në kohë të procedurave ligjore, kontraktuale dhe financiare;

- Likuidimin e faturave për mallra, shërbime dhe investime në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, brenda afateve dhe sipas radhës së përcaktuar, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të reja dhe të efekteve financiare negative në buxhetin e Bashkisë.

4.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi Menaxhimit Strategjik, Grupi Menaxhimit Riskut dhe Drejtoria Ligjore dhe e Burimeve njerëzore të analizojnë çdo rast të proceseve gjyqësore, për të evidentuar shkaqet që kanë sjellë konfliktet gjyqësore dhe marrjen e masave për shmangien e tyre në të ardhmen, duke patur në vëmendje faktin se mos zbatimi korrekt i procedurave ligjore ka edhe efekte financiare negative në buxhetin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi parashikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksa e tarifat vendore, rezultoi se*:*

- Për vitin 2025, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 640,579 mijë lekë në po të njëjtën vlerë me vitin 2024 dhe janë realizuar në vlerën 515,768 mijë lekë ose (-)4,772 mijë lekë më pak se realizimi në vitin 2024 dhe (-)124,811 mijë lekë më pak se planifikimi i tyre në vitin 2025 ose në masën 80.5%;
- Nga kategoria "taksa", në mosrealizimin e të ardhurave kanë ndikuar arkëtimet nga: TNI, taksa e tokës bujqësore, taksë ndërtese, të cilat janë realizuar në masën nga 50.2% deri në 88.7% ndaj planifikimit vjetor por edhe me një rënie në masën nga 0.9% deri në 5.4% ndaj realizimit të vitit paraardhës 2024;
- Nga kategoria "tarifa vendore", kanë ndikuar në mosrealizim tarifa nga: leje transporti-licenca, pastrim-higjenë-ndriçim realizuar në masën nga 77.5% deri në 84.5% ndaj planifikimit dhe me një rënie prej 12% ndaj realizimit të vitit të kaluar;
- Nga kategoria "taksa të ndara" nga: taksë e kalimit të drejtës së pronësisë, renta minerare janë realizuar në masën nga 59.7% deri në 54% ndaj planit dhe me rënie prej 17.6% ndaj realizimit të vitit 2024;
- Nga kategoria "të ardhura të tjera" nga: qira ndërtese, qira tokë bujqësore, të ardhura të tjera, janë realizuar në masën nga 22.6% deri në 86.5% ndaj planit dhe me rënie nga 3.8% deri në 4% ndaj realizimit të vitit 2024;
- Nga njësitë e varësisë, në mosrealizimin e të ardhurave kanë ndikuar: mospagesat për konviktet, nga vaditja dhe nga qendra kulturore e klubi sportiv, realizuar nga 1.6% deri në 47.3% ndaj planit dhe me rënie nga 0.5% deri në 26% ndaj realizimit të vitit të mëparshëm 2024.

Mungesa e një analize të mirëfilltë, të detajuar për çdo burim të ardhurash, ka ndikuar në planifikimin në vlera jo reale të pastudiuara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë, duke kufizuar identifikimin e burimeve me performancë të ulët dhe marrjen e masave për rritjen e të ardhurave. Mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 4/1, neni 5/a,c, neni 7 dhe neni 32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Grupi Menaxhimit Strategjik, Grupi Menaxhimit Riskut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për hartimin e analizave periodike mbi realizimin e secilit zë të ardhurash; pasqyrimin e detajuar të të ardhurave jotatimore sipas burimit të tyre, duke evidentuar shkaqet e diferencave midis planifikimit dhe realizimit, me qëllim planifikimin e të ardhurave mbi baza reale dhe rritjen e nivelit të arkëtimeve .

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi arkëtimet nga taksa e tarifa vendore, nivelin e vlerës debitore progresive dhe masat e marra, u konstatua se:

1. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion nga SPP [Sektori i Prokurimit publik] *rezulton se* gjatë vitit 2025 janë 15 subjekte [Operatorë Ekonomik] që kanë fituar procedurat e prokurimit për punë publike me fondet e Bashkisë Lushnjë në vlerë totale të kontratave të lidhura prej 312,333,748 lekë me TVSh. Lista e operatorëve ekonomik fitues nuk i është vënë në dispozicion Drejtorisë së të Ardhurave Vendore për të verifikuar adresën e regjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe llogaritjen e detyrimeve për taksat e tarifat vendore atyre

subjekteve që nuk kanë nipt primar në Bashkinë Lushnjë, duke krijuar risk për mos faturimin dhe mos arkëtimin e të ardhurave.
2. Vlera e debisë deri në 31.12.2025 është 1,860,578,335 lekë me kamatëvonesa, nga e cila për kategorinë biznes 534,810,226 lekë dhe kategorinë familjare + qiradhënia në vlerën 1,325,768,109 lekë. Për të mundësuar arkëtimin e vlerës debitore, nga ana e Bashkisë Lushnjë rezultoi se:
- Nuk janë dërguar Urdhër bllokimi në DRASHK Lushnjë-Fier;
- Nuk janë dërguar Urdhër bllokimi në DRSHTRR Fier;
- Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Grupi i Menaxhimit Riskut nuk kanë bërë një analizë të thelluar dhe rrjedhimisht nuk kanë hartuar plane për të mundësuar uljen e vlerës debitore progresive;
3. Nga analiza e informacionit të vënë në dispozicion mbi klasifikimin e debitorëve referuar pamundësisë së arkëtimit të debisë, *rezultoi se:*
- vlera e debisë me afat 2-3 vjet është 160,460,541 lekë (pa kamatë) për periudhën 2023-2025;
- vlera e debisë me afat 3-5 vjet është 248,033,576 lekë (pa kamatë) për periudhën 2021-2025;
- vlera e debisë me afat mbi 5 vjet është 198,969,135 lekë (pa kamatë) për periudhën deri në 31.12.2020.
Lidhur me problematikën e debitorëve të sipërcituar, nga bashkia Lushnjë:
- Në takimet e zhvilluara nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Grupi i Menaxhimit Riskut nuk rezulton të jenë trajtuar problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë dhe mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e strukturave përgjegjëse (Grupi i Menaxhimit Strategjik, Grupi i Menaxhimit Riskut dhe DFBAV), nuk kanë hartuar një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.
- Mungesa e Aplikimit të penaliteteve me shkresa për bllokimin e pronave të paluajtshme e të luajtshme regjistruar në ASHK dhe DPSHTRR;
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, Ligjin nr. 9920/2008, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 40, Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"*, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, nenin 181, *"Mos pagimi i taksave dhe tatimeve"*, të Kodit Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime dhe Manualit MFK me ndryshime miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.01.2024, në lidhje me funksionimin e kontrollit të brendshëm, dokumentimin dhe llogaridhënien. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë të marrë masa për të krijuar ura komunikimi dhe shkëmbimi të dokumentuar të informacionit ndërmjet strukturave të bashkisë, veçanërisht ndërmjet Sektorit të Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, me qëllim identifikimin në kohë të subjekteve fituese në tenderat e zhvilluar dhe aplikimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të atyre me nipt primar jashtë territorit të Bashkisë Lushnjë.
6.2. Rekomandimi: Grupi Menaxhimit Strategjik dhe Grupi Menaxhimit Riskut të kryejnë analiza të detajuara për çdo debitor problematik, duke evidentuar numrin e saktë dhe vlerën debitore, nivelin e arkëtimeve vjetore, pengesat për mbledhjen e tyre si dhe të hartojnë dhe zbatojnë një plan masash me afate dhe përgjegjësi konkrete për arkëtimin e vlerës debitore;
- Të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për të siguruar vjeljen e detyrimit vjetor dhe arkëtimin nga debia progresive;

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të aktivit të pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 215 "Mjete transporti" më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 15,395,313 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë edhe vlera prej 3,669,000 lekë që i përket 4 (katër) mjeteve të dëmtuara jashtë funksionit të konstatuara dhe të vlerësuar si të tilla, nga komisioni i vlerësimit përgjatë procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit, duke i'u referuar procesverbalit me nr. 1062 prot., datë 27.01.2026, dhe nr. 1063 prot., datë 27.01.2026. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi nr. 1, pika

2.1, vlera 3,669,000 lekë e cila i përket mjeteve të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në pasqyrat financiare të vitit 2026 të bëjë sistemimin e vlerës 3,669,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarisë 215 "Mjete transporti", sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara".

Deri më datë 31.03.2027

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrave kontabël dhe i llogarive analitike të aktiveve afatgjata materiale të Bashkisë, rezultoi se në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", prej vitit 2024 janë regjistruar shtesa në formën e trojeve, parcelave bujqësore dhe guroreve, me një sipërfaqe totale prej 648,608 m², të cilat janë kontabilizuar me një vlerë totale prej vetëm 17 lekë. Gjithashtu, nga auditimi i llogarisë analitike 212 "Ndërtesa dhe konstruksione", rezultoi se, prej vitit 2024, janë regjistruar 12 ndërtesa, të cilat janë kontabilizuar me një vlerë totale prej 12 lekë, ose 1 lek për çdo ndërtesë.
Referuar dokumentacionit justifikues dhe të dhënave të administruara nga Bashkia, u konstatua se vlerat me të cilat këto aktive janë evidentuar në kontabilitet nuk paraqesin në mënyrë të përshtatshme vlerën e aktiveve të administruara/pronësuara nga Bashkia dhe nuk sigurojnë një pasqyrim të plotë e të besueshëm të vlerës së aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare.
Si rezultat, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2025, zërat e aktiveve afatgjata materiale, konkretisht "Toka, troje, terrene" dhe "Ndërtesa e konstruksione", nuk paraqiten në vlerën që reflekton në mënyrë të drejtë dhe të besueshme gjendjen e aktiveve të administruara nga Bashkia. Veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masat për përcaktimin e saktë të vlerës së aseteve të shtuara që prej vitit 2024 dhe kontabilizimin e vlerave të sakta në llogaritë e aktiveve afatgjata sipas kërkesave dhe tekN...ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të bashkisë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" u konstatua se nga viti 2005 deri në vitin 2015 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 48,138,931 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sh.a Lushnjë, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Lushnjë. Pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Lushnjë dhe Ujësjellës Kanalizime Lushnjë Sh.a. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë për vlerën kontabël 48,138,931 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, pesë llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pa ndryshuar në vite përkatësisht: 210 "Toka, troje, terrene" në vlerën 4,990,000 lekë (Qendra e Arsimit) dhe 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën

4,176,457 lekë, 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 478,995,993 lekë, 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" në vlerën 14,574,498 lekë dhe 215 "Mjete transporti" në vlerën 50,661,092 lekë (Ndërmarrja e Pasurisë Publike) gjendje të cilat nuk janë të analizuara me emërtesat çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II, pika 5, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Njësitë Shpenzuese Ndërmarrjen e Pasurisë Publike, Qendrën e Arsimit marrin masa për të kryer detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 212 "Ndërtesa e konstruksione", 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", 215 "Mjete transporti" të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata materiale rezultoi se, për disa llogari janë aplikuar norma amortizimi jo në përputhje me rregullat kontabël konkretisht:

a) Për vitin 2025 Qendra e Arsimit ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" vlerën 102,456 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 409,225 lekë në masën 20%;

b) Për vitin 2025 Qendra e Arsimit ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" vlerën 8,374,911 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 6,699,928 lekë në masën 20% dhe Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit vlerën 898,221 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 1,796,442 lekë në masën 20%;

c) Për vitin 2025 Bashkia Lushnjë nuk ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhej të aplikohej normë amortizimi në vlerën 3,079,062 lekë në masën 20% dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka aplikuar normë amortizimi për llogarinë 215 "Mjete transporti" vlerën 13,627,007 lekë ndërkohë që referuar trajtimit kontabël duhet të aplikohej normë amortizimi në vlerën 17,248,607 lekë në masën 20%;

d) Për vitin 2025 Bashkia Lushnjë ka aplikuar normë amortizimi në vlerën 278,200 lekë për llogarinë 218 "Inventar ekonomik"; NPP vlerën 771,083 lekë; QKKS vlerën 204,992 lekë dhe QA vlerën 7,992,369 lekë në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike" nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Për më tepër QKKS ka aplikuar normë amortizimi në masën 10% për llogarinë 218 "Inventar ekonomik". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Njësitë Shpenzuese Ndërmarrjen e Pasurisë Publike, Qendrën e Arsimit dhe Qendrën e Kulturës dhe Klubit të Sportit në pasqyrat financiare të vitit 2026, të bëjnë rishikimin dhe korrigjimin e llogaritjes së amortizimit të aktiveve afatgjata materiale, duke zbatuar njëkohësisht normat e amortizimit në përputhje me rregullat kontabël për llogaritë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventar ekonomik", me qëllim paraqitjen në mënyrë të drejtë vlerën e aktiveve dhe amortizimin e tyre.

Deri më datë 31.03.2027

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", rezultoi se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 7,279,000 lekë. Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë. Në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë posedon në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime në masën 37.79% në vlerën 3,779,000 lekë sipas Marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime me nr. 1592 prot., datë 26.07.2022, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM-it, Bashkisë Lushnjë dhe Bashkisë Divjakë. Gjithashtu në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet që Bashkia Lushnjë posedon në Shoqërinë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930". Vlera e aksioneve të Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" është 3,500,000 lekë sipas Ekstraktit Historik në QKB dhe Vendimit nr. 60, datë 06.09.2013, të Këshillit Bashkiak Lushnjë me objekt "Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lushnjë si aksionar i vetëm në themelimin e Shoqërisë "Klubi i Futbollit Lushnja 1930" si zotërues në masën 100% të kapitalit të kësaj shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 2.1, *"Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet në vlerën 7,279,000 lekë.

Deri më datë 31.03.2027

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve u konstatua se, për vitin 2025 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht: Kontrata me nr. 8578 prot., datë 01.10.2025, me objekt "Rehabilitimi i shkarkuesit në rezervuarin e Kasharaj" me vlerë kontrate 32,964,687 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 17,615,760 lekë; Kontrata me nr. 8780 prot., datë 07.10.2025, me objekt "Rindërtimi i shkollës së mesme të bashkuar "Zyber Sharka" me vlerë kontrate 56,699,683 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 13,305,306 lekë; Kontrata me nr. 10112 prot., datë 12.11.2025, me objekt "Sistemime rrugore në Lagjen "18-Tetori", ndërmjet rrugëve "Hysni Gorovelli" dhe "Athina Dhimitri" me vlerë kontrate 31,929,696 lekë për të cilën janë likuiduar situacione punimesh në vlerën 7,134,456 lekë. Vlera e likuiduar prej 38,055,522 lekë që i përket kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Deri më datë 31.03.2027

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Lushnjë më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 40,933,769 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 50 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Lushnjë janë ngurtësuar fonde në vlerën 20,950,887 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Lushnjë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e

Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 20,950,887 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pikat 6-7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3., faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 2,938,459,293 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 275,898,364 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 135,407,908 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 6,664,262 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 374,283,280 lekë, sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" është mbivlerësuar në vlerën 1,636,436 lekë. Kjo problematikë është konstatuar në Qendrës Arsimore si pasojë e mos aplikimit të saktë të normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1. Rekomandimi: Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Qendrën Arsimore në pasqyrat financiare për vitin 2026 të kryejnë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar", me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2027

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 787 "Tërheqje nga seksioni i investimeve" rezultoi se shuma 566,697,377 lekë, e cila përfaqëson mjete monetare të trashëguara nga periudhat e mëparshme kontabël, është kontabilizuar në të ardhura të periudhës. Këto mjete monetare janë konstatuar, kontabilizuar dhe janë pasqyruar në pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme kontabël. Kontabilizimi sërish i këtyre mjeteve monetare në të ardhura të periudhës ka efekt në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare duke dhënë një rezultat jo të drejtë dhe të saktë të periudhës për njësinë, duke e mbivlerësuar atë në shumën 362,366,608 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 66-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që në konstatimet dhe kontabilizimet e të ardhurave të kontabilizohen të ardhurat e periudhës sipas kërkesave dhe tek N...ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare, e cila ndikon drejtpërdrejt në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Lushnjë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, u konstatua se është një numër i konsiderueshëm masash, për të cilat në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin*

e Kontrollin e Lartë të Shtetit", ri kërkohet marrja e masave për zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht:

a. Masa Organizative janë lënë 36 masa që janë pranuar 36 masa nga subjekti, nga të cilat: 7 masa janë zbatuar, 13 masa janë në proces zbatimi, 2 masa janë pjesërisht zbatuar dhe 14 masa pa zbatuar; rikërkohen 16 masa të cilat janë pjesërisht zbatuar dhe pa zbatuar;

b. Masa shpërblim dëmi janë lënë 12 masa në vlerën totale 6,871,004 që janë pranuar 12 masa nga subjekti në masë të plotë, nga të cilat: 2 masa në vlerën totale 382,066 lekë janë zbatuar, 10 masa në vlerën totale 6,486,938 lekë janë pjesërisht zbatuar dhe 0 masa pa zbatuar; rikërkohen 10 masa në vlerën totale 6,486,938 lekë të cilat janë pjesërisht zbatuar;

c. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) është lënë 2 masa në vlerën totale 2,450 mijë lekë që janë pranuar nga subjekti të cilat rezultojnë në proçes zbatimi dhe nuk rikërkohen;

d. Masa disilinore për 6 punonjës është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar plotësisht, nuk rikërkohet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4., faqe 89-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan pjesërisht zbatuar dhe pa zbatuar, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative

4.1. Rekomandimi: *Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnjë të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.*

6.1. Rekomandimi: *Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa të menjëhershme për kryerjen e inspektimeve në terren në lidhje me statusin e subjekteve që kanë aplikuar për çregjistrim në QKB, për rastet që u konstatua se këto subjekte ushtrojnë aktivitet t'u përllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.*

1.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Lushnjë, të marrë masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive, sipas komponentëve të MFK për plotësimin e mangësive të konstatuara.*

5.1. Rekomandimi: *Bashkia Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për:*

- Vlerësimin dhe regjistrimin si aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.

- Miratimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të Rregulloreve dhe manualeve të Aplikacionit TAIS.

- Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemet e teknologjisë së informacionit, procesi i hapjes mbylljes si dhe rastet e incidenteve dhe aksesit të paautorizuar duhet të dokumentohet.

- Të vlerësuar burimet, duke marrë masa për krijimin e Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendërzuar të sigurt për kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.

- Hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën TI si dhe të ngrejë mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

- Hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, si dhe procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.

- Konfigurimin firewall, switch dhe mikrotik të sistemit TAIS (dhe ruajtjen e konfigurimeve) në përputhje me rekomandimet e prodhuesve dhe standardet e praktikat më të mira të fushës.

8.1. Rekomandimi: *Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa në vijimësi që për çdo përllogaritje apo ndryshim të taksës së truallit, ndërtesës dhe reklamës të kryhet mbi bazën e dokumentacionit të pronësisë dhe procesverbaleve faktike të sipërfaqes së shfrytëzueshme.*

9.1. Rekomandimi: *Bashkia Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë*

masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

11.1. Rekomandimi: *Nga Kryetari i Bashkisë Lushnjë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune, i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale* ***14,083,888 lekë,*** *që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga Qendra e Arsimit dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe asaj të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, diferenca në inventar nga personat përgjegjës.*

14.1. Rekomandimi: *Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnjë për vlerën kontabël 48,138,931 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.*

16.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Lushnjë në gjendjen e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" të klasifikojë veçmas llogarinë 218/6 "Pajisjet kompjuterike" në regjistrin e aseteve të njësive dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.*

18.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Qendrën e Arsimit, Qendrën Kulturore dhe Klubit të Sportit të marrin masa për të njoftuar të gjitha subjektet për paraqitjen e dokumentacionit për likuidim, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.*

19.1. Rekomandimi: *Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Dega e Financës të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë 468 "Debitorë të ndryshëm", 210 "Toka, troje, terrene", 212 "Ndërtesa e konstruksione", 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", 215 "Mjete transporti", 466 "Kreditorë për mjete të ndryshme" dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm" të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.*

20.1. Rekomandimi: *Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pasurisë Publike në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2024 të marrë masa për sistemimin e vlerës 1,768,183,907 lekë të kontabilizuar në mënyrë të pasaktë në llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" duke i kontabilizuar si kundërparti në llogarinë 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë".*

21.1. Rekomandimi: *Bashkia Lushnjë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurisë Publike, Qendra Arsimore, Qendra e Kulturës dhe Klubi i Sportit, në pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2024 të kryejnë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.*

22.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës dhe Klubi i Sportit të nxjerr përgjegjësit për të gjitha rastet e* ***e****videntuara të cilat janë objekt të shpenzimeve me aktivitete social-kulturore, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit*

28.1. Rekomandimi: *Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju* ***rikërkojmë*** *marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA të auditimeve të mëparshme që rezultuan të pazbatuara, si më poshtë:*

Për 4 masa organizative:

7.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlera e akumuluar e amortizimit dhe vlera e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe të realizojë inventar fizik për të gjithë*

AAGJ, për verifikim e tyre dhe ekzistencës fizike.

9.1. Rekomandimi: *Bashkia Lushnjë nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të marrë masa për kryerjen e procedurave të plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave paraprake të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuara të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Rajonale Lushnjë.*

10.2. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Lushnjë të marrë masa për ngritjen e strukturës (drejtori/sektorë/njësi) të dedikuar për Informacionin Gjeohapësinor, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes në dhënien e lejeve.*

12.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Lushnjë të marrë masa për rritjen e kontributeve profesionale në inspektoratin e mbrojtjes të territorit, të rekrutojë në strukturën e IMT punonjës me formim profesional inxhinier ndërtimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së punës së Inspektoratit dhe bashkëveprimin me strukturat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.*

B. Masa shpërblim dëmi:

1.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës prej 1,761,169 lekë pa TVSh nga OE "L. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7647 prot., datë 20.09.2023, me objekt: "Urbanizimi i bllokut të banimit në Dushk Sektor", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

2.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej* ***872,980 lekë pa TVSh*** *nga OE "2." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6156 prot., datë 25.07.2023, me objekt: "Urbanizimi i bllokut të banimit në lagjen Saver", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera*

2.2. Rekomandimi: *Bashkia Lushnjë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e* ***penalitetit në vlerën 330,000 lekë me TVSh****.*

3.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej* ***489,472 lekë pa TVSh*** *nga OE "Sh. 0." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4405 prot., datë 30.05.2023, me objekt: "Rindërtimi i rrugës "Lasgush Poradeci", Bashkia*
Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej* ***618,289 lekë pa TVSh*** *nga OE "Z." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7941 prot., datë 12.09.2022, me objekt: "Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Unazë e ish depos se duhanit", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

5.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej* ***456,855 lekë pa TVSh*** *nga OE "C. R.20." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7936 prot., datë 12.09.2022, me objekt: "Sistemim asfaltim i segmentit rrugor 'Taulla Sinani' – 'Esma Dervishi", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

5.2. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e*

*penalitet në vlerën **305,681 lekë me TVSH**.*
7.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **537,675 lekë pa TVSh** nga OE "N." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 831 prot., datë 29.01.2024, me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare 'Irakli Bozo' Golem", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*
7.2. Rekomandimi: *Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e penalitetit në vlerën **916,100.5 lekë me TVSH**.*
8.1. Rekomandimi: *Titullari i Institucionit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **200,717 lekë pa TVSh** nga BOE "A." ShPK & "H.C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11407 prot., datë 28.12.2022, me objekt: "Rehabilitimi i palestrës, shkolla 'Foto Puka", Bashkia Lushnjë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

18. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Lushnjë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë në RPA me shkresën e saj nr. 973/7 prot., datë 12.02.2026 "Mbi auditimin financiar", u konstatua se është rreth 50% e masave, për të cilat në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit",* rikërkohet marrja e masave për zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pazbatuara:
a. Masa Organizative janë lënë 14 masa që janë pranuar 14 masat nga subjekti, nga të cilat: 7 masa janë zbatuar, 0 masa janë në proçes zbatimi, 1 masë është pjesërisht zbatuar dhe 6 masa janë pa zbatuar; rikërkohen 7 masa të cilat janë pjesërisht zbatuar dhe pa zbatuar;
b. Masa administrative e disiplinore për 1 punonjës është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi, nuk rikërkohet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4., faqe 89-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit"*, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan pjesërisht zbatuar dhe pa zbatuar, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative:
2.1. Rekomandimi: *Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurat Vendore të marrin masat menjëherë për përcaktimin e saktë të vlerës së aseteve të shtuara gjatë vitit 2024 dhe kontabilizimin e vlerave të sakta në llogaritë e aktiveve afatgjata sipas kërkesave dhe tek N.ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.*
3.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës të marrë masat për evidentimin dhe sistemimin e transaksioneve që lidhen me diferencën e konstatuar në shumën 117,974,646 lekë. Të bëhen stornimet e kontabilizimeve të pasakta dhe të ribëhen kontabilizimet e sakta të transaksioneve të llogarive 213, 214, 215 dhe 218, si dhe efekti i rillogaritjeve të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit kontabël 2025, sipas kërkesave dhe tek N.ve kontabël me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.*
6.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës të marrë masa që në konstatimet dhe kontabilizimet e detyrimeve të plotësohen dhe respektohen kërkesat dhe tekN.t kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë, si dhe transaksionet e keq klasifikuara në shumën 17,950,115 lekë të sistemohen në llogaritë e pagueshme te detyrimeve afatshkurta sipas kritereve kontabël të secilës llogari.*
7.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës të marrë masa që në konstatimet dhe kontabilizimet e të ardhurave të plotësohen dhe respektohen kërkesat dhe tekN.t kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më*

të saktë të pasqyrës së performancës financiare e cila ndikon drejtpërdrejt pasqyrën e pozicionit financiar në pasqyrat financiare të Bashkisë.

10.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve, të cilat kanë ndikim apo rregullojnë rezultatin e periudhës përpara mbylljes së transaksioneve vjetore, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të pasqyrës së performancës financiare dhe të pozicionit financiar.*

12.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës të marrë masat për kontabilizimin e të gjitha transaksioneve që lidhen me ndryshimet e aktiveve neto gjatë periudhës kontabël në mënyrë që të pasqyrohen të gjitha ndryshimet në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto nga e cila derivojnë tepricat sintetike që përbëjnë fondin e konsoliduar në pasqyrën e pozicionit financiar.*

13.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për të kryer dhe pasqyruar saktë investimet e kryera, si dhe burimet e tyre sipas rregullave kontabël, që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të tekN...ve kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë në pasqyrat financiare.*

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifat vendore që kanë ndaj Bashkisë Lushnjë, u konstatua se deri në datën 31.12.2025 situata paraqitet si vijon:

- Vlera debitore progresive për biznesin e madh në 31.12.2025 është 401,860,684 lekë dhe për vitin 2025 është 48,460,239 lekë;
- Vlera debitore progresive për biznesin e vogël në 31.12.2025 është 109,449,542 lekë dhe për vitin 2025 është 15,064,966 lekë;
- Vlera debitore nga mospagesa e detyrimeve vjetore për vitin 2025 nga 33 institucione është 0 lekë;
- Vlera debitore progresive nga Taksa e ndërtesës në 31.12.2025 është 336,740,475 lekë dhe për vitin 2025 është 31,528,319 lekë;
- Vlera debitore progresive nga taksat/tarifa familjare/truall në 31.12.2025 është 19,391,543 lekë dhe për vitin 2025 është 2,053,725 lekë;
- Vlera debitore progresive nga taksat/tarifa familjare/pastrim në 31.12.2025 është 519,262,282 lekë dhe për vitin 2025 është 50,616,666 lekë;
- Vlera debitore progresive nga taksa e tokës bujqësore është 406,434,528 lekë dhe për vitin 2025 është 44,751,429 lekë;
- Vlera debitore progresive nga TNI në 31.12.2025 është 36,798,213 lekë dhe për vitin 2025 është 17,808,825 lekë;
- Vlera debitore progresive nga qiratë në 31.12.2025 është 7,141,068 lekë për 6 subjekte debitore dhe për vitin 2025 është 177,840 lekë për 6 subjekte debitore;

Në total: Vlera debitore progresive deri në 31.12.2025 është në shumën 1,836,078,335 lekë dhe përbën të ardhura të munguara për Bashkinë dhe vetëm për vitin 2025 është krijuar debi në vlerën totale 210,284,169 lekë. Vlera debitore është kontabilizuar.

Në Bashkinë Lushnjë në takimet e Grupi Menaxhimit Strategjik, nuk janë trajtuar problematikat për pamundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematik pa shpresë arkëtimi në shumën e 198,969,135 lekë dhe të atyre me afat pagese nga 2 deri në 5 vjet në vlerën 408,494,117 lekë dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë të detajuar, deri tani nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre. Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920/2008, datë 19.5.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 6, neni 12, neni 32, neni 40, neni 114; Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 10-20, si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 5-35. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi Menaxhimit Strategjik, Grupi Menaxhimit Riskut dhe Drejtoria e Përgjithshme financës, buxhetit, të ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë

Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës debitore progresive prej 1,860,578,335 lekë dhe veçanërisht për arkëtimin e debisë prej 607,463,252 lekë të debitorëve problematik pa shpresë arkëtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga subjektet që tregtojnë hidrokarbure, u konstatua se:

1. Në Bashkinë Lushnjë kanë ushtruar aktivitetin 56 subjekte, nga të cilat:

- 33 subjekte janë pa licencë, nga të cilat: 9 subjekte janë mbyllur/pezulluar apo çregjistruar dhe 1 subjekt ka ndryshuar aktivitet; 23 subjekte janë me licencë.
- 28 subjekte janë debitore deri në 31.12.2025 në vlerën totale 23,500,000 lekë nga të cilat: 1 subjekt aktiv me autorizim me vlerë debitore 1,000,000 lekë, 26 subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa licencë me vlerë debitore 22,300,000 lekë dhe 1 subjekt që ka ndryshuar aktivitet me vlerë debitore 100,000 lekë. Nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin pa licencë janë 17 subjekte aktive në vlerë totale debitore në shumën 14,300,000 lekë dhe 9 subjekte që kanë mbyllur aktivitetin dhe kanë vlerë debitore totale në shumën 8,100,000 lekë.

Detyrimi i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve deri në datën 31.12.2025 është në shumën 23,500,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 76 dhe neni 114; VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqe 31-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Sektori i Lejeve të Transportit dhe Licensimit, të marrë masat dhe në bashkëpunim me Drejtorinë juridike të ndjekin gjithë hapat ligjorë për vjeljen e detyrimit prej 23,500,000 lekë të 28 subjekteve debitore që tregtojnë hidrokarbure në territorin e Bashkisë Lushnjë, veçanërisht të subjekteve që kanë ushtruar aktivitetin pa u pajisur me licencë dhe që aktualisht rezultojnë të pezulluar apo çregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT